ISSN 2308-6106

AUDITIMI PUBLIK

KLSH

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

REVISTË 4 - MUJORE Nr.13

2016

ALSAI

EUROSAI

INTOSAI

Seria : botime KLSH - 08/2016/59 Tiranë, 2016

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Experentia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË KATËRMUJORE
kërkimore-shkencore-informative
shqip - anglisht

Nr. 13/2016, Tiranë
ISSN 2308-6106
Viti i V-të i botimit 2016
Janar-Prill 2016
Seria : botime KLSH - 08/2016/59

Titulli:

AUDITIMI PUBLIK NR.13

Redaktore: Irena Islami

Art Design: Elisa Metaj

Seria: botime KLSH - 08/2016/59

Shtypur në Shtypshkronjën ” ILAR”

Tiranë 2016

ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION
Experentia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

EVERY FOUR MONTHS MAGAZINE

of reseach, science and information
in Albanian and in English

No. 13/2016, Tirana
ISSN 2308-6106
January - April 2016
Series:Publications ALSAI - 08/2016/59

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH	Kryetar
Prof. Dr. Dhori Kule, Rektor, Universiteti i Tiranës	Anëtar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT) (Kryeredaktor)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof.Dr. Skënder Osmani, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni, Anëtar i Gjykatës së Lartë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati, Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës	Anëtar
Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel, Profesor, Universiteti i Bambergut, Gjermani	Anëtar
Dr. Igor Soltes, ish-President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë	Anëtar
Prof. Dr. Iraj Hashi, Universiteti Staffordshire në Britaninë e Madhe	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola, Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. As. Dr. Sazan Guri, Instituti " G& G Group"	Anëtar
Prof.As. Dr. Manjola Naço, Drejtore Departamenti, KLSH	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela, Kryetar i IEKA, Managing Partner,nH EuroConsult	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar

SEKRETARIATI

Irena Islami	Sekretare Kolegjiumi

I NDERUAR LEXUES !

Kemi kënaqësinë t'Ju paraqesim numrin e 13-të të Revistës kërkimore shkencore "Auditimi Publik".

Në këtë numër të 13-të të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre Drejtues të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) dhe të Organizatave Ndërkombëtare të SAI-ve si z. Arno Visser, President i EUROSAI-t dhe Dr.Igor Soltes, deputet i Parlamentit Europian dhe ish-President i SAI-t Slloven; profesionistë të fushës së Ekonomisë si Prof.Dr. Sherif Bundo, Prof.Dr.Sazan Guri, Dr.Zef Preçi, përfaqësues nga institucione të tjera shtetërore, drejtues dhe auditues të KLSH-së, etj.

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financierë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, ekspertë të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes në auditimin dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI "Experentia mutua omnibus prodest (Eksperienca e Përbashkët ju shërben të gjithëve)".

Bordi Editorial i Revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit, të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të saj me qëllim që kjo Revistë Shkencore, të jetë një mundësi më shumë për zhvillimin e debatit në fushën e auditimit dhe më gjerë.

ME RESPEKT,
BORDI EDITORIAL

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi " Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al

PËRMBAJTJA

TITULLI	AUTORI	FAQE
Ne, Qytetarët! (“*Ne SAI-t përballemi me sfidat e shekullit XXI, duke përdorur teknikat e shekulli të XX-të në institucionet e shekullit të XIX-të*”)	Arno Visser, President i EUROSAI-t Botuar në Revistën e INTOSAI-t (Pranverë 2016)	11
Formaliteti kundrejt parimeve të 3E-ve në procedurat e prokurimit	Dr. Igor Šoltes, Eurodeputet & zv/Kryetar i Komisionit të PE-së për Kontrollin e Buxhetit të Bashkimit Europian	15
Risitë, sfidat dhe disa refleksione mbi auditimin e pasqyrave të reja financiare	Prof.Dr.Sherif Bundo Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës Erëza ARIFI Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	21
Domosdoshmëria e marrjes së masave të nevojshme për reduktimin – mënjanimin e impaktit të veprimtarisë së pakontrolluar antropogjene në sistemin liqenor të Prespës	Prof.Dr.Niko Pano Akademik Prof.Dr.Gudar Beqiraj Akademik Prof.Dr.Salvator Bushati	29
Moratoriumi për koncesionet dhe PPP-të, nevojë e kohës…	Dr.Zef Preçi Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike	43
Ç’duhet të dijë një auditues mbi menaxhimin e mbetjeve urbane	Prof.Dr.Sazan Guri “G&G”Group	55

Auditimi i ECA-s dhe NIK-ut polak mbi rezultatet e shpenzimeve buxhetore 2014-2020 të Bashkimit Europian	Beata Blasiak-Nowak Marzena Rajczewska Këshilltare në Departamentin e Auditimit të Administratës Publike të NIK-ut (Botuar në EUROSAI Journal, nr.04, Prill 2016)	69
Korrupsioni si fenomen dhe masat që duhet të merren me qëllim luftimin e këtij fenomeni	Mirela Kapo, kandidate PhD Avjerina Bazaj, Msc. Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës	81
Mundësitë për zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies për ndjekjen dhe auditimin e Objektivave të Zhvillimit të qëndrueshëm në Amerikën Latine	OJQ "Aksioni Qytetar Kolumbi" (AC-Columbia). (Botuar në revistën e OLACEFS).	97
Roli i ECA-s, lidhur me reagimin e BE-së ndaj krizës financiare	Dr. Louis Galea, anëtar i ECA (Botuar ne EUROSAI Journal, nr.04, Prill 2016)	107
Raporti mbi aktivitetin 2015-2016 të EUROSAI-it	Prezantuar nga Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAI-t në takimin e 44- të Bordit Drejtues	111
Info nga vendi	Aktivitete të KLSH-së (Janar-Prill 2016)	123
Zyra Kombëtare e Auditimit të Finlandës	Profil	147
Kontrolli i Shtetit i Izraelit	Profil	151
Gjykata e Llogarive e Moldavisë	Profil	157

CONTENT

TITLE	AUTHOR	PAGE
We, the people!	Arno Visser, President, EUROSAI Published in INTOSAI Magazine, Spring 2016	161
Formality Vs 3E principles in public procurement	Dr. Igor Šoltes, Memeber of European Parliament	165
Novelties, challenges and few thoughts on new financial statements' auditing	Prof.Dr.Sherif Bundo Faculty of Economy, Tirana University Erëza ARIFI Faculty of Economy, Tirana University	173
The necessary measures to reduce - eliminate the antropogenic damages in Prespa Lake System	Prof.Dr.Niko Pano Academic Prof.Dr.Gudar Beqiraj Academic Prof.Dr.Salvator Bushati	181
Moratorium on concessions and ppp – necessary in our time...	Dr.Zef Preçi Albanian Center for Economic Research	195
What an auditor should know about urban waste management	Prof.Dr.Sazan Guri "G&G"Group	205
The European Court of Auditors' and Polish Supreme Audit office's audit on results of the EU budget expenditure for the years 2014 to 2020	Beata Blasiak-Nowak Marzena Rajczewska Advisors in the Polish Supreme Audit Office's Public Administration Department (Published in EUROSAI Magazine nr.4 April 2016)	217

Corruption as a phenomenon and the measures to be undertaken to combat it	Mirela Kapo, Candidat PhD Avjerina Bazaj, Msc. Faculty of Law University of Tirana	229
Opportunities for the implementation of good practices of governance and accountability for Tracking and auditing Sustainable Development Goals in Latin America	(Published in OLACEFS Magazine)	245
The role of ECA in relation to the EU response to the financial crisis	Dr. Louis Galea, ECA Member (Published in EUROSAI Magazine nr.4 April 2016)	253
Report on EUROSAI activity 2015-2016	From the Secretary General of EUROSAI in 44th meeting of the EUROSAI governing board	257
Events and activities of ALSAI during January- April 2016	INFO	269
National Audit Office of Finland	Profile	289
The Office of the State Comptroller and Ombudsman of Israel	Profile	293
Court of Accounts of Moldova	Profile	299

NE, QYTETARËT!

Në shekullin e njëzet e një, ne jemi dështmitarë të një lëvizje globale e cila sërish kërkon më shumë pjesëmarrje, më shumë transparencë dhe më shumë përgjegjshmëri. Një shembull i kësaj lëvizjeje është "Partneriteti dhe Qeverisja e Hapur".

Nga: Arno Visser, President, Gjykata e Auditimit e Holandës dhe Presidenti EUROSAI

Revolucionet

Në 12 mars të vitit 1848, Mbreti William II i Holandës u zgjua në mes të natës i djersitur, zemra i rrihte fort dhe kishte dhimbje stomaku pavarësisht se nuk kish konsumuar asgjë në mbrëmje.Mendja e tij ishte tek revolucioni që kishte përfshirë Evropën dhe pjesë të Amerikës Latine. Kryengritjet në Paris kundër mbretit të Francës dhe qeverisë së tij, ato të zhvilluara në disa shtete gjermane dhe në Danimarkë, kishte çuar në rrëzimin e papritur të monarkive dhe në reformën e regjimeve të vjetra evropiane. Njerëzit në të gjithë Evropën i ishin bashkuar lëvizjeve *ad hoc* të klasës së mesme, punëtorëve dhe reformatorëve për të shprehur pakënaqësinë me qeverisjet në vendet e tyre. Ata kërkonin më shumë përfshirje në qeverisje dhe më shumë demokraci.

Thirrje të ngjashme kishin filluar të shtoheshin edhe gjatë katër viteve të fundit në Mbretërinë e Holandës. Deri në aktë kohë, William kishte refuzuar hapur çdo reformë. Megjithatë, në ditët e fundit, kërkesa për reforma në mbretëri ishte bërë jo vetëm nga anëtarët e parlamentit, por edhe nga turmat e mëdha në rrugët e Amsterdamit dhe të Hagës. Revolucioni ishte ulur pranë shtratit të Mbretit dhe ishte gati të godiste.

I frikësuar për humbjen e pozitës së tij, William përfundimisht vendosi t'u dorzohej këtyre kërkesave. Më vonë ai shpjegoi se kishte "ndryshuar brenda natës nga një konservator në një liberal "Qysh në mëngjes ai emëroi një komision për të ndryshuar kushtetutën holandeze. Kushtetuta e re i hapi rrugën demokracisë parlamentare". Ajo sanksi-ononte lirinë e arsimit, lirinë e organizimit dhe të shtypit të lirë. Ajo siguronte zgjedhje të drejtpërdrejta në të gjitha nivelet e qeverisjes, buxhet vjetor të përcaktuar

nga parlamenti dhe përgjegjshmëri në qeverisje.

Ajo gjithashtu rezultoi në humbjen e pushtetit personal ekzekutiv për mbretin William. Qasja pragmatike e ndërmarrë nga Mbreti çoi në një tranzicion paqësor të sistemit të qeverisjes në Holandë.

Revolucionet e viteve 1848 dhe 1849 ishin të nxitura nga kërkesa për përfaqësim më të mirë në sistemin parlamentar, kërkesa këto që vinin nga një bazë në rritje e qytetarëve të arsimuar. Kërkesat e tyre për akses dhe ndikim në procesin e vendimmarrjes bazoheshin në vlerat klasike të pjesëmarrjes, përfaqësimit të drejtë, transparencës dhe llogaridhënies.

Epoka moderne

Institucionet tona Supreme të Auditimit e kanë bazën në parimet demokratike të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ne sigurojmë llogaridhënien, rrisim transparencën dhe kontribuojmë në mënyrë të vazhdueshme në përmirësimin e administratës publike në vendet tona. Megjithatë, kohë pas kohe, ne ballafaqohemi me vetë kufizimet tona. Deri në dekadën e fundit të shekullit të njëzetë, qeveritë dhe SAI-t kishin monopolin e informacionit në lidhje me domenin publik. Një ndryshim paradigmik solli ruajtja dixhitale e të dhënave në masë dhe përdorimi i tyre në shkallë të gjerë në fund të shekullit të njëzetë. Analiza e informacionit dhe shkëmbimi i tij nuk është më një proces i vetëm. Përmes dixhitalizimit dhe përdorimit të të dhënave tashmë ka më shumë informacion se kurrë më parë. Për më tepër, informacioni apo të dhënat janë në dispozicion gjatë 24 orëve në çdo ditë të javës, pasi ato nuk janë të mbyllura në një arkiv fizike. Për më tepër, informacioni përdoret në vazhdimësi për interpretime dhe qëllime të ndryshme.

Në shekullin e njëzet e një, ne jemi dëshmitarë të një lëvizje globale e cila sërish kërkon më shumë pjesëmarrje, më shumë transparencë dhe më shumë përgjegjshmëri. Një shembull i kësaj lëvizjeje është "Partneriteti dhe Qeverisja e Hapur". Ky rrjet organizatash që përfshin shumë palë interesi përpiqet që qeveritë të bëhen në mënyrë të qëndrueshme më transparente, më llogaridhënëse dhe më të përgjegjshme ndaj qytetarëve të tyre. Qëllimi përfundimtar i këtij rrjeti është që të përmirësojë cilësinë e qeverisjes dhe cilësinë e shërbimeve që marrin qytetarët. Kjo nuk është e ndryshme nga argumentat e paraqitura nga lëvizjet revolucionare të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Teknikat dhe qëndrimet

Si Institicion Suprem Auditimi ne po përballemi me sfidat e shekullit të njëzet e njëtë duke përdorur teknikat e shekullit të njëzetë në institucione të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Prandaj për ne është e rëndësishme që të mbetemi relevant për publikun e gjerë. Sipas mendimit tim, kjo mund të arrihet duke përqafuar teknikat e zhvilluara rishtazi dhe duke përshtatur qëndrime gjithëpërshirëse. Kohët e fundit, unë kam parë dy shembuj se si ne mund mund t'i

trajtojmë këto sfida. Shembulli i parë është paraqitur nga znj. Tytti Yli-Viikari, e sapo zgjedhur në postin e Audituesit të Përgjithshëm të Finlandës, gjatë një vizite të përbashkët në SAI-n e Turqisë. Ajo argumentoi se SAI-t duhet të investojnë në teknologji të reja dhe në mënyrën se si duhet të përdoren këto teknologji. Mjetet për investigimin e të dhënave, analizat inteligjente të sistemeve të të dhënave dhe analizat e teksteve tashmë janë të aplikueshme. Tani që këto janë zhvilluar për përdorim të gjerë, ne kemi nevojë të investojmë në blerjen e hardware-ve të ri, software-ëve dhe për burime njerëzore. Kjo do të na japë mundësi të përdorim të dhëna të strukturuara dhe të pastrukturuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme. Të dhënat e përfituara në këto mënyra mund të na ndihmojnë të identifikojmë çështje të ndryshe të pandeshura më parë, në mënyrë që të përmirësojmë performancën e përgjithshme të administratës publike.

SAI-t janë në gjendje t'i përdorin këto teknika dhe ne mund të kombinojmë të dhënat e aksesuesshme dhe ato me kërkesa strikte për akses të marra nga burime të ndryshme për të siguruar njohuri të reja për përmirësimin e eficiencës dhe të politikave publike më efektive. Njohuritë e reja të kombinuara me eksperiencat e mëparshme, mund të çojnë në largpamësi. Në vend që të shtrojnë pyetjen se çfarë ndodhi, SAI-t që përdorin të dhënat analitike mund të shohin përpara dhe të fitojnë njohuri për atë çka mund të ndodhë në të ardhmen. SAI-t mund të fokusohen në forma të ndryshme largpamëse auditimi, duke përdorur të dhënat e auditimit, shoqëruar me mjete analitike për të ndërtuar modele dhe skenarë që kanë për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të përgjegjësisë. Shumë prej këtyre mjeteve tashmë janë në dispozicion, për shembull në fushën e marketingut të drejtpërdrejtë. Në të ardhmen e afërt, sistemet kompjuterike të të vetëmësuarit mund të jenë në gjendje të na ndihmojnë në punën tonë audituse, pasi po bëhen gjithnjë e më të sofistikuara dhe janë në gjendje që në mënyrë të pavarur të kombinojnë informacionin e marrë nga burime të ndryshme.

Shembulli i dytë ka të bëjë me pozitën tonë në shoqëri dhe vjen nga SAI i Brazilit. Përdorimi i të dhënave dhe i mjeteve teknologjike të tilla si të dhënat analitike tregojnë se ne në të vërtetë nuk duhet të punojnë më vetëm. Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe të tjerët duhet të kenë mundësi të përdorin të dhënat e administratës publike, në mënyrë që ata të mund të na ofrojnë njohuritë e tyre, duke kontribuar për çështjet që ne si SAI trajtojmë. Kështu, së bashku me shoqërinë, ne jemi në gjendje të paraqesim një tablo më të qartë të asaj që po ndodh. Kjo do të thotë se qeveritë dhe sa më shumë pjesë të tjera të shoqërisë duhet të jenë të gatshëm të ndajnë të dhënat e tyre në një format që është i hapur, d.m.th i plotë, nga një burim kryesor, të aksesueshme, të lexueshme, jo diskriminuese dhe me standarde e licensa të hapura. SAI i Brazilit inkurajon administratën publike që t'i sigurojë

publikut të gjerë akses në këto të dhëna. Këtë ata e bëjnë duke i bindur institucioet shtetëror se shoqëria kërkon më shumë transparencë nga administrata publike dhe në shkëmbim shoqëria mund të kontribuojë drejtpërdrejtë me shërbime të reja për përmirësimin e kësaj administrate. Së fundmi, dhënia e aksesit për të dhënat nga administrata publike u jep qyetatarëve mundësinë të krijojnë biznese të reja dhe të ketë zhvillimin ekonomik. Në këtë mënyrë, SAI i Brazilit ka miratuar qëndrimin e qeverisjes së hapur.

Apel për të ndërmarrë një kurs të veçantë të veprimit!

Në nëntor të vitit 2015, Gjykata e Auditimit e Holandës organizoi konferencën e EUROSAI-t për Open Data. Njëzet e tetë SAI morën pjesë në këtë konferencë dhe ishin të vendosura për ambiciet e tyre. Kështu, 92 përqind dëshironin që të dhënat e tyre të ishin të aksesueshme, 43 për qind dëshërojnë të auditojnë gjatë këtij viti aksesin e të dhënave dhe 81 për qind e tyre parashikojnë të përdorin të dhëna e aksesueshme në auditimet që do të kryejnë në të ardhmen. Lëvizja ka filluar. Tani ne kemi momentin kulminant. Ne si SAI-e, jemi agjentë të informacionit dhe natyra e informacionit me të cilën kemi të bëjmë po ndryshon. Ne duhet të jemi në krye të këtij ndryshimi, duke përqafuar teknika të reja dhe duke përshtatur qëndrimet tona. Në ndryshim nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, në sajë të zhvillimeve teknologjike, publiku i shekullit të njëzet e njëtë kërkon pjesëmarrjen dhe përfshirjen e drejtpërdrejtë. Por këto kërkesa ende bazohen në të njëjtat vlera klasike të pjesëmarrjes, përfaqësimit të drejtë, transparencës dhe llogaridhënies. Ne jemi në mes të revolucionit të të dhënave ndaj duhet të reagojmë shpejt për adresimin e kërkesave për akses në informacion dhe bashkëpunim me shoqërinë. Në fund të fundit, nuk janë vetëm qytetarët që duan të arrijë më shumë transparencë dhe llogaridhënie. SAI-t dhe qytetarët dëshërojnë të njëjtën gjë. Le të punojnë drejt këtij objektivi të përbashkët!

Botuar në Revistën e INTOSAI-t Pranverë 2016

Përktheu: Alma Shehu

Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Arno Visser, President, Gjykata e Auditimit e Holandës dhe Presidenti EUROSAI

FORMALITETI KUNDREJT PARIMEVE TË 3E-ve NË PROCEDURAT E PROKURIMIT

Ngritja e një sistemi të prokurimit publik, zhvillimi dhe implementimi i tij duhet të bazohen në parimin e lëvizjes së lirë të të mirave materiale, parimin e pavarësisë së krijimit (të sipërmarrjeve) dhe parimin e pavarësisë së ofrimit të shërbimeve.

Nga: Dr.Igor Šoltes, Deputet i Parlamentit Europian

Abstrakt

Përveç aspekteve të eficencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit, prokurimet publike karakterizohen gjithashtu edhe nga parime të tjera siç janë ato të barazisë dhe mosdiskriminimit. Duke qenë se prokurimet publike janë një tërësi parimesh të ndryshme, ato shpesh shoqërohen me konflikte apo diskutime të cilat bëjnë që të vështirësohet në mënyrë të konsiderueshme arritja e objektivave. Do të doja të theksoja rëndësinë e parimeve individuale për objektiva të veçanta dhe të bëja një ilustrim se si duhet operuar në rastet kur jemi përballë koflikteve mes këtyre parimeve dhe si duhet kërkuar zgjidhja kur lind nevoja për të peshuar secilin prej këtyre parimeve. Në rastin e korrupsionit në procedurat e prokurimit publik duhet treguar kujdes se cili parim do të jetë prioritar duke kushtuar më shumë vëmendje në trajtimin e çështjes në fjalë dhe nëse të qenit formal në procedura ndihmon në luftën kundër korrupsionit apo përkundrazi e intensifikon atë. Me kaq vite eksperiencë në studimin e rasteve, mund të them se praktikisht institucionet zgjedhin veçanërisht si parimin më të rëndësishëm atë të formalitetit.

Parimet bazë të Prokurimit Publik

Për shkak të shumëllojshmërisë së situatave gjatë jetës së përditshme, legjislacioni nuk mund të përfshijë norma për çdo çështje ligjore, kështu që njohja e parimeve bazë të prokurimit publik është me shumë rëndësi.

Është e nevojshme të kuptohen rregullat ligjore nëpërmjet disa parimeve, të cilat udhëheqin vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktor si dhe Operatorin Ekonomik në njohjen e të drejtave të tij në një procedurë prokurimi. Në fushën e prokurimeve publike, përveç parimeve të veçanta, duhen marrë në konsideratë edhe parime të tjera, të cilat në ditët e

sotme shërbejnë tashmë si një kriter bazë në shoqërinë tonë dhe mbulojnë gjithë sistemin ligjor.

Ngritja e një sistemi të prokurimit publik, zhvillimi dhe implementimi i tij duhet të bazohen në parimin e lëvizjes së lirë të të mirave materiale, parimin e pavarësisë së krijimit (të sipërmarrjeve) dhe parimin e pavarësisë së ofrimit të shërbimeve. Të gjitha këto rrjedhin nga Traktati i Komunitetit Evropian, nga parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit për të siguruar konkurrencë mes operatorëve ekonomikë, nga transparenca në procedurat e prokurimit publik, trajtimi i barabartë i tyre si dhe nga parimi i proporcionalitetit.

Parimet themelore janë specifikuar në Artikullin nr. 2 të Udhëzimit nr. 2004/18/EC, i cili përcakton:

- Parimin e trajtimit në menyrë të barabartë;
- Parimin e mosdiskriminimit;
- Parimin e transparencës;

Traktati mbi Ekonominë i Komunitetit Evropian paraqet kuadrin themelor për rregullimin e legjislacionit të prokurimit publik. Fillimisht ky akt synonte vendosjen e një tregu të brendshëm të përbashkët mes Vendeve Anëtare duke ndaluar çdo diskriminim kombësie dhe çdo kufizim në përzgjedhjen e mallrave dhe shërbimeve duke përfshirë këtu lëvizjen e lirë të mallrave, të cilat janë të zhveshura nga detyrimet doganore, si dhe heqjen e kuotave dhe masave të limituara duke pasur një efekt ekuivalent përgjatë detyrimeve doganore dhe kuotave mes Vendeve Anëtare. Objektivi i këtij Traktati do të arrihej akoma më mirë me heqjen e pengesave ndaj lëvizjes së lirë të forcës punëtore dhe shërbimeve, kapitalit, pagës si dhe me pavarësinë për të vendosur mbi themelimin e ndërmarrjeve në seicilin prej Vendeve Anëtare. Në bazë të këtij Traktati, do të ishte një arritje, zhvillimi i politikave kryesore të Komunitetit Evropian, sidomos i atyre në fushën e ligjit të konkurrencës, ndihmës shtetërore dhe në agrikulturë.

Traktati i EEC (European Economic Community) nuk i përmend shprehimisht prokurimet publike, përveç se në rastin kur përmendet financimi i kontratave publike me vendet e huaja dhe në lidhje me politikat industriale. Pavarësisht kësaj, në Traktatin e EEC mund të gjenden udhëzime për të ndërtuar një bazë të sigurtë ligjore mbi të cilat të mund të ngrihet i gjithë sistemi i prokurimit publik. Këto janë kryesisht dispozita, të cilat i referohen levizjes së lirë të të mirave (Artikulli 28), pavarësisë së themelimit (Artikulli 43) dhe pavarësisë në ofrimin e shërbimeve (Artikulli 49). Dispozita të tjera të rëndësishme janë edhe ato që lidhen me ndalimin e diskriminimit (Artikulli 12) dhe çështjen e sigurimit të sipërmarrjes (Artikujt 81, 86 dhe 87).

Regjimi i lëvizjes së lirë të të mirave dhe shërbimeve është elementi më i rëndësishëm në fushën e prokurimit publik. Traktati i EEC përmban objektivisht bazën ligjore të prokurimit publik, që do të thotë krijimin e procedurave të prokurimit mes vendeve anëtare dhe mundësimin e

operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në kontratat publike përtej kufijve të vendit (mes Vendeve Anëtare). Duke qenë se do të ishte e pamundur për Vendet Anëtare për të vendosur rregulla gjithnjë e më tepër specifike për prokurimin publik, në bazë të traktatit të EEC, udhëzimet ligjore për këtë fushë janë përshtatur në një kategori dytësore. Të kuptosh parimet bazë dhe prej andej të krijosh një sistem ligjor është më se e rëndësishme. Kjo kuptohet akoma më mirë nga fakti se fillimisht implementimi i udhëzimeve nuk ishte efektiv gjithandej, ndaj dhe parime të tilla krijojnë një bërthamë të vetme për interpretim dhe arritjen e objektivave që shoqërojnë sistemin e prokurimit publik nëpërmjet formulimit të kontratave dhe udhëzimeve përkatëse.

Parimet luajnë një rol mjaft të rëndësishëm, si në drejtim të legjislacionit, kur kemi të bëjmë me përshtatjen e përmbajtjes së normave ligjore, por edhe në të kuptuarin e dispozitave ligjore, veçanërisht në rastet e përcaktimeve jo të sakta të tyre. Kryesisht, interpretimi dhe kuptimi i duhur i disa parimeve thjeshtëzon së tepërmi interpretimin e normave ligjore në terma të përmbajtjes, kontekstit dhe qëllimit. Parimet ligjore lidhen me normat ligjore në një të vetme, duke sjellë kështu normat me përmbajtjen e duhur, veçanërisht për rastet kur për shkak të diversitetit të madh jo të gjitha rrethanat mund të jenë parashikuar nga këto norma ligjore. Një rregull ligjor duhet të kuptohet nëpërmjet një parimi specifik, i cili përbën njëkohësisht si drejtimin ashtu edhe qëllimin e hartimit të një norme ligjore në veçanti.

Konfliktet praktike mes parimeve, vlerave, normave dhe marrëdhënieve

Të kuptosh saktë prokurimet publike është tejet e rëndësishmë për Autoritetet Kontraktore sidomos për ti bërë ato të ndërgjegjshme për të drejtat e tyre të kufizuara në përdorimin e aseteve publike më qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit, gjatë të cilave nuk duhet të ketë përfitime personale apo përfitime të grupeve të veçanta por vetëm interesa për publikun e gjerë *"in largo sensu"*. Rëndësia e parimeve gjithashtu reflektohet edhe nga rëndësia që kanë në zgjidhjen e shumë problemeve të kufizuara.

Disa pyetje interesante që mund të na lindin kur diskutojmë mbi këto parime themelore janë:

- A janë ato reciprokisht të barabarta?
- A ka një klasifikim të tyre nga lartë poshtë për nga rëndësia?
- A janë ato përjashtuese apo plotësuese të njëra tjetrës?
- A e mbështesin këto parime prokurimin publik drejt të njëjtave objektiva?

Deri më tani marrëdhënia mes parimeve të formalitetit dhe atyre të ekonomisë (zakonisht kundërshtojnë njëra tjetrën) kanë treguar se janë disi problematike. Autoritetet Kontraktore veçanërisht e kuptojnë këtë konflikt në rastet kur, për shkaqe formale, një ofertë duhet

skualifikuar si e parregullt për shkak të një mungese në dokumentacion, e cila nuk është thelbësore për një performancë të mirë të punës por që është kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktor dhe kjo ofertë në veçanti është më e përshtatshmja për sa i përket gjithë kritereve të tjera të dokumentacionit në tender. Një ofertë e tillë do të duhet të skualifikohet nëse i përmbahemi parimit të formalitetit dhe prakitkës së institucioneve, ndonëse një vendim në favor të kësaj oferte do të ishte në përputhje me parimin e ekonomicitetit. Atëherë, në këto kushte, ku është kufiri i cili tregon se cila do të jetë zgjedhja e duhur midis këtyre dy parimeve? A është e mundur ti vendosim ato në një sistem vlerash në të cilin, në një mënyre relative, do të krijohej një situatë e tillë ku njëri prej parimeve të vendoste një kufi të qartë se cili prej tyre është më i përshtatshëm se tjetri – apo mjafton thjesht parimi i formalitetit të vendoset mbi parimin e ekonomicitetit pa marrë në konsideratë ndonjë ndikim ekonomik? Do të ishte ideale nëse do të kishim mundësi të ofronim një përgjigje direkte. Fatkeqësisht, ende nuk mund të jepet një e tillë për aq kohë sa nuk do të ketë një konsensus mes institucioneve të ndryshme se cili prej parimeve do të jetë më i rëndësishëm në krahasim me të tjerët. Ndërkohë, duke diskutuar mbi këtë problem, mund të marrim në konsideratë si një pikë referimi praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë në procesin e vlerësimit të proporcionalitetit, ku "*rëndësia*" ka më tepër peshë se sa "*ndërhyrja*" por me një të drejtë specifike, kur kjo e drejtë synon të mbrojë veten nga ndërhyrje të tilla dhe kur gjykohet se kemi pasur të bëjmë me një ndërhyrje më të rëndë në proporcion me nivelin më të lartë të një të drejte të cënuar. Nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se rëndësia e të drejtës, e cila duhet të mbrohet nga ndërhyrjet prevalon mbi rëndësinë për ndërhyrje mbi të drejtën në fjalë, atëherë ndërhyrja do ti nënshtrohet këtij lloj testi të proporcionalitetit. Një formë e tillë testi proporcionaliteti mund të kryhet edhe në rastin e prokurimeve publike, kur gjendemi para një rasti ku zbatimi i një parimi kërkon shkeljen e një parimi tjetër.

Kjo mund të ndodh në rastet kur p.sh për mbrojtjen e parimit të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, parimi i formalitetit shkelet nën pretendimin se janë zbatuar parimet e 3E– ve. Në këtë mënyrë ky është një rast tipik për përdorimin e testit të proporcionalitetit.

Një e drejtë e caktuar (në rastin tonë parimi i formalitetit) mund të kufizohet vetëm në rastet, në të cilat është e nevojshme për qëllime të mbrojtjes së të drejtave të tjera (në rastin tonë parimi i ekonomicitetit), kur është e domosdoshme të respektohen parimet kushtetuese të proporcionalitetit, kjo do të thotë që është e detyrueshme të plotësohen tre kushte për pranueshmërinë e këtyre kufizimeve apo ndërhyrjeve në të drejta: Emergjencë, mjaftueshmëri dhe proporcionalitet në një kuptim të kufizuar. Ndërhyrja në të drejtat kushtetuese është e lejuar vetëm

në rastet kur këto ndërhyrje janë të domosdoshme (të paevitueshme) për mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut, që do të thotë se një objektiv ligjor nuk mund të arrihet duke kryer ose jo një ndërhyrje të vogël në të drejtat kushtetuese. Për arritjen e një objektivi kushtetues të lejuar, ndërhryja duhet të jetë e përshtatshme (p.sh mbrojtja e të drejtave të të tjerëve apo e interesit të publikut, ku mbrojtja e interesit të publikut përfaqëson një objektiv të lejuar). Ndërhyrja në të drejta nuk duhet të jetë e tepruar, që do të thotë se vetëm ndërhyrjet më të vogla nga të gjitha ndërhyrjet e mundshme në të drejta janë të lejuara për arritjen e të drejtave kushtetuese apo objektivave të dëshiruar, siç është p.sh. Mbrojtja e të drejtës së barazisë së të tjerëve. Brenda kuadrit të proporcionalitetit, rëndësia e ndërhyrjes në një të drejtë duhet gjithashtu të vlerësohet krahasuar me rëndësinë e të drejtës e cila do të kufizohet. Sigurisht që ne nuk mund të bëjmë një barazim të drejtpërdrejtë mes prokurimeve publike dhe të drejtave kushtetuese, disa prej tyre mund edhe të rrjedhin nga përdorimi i prokurimeve publike apo janë të kufizuara me qëllim zvogëlimin e keqpërdorimit nëpërmjet akteve ligjore apo ekzekutive, apo nga vendime të ndonjë institucioni apo autoriteti. Pavarësisht kësaj, kushtet e përmendura pak më sipër pas të cilave mund të lejohen ndërhyrjet në të drejtat kushtetuese, në një mënyrë apo tjetrën, krijojnë bazat për një vlerësim të pranueshmërisë së limiteve dhe perjashtimeve të një prej parimeve themelore të prokurimeve publike me qëllim zbatimin e një parimi tjetër. Jo vetëm domosdoshmëria, por gjithashtu edhe mjaftueshmëria dhe proporcionaliteti duhen marrë në konsideratë si elementë të rëndësishëm në testin e proporcionalitetit në fushën e prokurimeve publike gjatë të cilave na duhet të vlerësojmë ndërlikimet që lindin prej shkeljes së një parimi, në kuadër të një përfitimi dhe të një objektivi, i cili mund të arrihet vetëm nëpërmjet zbatimit të një parimi tjetër dhe që duhet bazuar në ligj. Në këtë mënyrë, pamjaftueshmëria e theksuar formale apo cënimi, nuk do të thotë me patjetër përjashtimin e një operatori ekonomik nga një procedurë prokurimi, në raste të tilla kur pamjaftueshmëria apo cënimi i së drejtës nuk do të ketë ndikime negative apo të pafavorshme në parimet e tjera të prokurmit publik (parimi trajtimit të barabartë, parimi i mosdiskriminimit, etj). Kjo neglizhencë mund të çojë më tej në përzgjedhjen e një oferte bazuar në parimin e ekonomicitetit me qëllimin e vetëm sipas kriterit të kushtit ekonomik më të favorshëm, i përshtatshëm ky në marrëdhënien mes investimit dhe vlerës.

Neglizhimi i parimit të formalitetit në emër të parimit të ekonomicitetit në këtë rast do të ishte i nevojshëm, i përshtatshëm dhe proporcional.

Konkluzione

Diskutimi i mësipërm mund të përfaqësojë një formulim të testit të proporcionalitetit në fushën e prokuri-

meve publike, diskutim i cili mund të përbëjë një hap të rëndësishëm dhe të domosdoshëm drejt vështrimit të praktikave më të fundit, si për Autoritetet Kontraktore ashtu edhe për institucionet monitoruese të rregullshmërisë, për të vendosur mbi shkeljet ne procedurat e prokurimit publik por gjithashtu edhe në shkeljet e parimeve themelore. Një nga detyrat më të vështira për përmirësime ligjore dhe praktike për t'u kryer është gjetja e një raporti të përshtatshëm mes parimeve themelore të prokurimit publik. Mund të themi se asnjë parim nuk mund të përjashtohet por dhe as të përdoret me siguri.

Përktheu: Jonild Hoxhaj, Auditues

Departamenti i Auditimit të Pushtetit Vendor

Nga: Dr.Igor Šoltes, Deputet i Parlamentit Europian

RISITË, SFIDAT DHE DISA REFLEKSIONE MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE TË REJA FINANCIARE

*Rishikimi, përmirësimi dhe modernizimet e standardeve të kontabilitetit dhe të pasqyrave të raportimit financiar kanë shërbyer **për të përafruar kontabilitetin dhe shërbimet e tij me kulturën profesionale dhe eksperiencën evropiane** në këtë fushë.*

Nga: Prof.Dr. Sherif BUNDO, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Erëza ARIFI, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Për një profesionist kontabiliteti dhe për çdo studiues dhe njohës të mirë të kësaj fushe, që udhëhiqet në punën dhe veprimtarinë e përditshme nga parime të shenjta morale dhe profesionale, zhvillimet në fushën e kontabilitetit në dy dekadat e fundit kanë qënë të vrullshme. Ato kanë qënë dhe janë të tilla, për shkak të ndryshimit dhe vrullit të ndryshimeve në bërthamën e shoqërisë dhe të ekonomisë, në marrëdhëniet e pronësisë.

Rishikimi, përmirësimi dhe modernizimet e standardeve të kontabilitetit dhe të pasqyrave të raportimit financiar kanë shërbyer **për të përafruar kontabilitetin dhe shërbimet e tij me kulturën profesionale dhe eksperiencën evropiane** në këtë fushë. Ato **kanë pasuruar fjalorin profesional** dhe kanë shërbyer edhe **për të mbajtur më të lidhur profesionistët e kontabilitetit dhe audituesit, me zhvillimet, me risitë që solli modeli ekonomik i tregut** dhe vlerësimi kontabël bazuar në vlerën e drejtë.

Disa arritje dhe risi njëherësh

Pa i vënë vetes detyrë, që të listojmë gjithë arritjet dhe risitë, në mënyrë të sintetizuar, mund të nënvizojmë se standardet e reja, e kanë pasuruar eksperiencën dhe praktikën tonë kontabël në disa fusha dhe dimensione njëherësh.

Së pari, ato kanë sjellë risitë që trajtimi kontabël dhe pasqyrat financiare, **raportimi financiar i të gjitha llojeve dhe kategorive të bizneseve të jetë i përafërt**. Kjo do të thotë se nuk ka diferenca të mëdha të zyrtarizuara në trajtimin kontabël të entiteteve. Përderisa shumica dërmuese e bizneseve në vendin tonë është e kategorisë Ndërmarrje të vogla

dhe të mesme, këto standarde duket që ju shkojnë më shumë për shtat. Zgjedhja e KKK, për të adoptuar si standarde kombëtare kategorinë e standardeve ndërkombëtare të NVM, **është një qëndrim strategjik që duhet inkurajuar dhe mbështetur.** Shërbimi kontabël i tyre është i bazuar tek kontabiliteti i përgjithshëm dhe llogaritë sintetike.

Së dyti, standardet **kanë sjellë mjaft risi që kanë lidhje me vlerësimin**. Personalisht këtë e quajmë, nga njëra anë dinamizmin e madh dhe progresin në vlerësimin kontabël, duke përdorur vlerën e drejtë, apo vlerën e tregut, dhe nga ana tjetër **kanë sjellë me vete edhe rritjen e lirisë profesionale** të profesionistëve që të kërkojnë midis disa mënyrave të vlerësimit, atë, apo ato mënyra që është/janë dhe çmohet/çmohen më e drejtë dhe më afër të vërtetës. Një mall, një aktiv, një pasuri, një mjet, një ndërmarrje, thuhet në Ligjinë e Çmimit të njëjtë në Financë, vlen aq sa shitet. Nga ana tjetër, dy mallra të njëjtë nuk shiten gjithnjë njëlloj. Kjo do të thotë se ka diferenca, shpesh herë të mëdha midis vlerës dhe çmimit. Ndaj standardet krijojnë mundësinë që profesionistët të kërkojnë vlerësimin më të drejtë dhe gjithnjë në kërkim të asaj metode vlerësimi që është e bazuar sa në parimet e vlerësimit, aq edhe në parimet dhe kodet profesionale.

Së treti, standardet e reja, edhe pse janë një frymë e re dhe formulime të reja, **ruajnë boshtin e standardeve kombëtare të Kontabilitetit.** Standardet e reja janë një përmirësim dhe progres i tyre. Ato ngrihen dhe implementohen si të thuash mbi themelet e standardeve kombëtare. Kjo i ka shërbyer për mirë përmirësimit të cilësisë së shërbimeve kontabël dhe rritjes së aftësive profesionale të tyre. Mbajtja në të njëjtën linjë e standardeve të reja është kontribut në evitimin e një lloj anarkie dhe shpërqëndrimi që ndodh natyrshëm në raste të tilla, kur në një fushë, ligjet apo aktet rregullatore ndryshojnë shpesh, ndryshojnë dhe dalin rregulla të reja, pa përvetësuar dhe konsoliduar njohejt e standardeve të vjetra.

Së katërti, pa asnjë rezervë, dëshirojmë të nënvizojmë se standardet e NVM **kanë përmirësuar nivelin e mësimdhënies dhe kanë përmirësuar dhe kanë pasuruar leksionet dhe materialet e tjera didaktike.** Përkthimi dhe shqipërimi i standardeve dhe kontributi i institucioneve të angazhuara në këtë fushë është një vlerë e shtuar në fushën e kontabilitetit dhe të raportimit financiar në vendin tonë. Puna për njohjen dhe trajnimin me standardet e reja, ka qënë dhe mbetet një sektor i veprimtarisë intensive të shoqatave dhe organizmatave profesionale të fushës së kontabilitetit. Vetëm SHKFSH, që në datën 1 shtator 2016, kishte të regjistruar në regjistrin e antarësisë 4898 antarë, ka trajnuar përgjatë vitit 2015 mbi 740 profesionistë, me statusin Kontabël të Miratuar aktivë, Kontabël të miratuar jo aktivë, kandidatë për Kontabël të Miratuar dhe antarë të rinj. Kjo organizatë mjaft e madhe

profesionale, ka organizuar përveç kurseve të trajnimit dhe të formimit profesional në fiskalitete, edhe kurse në njohjen, interpretimin dhe zbatimin e standardeve të reja.

* * *

Me qëllimin e mirë, në shërbim të përmirësimit dhe në përgjigje afirmative të ftesës së bërë prej opinionit të profesionistëve të kontabilitetit dhe të Auditimit, në vijim edhe të konkluzioneve të Konferncës së KLSH, në mënyrë modeste, do të dëshironim që të adresonim disa sugjerime, apo më mirë të tërheqim disa refleksione që baza e kontabilistëve i artikulon në mënyrë të natyrshme dhe me vetëdije të lartë profesionale. Gjykojmë se është detyra e të gjithëve që të reflektojmë dhe të kontribuojmë **në përmirësim të qartësimit dhe thjeshtësimit të informacionit kontabël dhe të përdorimit me lehtësi të tij** në shërbim të vendimmarrjes dhe të menaxhimit. Sidoqoftë, duhet nënvizuar se **asgjë nuk është perfekte**. Perfekte është vetëm fakti që asgjë nuk është e tillë. **Sugjerimet tona do të përqëndrohen në tre linja kryesore.**

1. Pasqyrat Financiare, Standardi 2. Përderisa pasqyrat financiare janë artikuluar dhe formuluar prej nesh, për cilësinë, mënyrën e formulimit, përmbajtjen e fjalëve dhe kontekstin gjithëkush mund të shprehë opinione. E përbashkëta është e lidhur me faktin se përmbajtja e formulimeve duhet të nënkuptojë, përfshijë, shprehë dhe përfaqësojë gjithnjë të njëjtën gjë. Në këtë kuptim, **misioni ynë është i lidhur me faktin që ato, pasqyrat financiare të jenë sa të thjeshta aq edhe të qarta.**

- Në pasqyrat tona financiare, Standardi numër 2, pasqyra e pozicionit financiar, bilanci, por edhe në pasqyra të tjera, përdoren për herë të parë disa terma për të shprehur zëra të aktiveve dhe pasurisë, apo zëra të detyrimeve, që kemi bindjen se nuk tingëllojnë mirë dhe nuk “kanë ngjitur” në kulturën dhe terminollogjinë profesionale të profesionistëve. Në Direktivën e re të Bashkimit Evropian, (qershor 2013), thuhet qartë se: **"Bilanci paraqet formën ligjore të llogarive"**. Pak a shumë të njëjtin përkufizim kanë edhe dy direktivat e tjera, direktiva 4 dhe dierektiva 7, të BE të cilat kanë shumë vite që janë artikuluar dhe hartuar. Në fushën juridike, në fushat profesionale, në fjalorin e fiskaliteteve, në fushën e financës, dhe në fusha të tjera, termat duhet të shprehin përmbajtjen e lëndës. Në këtë linjë, mendoj se disa fjalë nuk shprehin thelbin dhe ajo që nuk tingëllon mirë, është e lidhur me faktin se i largohet esencës. Kështu, **në aktivin e Bilancit,** përdoren **termat: të drejta të arkëtueshme** (nga aktiviteti i shfrytëzimit, nga njësitë ekonomike brenda grupit, nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesmarrëse, apo të drejta të arkëtueshme të tjera), ndësa **në krahun e detyrimeve dhe të Kapitalit**, përdoren **termat: të**

pagueshme (për aktivitetin e shfrytëzimit, të pagueshme ndaj njësive ekonomike brënda grupit, të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesmarrëse, të pagueshme ndaj punonjësve, të pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dëftesa të pagueshme, të pagueshme për detyrimet tatimore, të tjera të pagueshme, etj). Kjo formë të shprehuri nuk më duket korrekte, për shumë arsye, ndër të cilat po rendis:

Së pari, kjo mënyrë të shprehuri nuk ka lidhje me **"formën juridike të llogarive"** që insiston direktiva. Këto formulime bien ndesh me formulimet që kemi, që përdorim, që shprehin raportet juridike dhe që punojmë në legjislacionin tregëtar dhe atë fiskal në vendin tonë. Për të qënë i saktë në opinionin tim, kam studiuar me shumë përgjegjësi dhe vëmendje 14 ligje dhe VKM mbi Tregëtaret dhe Shoqëritë Tregëtare në Republikën e Shqipërisë, ndër të cilët përmend: Ligjin "Për tregetarët dhe Shoqëritë Tregëtare, për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit, (së fundi për Qëndrën Kombëtare të Biznesit), për liçensat autorizimet dhe Lejat, për Falimentimin, për Konkurencën, për tregëtinë elektronike, për përgjegjësitë penale të personave Juridikë, për Proçedurat Tatimore në RSH, për tatimin mbi të ardhurat, si dhe disa VKM. **Në legjislacionin** tonë në fjalë **përdoren termat që burojnë nga raportet tregëtare**. **Ekonomia e tregut është e bazuar tek veprimtaria tregëtare dhe kjo e fundit është e bazuar tek kontratat, të drejtat dhe detyrimet midis palëve** që burojnë nga një veprimtari shitblerjeje, shfrytëzimi, shërbimi, apo çdo formë tjetër, por që juridikisht quhet veprimtari tregëtare. Legjislacioni përdor termat Klientë, Debitorë, Furnitorë, Kreditorë, apo të drejta mbi dhe ndaj këtyre palëve. Nga studimi me vëmëndje i disa relacioneve që kanë shoqëruar propozimet e qeverive të ndryshme për miratimin e këtyre ligjeve, ndër të tjera thuhet se janë terma që përdoren në kontabilitet dhe që shprehin të drejtat dhe detyrimet ndaj palëve të treta. Formulimet në legjislacion bazohen tek parimi që kontabiliteti dhe dokumentat bazë kontabël janë provë juridike. Mbi këtë vlerë, është ndërtuar gjithë praktika juridike dhe është organizuar shprehja e të drejtës së pronësisë. Sa për ilustrim, në Ligjin "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" termi Kreditorë përdoret 233 herë, ose mesatarisht një herë në çdo nen. Ndërsa termi debitor/ë dhe kreditor/ët, në ligjin për Falimentimin përdoren në më shumë se 415 herë në 280 nenet që ka ligji. Që pasqyrat e pozicionit financiar dhe ato të performancës financiare **të jenë në shërbim dhe në harmoni me gjithë legjislacionin tregëtar** ato duhet të përdorin termat që përmëndëm dhe duhet të reflektojnë këtë fakt.

Së dyti, në **kulturën legjislative dhe aktet rregullative**, sikurse janë edhe pasqyrat financiare përderisa janë bërë të detyrueshme me urdhërin numer 64,

korrik 2014, te Ministrit të Financave, ka një praktikë dhe filozofi, sipas të cilës, **një ligj, një praktikë, një akt, që nuk "ngjit", që nuk pranohet nga publiku**, që nuk "kapërdihet" dhe nuk vetë ekzekutohet, **duhet ndryshuar**. Nga kontaktet me profesionistët, më rezulton se një pjesë e mirë e tyre kanë bërë përshtatje. Nga njëra anë e drejta dhe sjellja e profesionistëve për të perdorur dhe ndryshuar formulimet, është shprehje e lirisë së tyre profesionale. Por, nga ana tjetër, kjo tregon që jo të gjitha shprehjet dhe formulimet janë bërë dhe bëhen pjesë e kulturës së tyre të punës. Kjo praktikë dhe kjo kulturë në botën fiskale është mjaft e njohur. Shembujt e ndryshimeve të tilla në legjislacionin tatimor janë të shumë edhe në kulturën fiskale për vëndin tonë. Po marr termin: ***detyrime afatshkurtëra të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit***. Është fjala për detyrimet ndaj furnitorëve! Pse të mos shkruhet më shkurtë, më thjeshtë dhe më qartë: **detyrime ndaj furnitorëve?** Më e plotë, ndoshta edhe më e qartë do ishte: detyrime ndaj furnitorëve për veprimtarinë kryesore. Fjala shfrytëzim në shqip nuk ka të njëjtin konotacion me fjalën shfrytëzim që kanë përdorur francezët, të cilët kanë 35 vjet që e kanë hequr, apo që përdorin edhe gjuhët e tjera.

Së treti, formulime të tilla, nuk **janë të bazuar në kulturën kontabël dhe as në eksperiencën kontabël të asaj që quhet evropa kontinentale**. **Praktika kontabël italiane** që e kemi afër dhe që ka pasur tradicionalisht ndikime në vendin tonë, përdor termat: kredi akorduar klientit, kredi akorduar të tjerëve në aktiv dhe detyrimi ndaj furnitorëve dhe detyrime ndaj të tjerëve në pjesën e detyrimeve. **Zviceranët,** përdorin në pjesën dhe hapësirat frankofone, termat Debitorë dhe Klientë, në aktiv dhe Furnitorë, Kreditorë dhe detyrime të tjera, në pjesën e detyrimeve. **Francezët** përdorin termat: Klientë dhe debitorë, ndërsa në krahun e detyrimeve përdorin termat Furnitorë, përdorin termat Kreditorë, përdorin termat detyrime ndaj shtetit, detyrime ndaj sigurimeve shoqërore, detyrime ndaj palëve të lidhura, të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve, debitorë të tjerë/kreditorë të tjerë. **Në Gjermani,** përdoren termat të drejta ndaj Klientëve, detyrime ndaj furnitorëve, të tjerat janë pothuaj njëlloj. **Edhe versioni anglez,** në të cilin duket që janë bazuar hartuesit dhe propozuesit e KKK të këtyrë termave, shprehin në mënyrë të domosdoshme faktin që qoftë detyrimet për tu paguar, qoftë të drejtat për arketim, duhet të jenë të adresuara ndaj palëve të lidhura në veprimtari tregëtare. Fjala klient dhe fjala furnitor, fjala debitor dhe fjala kreditor, nuk mund të suprimohen. Ato janë pjesë e fjalorit të ditës. ***Një shitës*** nuk thotë ***sot kam pasur shumë të arkëtueshme***, por thotë sot kam pasur **shumë klientë**, nuk thotë kam ***shumë të pagueshme*** por ***thotë kam shumë detyrime***.

Së katërti, kontabiliteti, **zanafillën e ka tek koncepti i debisë dhe i kredisë**, të cilat janë në thelb **rrënja gjuhësore e**

fjalëve debitorë dhe kreditorë. Nuk duhet ti abandonojmë këto terma origjine. Përpara se të përdorim formulime të reja dhe shprehje të reja, cila është arsyeja që nuk duhet të përdorim, apo përshtasim ato që ekzistojnë?

Së pesti, formulimet **nuk respektojnë traditën, kulturën tonë profesionale, shkollën, dhe gjithë pasurinë intelektuale të fituar në këtë fushë**. Besoj nuk ka **faktorë që na ngutin, na forcojnë të mos marrim në konsideratë** atë pak përvojë që kemi në fushën e kontabilitetit? Në vendin tonë, në shumë fusha, është përdorur me pasoja, braktisja e përvojës pa arsye, pa analizë, për shkak të amatorizmit. E di që duke përdorur rrethanorin "përvojë e pakët" nuk jam i saktë dhe ndoshta fyej themeluesit dhe kontribuesit e mëdhenj të kontabilitetit në vëndin tonë. Por, si përfaqësuesi më i lartë i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, dhe Profesor ne Universitet në Finance e kontabilitetit, më duhet të vë theksin tek respekti për arritjet. Kush nuk di nga vjen, nuk di të përdorë "busullën" ku shkon, nuk gjen dot rrugën e duhur.

Së fundi, por pa pretenduar se i trajtova në mënyrë ezauruese të gjithë faktorët, **është faktori gjuhësor.** Tek pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare, (Metoda direkte), ka një zë që të lodh kur e lexon. Po e citoj**: "Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve"**. Nuk po e komentoj. Kam vuajtur për ta kuptuar këtë shprehje. Në bilanc, në pjesën e detyrimeve përdoret termi: **Dëftesa për tu paguar?** Tipologjia e fjalës dëftesë, është e lidhur vërtetë me dokumentin që i lëshohet dikujt për të vërtetuar se i kemi marrë diçka, apo se ai ka paguar apo ka dhënë diçka. Por, fjala dëftesë përdoret edhe për dëftesën e shkollës, edhe dëshmi. Po për transaksionet elektronike, me paranë e padukshme apo me rregjistrimet elektronike, qe nuk ka deftese? Po veprimet me karta manjetike? Pse duhen shprehur në mënyrë kaq konfuze termat tona profesionale, në një gjuhë shumë të pasur? Fjala detyrime të tjera, është më e thjeshtë, më e qartë, më e plotë, pa mëdyshje. (**Po citoj nga Fjalori i gjuhës shqipe:** Detyrim është zotimi që marrim ndaj dikujt apo diçkaje, zakonisht sipas një marrëveshje, para, prodhime, mall, etj. Detyrime shtetërore, detyrime tregëtare, shlyen detyrimet, paguan detyrimet. Ka më qartë?) Një njohës dhe përkthyes i talentuar i anglishtes, përkthyes i dhjetra librave kryvepra, profesor në universitet, nënvizon: përkthimi është shkencë, fjalët nuk duhet dhe nuk mund të përkthehen të shkëputura. Përkthimi wshtw i duhuri kur gjëndet fjala që shpreh përmbajtjen e termit, jo të përdoret kuptimi i parë frazeollogjik i fjalës që gjëndet në fjalor.

Fjala Kreditor, është fjalë e fjalorit të gjuhës shqipe. Kuptimi i parë dhe i vetëm i së cilës është e lidhur me detyrimet kreditore që i burojnë një ndërmarrje ndaj një ndërmarrjeje tjetër, debitore, të lidhur me raporte tregëtare për mallra dhe shërbime. Po kështu edhe fjala furnitor dhe furnizim, nëpërmjet veprimtarisë tregëtare të shitblerjes.

Edhe një shpjegim të fundit gjuhësor. Fjalët, të arkëtueshme dhe të pagueshme, **janë mbiemra**. Në pasqyrat financiare të pozicionit financiar, në Bilanc, apo në aneksin e llogarisë së rezultatit financiar, duhet të prezantohen elementët pasurorë dhe detyrimet me emrat e elementëve, jo me mbiemrat. **Në fillim duhet shpjeguar dhe prezantuar kryefjala, emri, pastaj funksioni, cilësia**, rrethanat apo karakteristikat e kryefjalës. Ne e kemi mundësinë që në termat e kontabilitetit, në rapport me segmentet e tjera të shoqërisë të prezantohemi në mënyrë dinjitoze.

2. Aktivet Biologjike, Standardi numër 13. Në rradhë të parë gjykojmë se aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncensionare mund të ishin në dy standarde të veçuara. Prezenca e standardit të aktiveve biologjike është një nevojë për shërbimet tona të kontabilitetit, nevojë e cila është evidentuar nga antarësia e Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë. Numri i bizneseve të organizuara, me trajtën e një shoqërie tregëtare, që ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën e aktiveve biologjike është rritur dhe ka tendencën të shtohet. Vetëm në periferi të Tiranës, numërohen rreth 76 biznese që ushtrojnë aktivitetin e mbarështrimit të gjedhit, të të imtave, të pularive dhe të prodhimit të vezëve, të grumbullimit dhe transformimit të priodukteve bujqësore dhe blegtorale. Ky standard, besoj se ndaj të njëjtin opinion me gjithë të pranishmit, plotëson një boshllëk që ka krijuar mungesa e kontabilitetit në këtë fushë në shkollat e larta në Shqipëri. Nga ana tjetër, trajtimi i aktiveve biollogjike është mjaft i cunguar. **Praktika e kontabilitetit, ka nevojë që në këtë standard të marrin përgjigje për pyetjet**: si do të trajtohen kalimet në kopenë themelore kategoritë në rritje të gjësë së gjallë? Si do të trajtohet dhe vlerësohet kostoja e produktit nga kategoritë që japin me shumë se një produkt (disa kategori japin dhe mbarështrohen për tre dhe katër produkte)? A amortizohen dhe si amortizohen kategoritë e kopesë themelore apo masivet drufrutore? Si do të trajtohen kontabilisht aktivet biologjike që kanë trajtën e aktiveve dekorative, fidanave për shitje, akuariumet, etj?

3. Marrëveshjet Koncensionare, Standardi numër 13. E vlerësojmë të dobishëm përfshirjen e marrëveshjeve koncensionare në standardet e reja. Në vendin tonë, **deri tani numërohen rreth 1865 marrëveshje koncensionare**, dhënë me shumicë në 15 vitet e fundit. Këtij numri nuk i janë shtuar **mbi 525 marrëveshje që kanë të bëjnë me statusin e personave të stimuluar në Turizëm**. Edhe këto marrëveshje janë të karakterit koncensionar, të cilat bazohen në veprimtarinë e stimuluar, akorduar me VKM, në përputhje me ligjin e kësaj fushe, i cili është abroguar në vitin 2009. Ndërkohë, këto subjekte, kanë në objektin e veprimtarisë së tyre tokën apo të drejtën e enfiteozës akorduar për 99 vjet nga shteti, kompanive dhe subjekteve që

kanë marrë në përdorim për ta zhvilluar tokën në bregdet, apo në zonat e tjera turistike, ashtu sikurse kanë marrë në koncension një burim ujor, një minierë, një kodër, një hidrocentral, një lagunë, një pasuri tjetër publike. Standardi duhet të sqarojë statusin kontabël të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet të sqarojë dhe shpjegojë qënien të amortizueshme apo jo të amortizueshme, duhet të saktësojë periudhën dhe trajtimin kontabël të derisotëm dhe trajtimin kontabël nga sot e tutje. Praktikat kontabël krijojnë raporte komplekse fiskale. Besoj se kjo tërheq vëmendjen e profesionistëve që punojnë në këta sektorë, por edhe të pronarëve të këtyre investimeve.

Literatura dhe referencat

- Direktiva e BE-së, për Kontabilitetin, (2013/34/EU), që zëvendëson Direktivat e Këshillit 78/660/EEC dhe 83/349/EEC (ish Direktiva 4^{të} dhe 7^{të} Ligjore e Kompanive),
- Konferenca ndërkombëtare për përmirësimin e raportimit financiar, REPARIS, 16 maj 2013,
- Rregullorja (CE) n°1606/2002 = SNRF + Opsionet e vendeve anëtare,
- Burimi: Komisioni Europian 3
- Kriza e vazhdueshme financiare dhe reforma për rritjen ekonomike të BE-së: Europa 2020,
- Ligji 9901, i ndryshuar, "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare",
- Ligji 8901, i ndryshuar, "Për Falimentimin",
- Ligjet: Për Konkurencën, Për Tregëtinë elektronike, Për Përgjegjësinë penale të personave Juridikë, etj, si dhe 7 Vendime të Këshillit të Ministrave,
- Ligji "Për Proçedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar,
- Akademia e Shkencave, Fjalor i termave financë-Bankë, ZAHO, DHUCI, PASHA
- Akademia e Shkencave, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe,
- KLSH, Konferenca shkencore Qershor 2016
- KKK, Faqja zyrtare, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe shtojcat: Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e rezultatit Financiar dhe shtojca të tjera,

Nga: Prof.Dr. Sherif BUNDO, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Erëza ARIFI, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

DOMOSDOSHMËRIA E MARRJES SË MASAVE PËR REDUKTIMIN E VEPRIMTARISË ANTROPOGJENE NË SISTEMIN LIQENOR TË PRESPËS

Liqenet e Prespës, krahas individualitetit të veçantë të spikatur të regjimit të tyre limniologjik, që karakterizohet nga një natyrë tipike malore karstike, shquhen njëkohësisht edhe për potencialin e lartë hidrik, si dhe për vlerat e veçanta e të rralla të biodiversitetit. Këto veçori kanë bërë të mundur që liqenet e Prespës të jenë pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kaskadës hidroenergjetike të lumit Drin, si dhe të përcaktuar edhe si zona të veçanta ekologjike me status ndërkombëtar.

Nga: Prof.Dr.Niko Pano,

Prof.Dr.Gudar Beqiraj, Akademik

Prof.Dr.Salvator Bushati, Akademik

Përmbledhje

Sistemi liqenor i Prespës shquhet për individualitetin e veçantë e të përsosur natyror, hidrografinë tipike karstike e tepër të komplikuar, potencialin e lartë hidrik, vlerat e larta të biodiversitetit të nivelit ndërkombëtar, peizazhin e bukur natyror, etj.

Në këtë kumtesë, paraqitet një vlerësim i përgjithshëm i aspekteve kryesore natyrore të sistemit hidrografik të Prespës, si dhe impakti i veprimtarisë së pakontrolluar antropogjene në këtë ekosistem.

Elementet e regjimit limniologjik të sistemit liqenor të Prespës, si bilanci ujor, nivelet e liqeneve, karakteristikat fiziko-kimike të ujërave, veçoritë hidrogjeomorfologjike të brigjeve dhe të truallit të liqeneve, janë analizuar në këtë kumtesë. Në mënyrë të posaçme evidentohen veçoritë hidrogjeologjike dhe roli i potencialit të fuqishëm hidrik nëntokësor të sistemit liqenor të Prespës, respektivisht Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe që tashmë janë komponentë të rëndësishëm përbërës hidrik të Kaskadës Hidroenergjetike të lumit Drin, respektivisht për 2 hidrocentrale të ndërtuar në Maqedoni (Glloboshica dhe Spile) si dhe 4 hidrocentrale të ndërtuara në Shqipëri (Fierzë, Koman, Vau i Dejës dhe Ashta).

Ndërkohë sistemi liqenor i Prespës vlerësohet gjithashtu edhe si një objekt i veçantë hidrografik i Pellgut të Mesdheut për vlerat e mëdha specifike natyrore për biodiversitetin e pasur dhe të shumëllojtë,

e cila ka bërë të mundur që ky sistem hidrografik të ketë Statuse Ndërkombëtare (Konveta Ramsar, Park Ndërkombëtar, Zonë e Ruajtur me Përparësi).

Impakti i veprimtarisë së pakontrolluar antropogjene në sistemin liqenor të Prespës është evidentuar kryesisht, duke marrë parasysh pasojat e lëndës së ngurtë aluvionale të lumit Devoll me volum 1,3 milion m^3 të depozituara në Prespën e Vogël gjatë viteve 1973-2000, kur ky liqen ishte pjesë përbërëse e skemës ujitëse të fushës së Korçës. Impakti i këtij depozitimi masiv aluvional ka ndikuar ndjeshëm në zvogëlimin e sipërfaqes ujore të liqenit të Prespës së Vogël deri në atë shkallë, saqë Shqipëria pothuajse të humbasë territorin e saj hidrik në këtë liqen, kënetëzimin e liqenit të Prespës dhe dëmtimin dhe tjetërsimin e biodiversitetit, si dhe dëmtime të sistemit hidrik, të qarkullimit të ujërave nëntokësore etj. Duke patur parasysh faktin e rëndësishëm se shqetësimet e mësipërme janë trajtuar në disa aktivitete shkencore si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, si dhe janë botuar, por ato nuk janë shoqëruar në shkallën e duhur me marrjen e masave përkatëse nga dikasteret përgjegjëse për zgjidhjen e tyre. Aktualisht kërkohet një përfshirje e planifikim adekuat dhe serioz i institucioneve përgjegjëse shtetërore për të fituar kohën e humbur në zgjidhjen e problemeve të mësipërme.

Fjalët kyçe: *Potencial hidrik nëntokësor, limnologji, hidrogjeologji, biodiversitet, aktivitet antropogjen*

Hyrje

Sistemi liqenor i Prespës i përbërë nga Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe ndodhen në Juglindje të Shqipërisë, në lartësinë 850m mbi nivelin e detit.

Liqenet e Prespës, krahas individualitetit të veçantë të spikatur të regjimit të tyre limniologjik, që karakterizohet nga një natyrë tipike malore karstike, shquhen njëkohësisht edhe për potencialin e lartë hidrik, si dhe për vlerat e veçanta e të rralla të biodiversitetit. Këto veçori kanë bërë të mundur që liqenet e Prespës të jenë pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kaskadës hidroenergjetike të lumit Drin, si dhe të përcaktuar edhe si zona të veçanta ekologjike me status ndërkombëtar.

Veprimtaria e pakontrolluar antropogjene për disa dekada radhazi ka dëmtuar së tepërmi sistemin liqenor të Prespës. Mirëpo, sado që aspekte të veçanta të kësaj veprimtarie të dëmshme ambientale në këtë sistem janë trajtuar në disa studime shkencore, ato nuk janë shoqëruar edhe me marrjen e masave të nevojshme nda dikasteret përkatëse, në drejtim të diagnostikimit dhe rikuperimit ambiental.

Duke evidentuar veçoritë kryesore natyrore të sistemit liqenor të Prespës si: I. hidrografia; II. Limnologjia; III. Hidrologjia; IV. Biodiversiteti; V. Veprimtaria antropogjene, në këtë artikull argumentohet domosdoshmëria e marrjes së masave të nevojshme për reduktim – mënjanimin e impaktit të veprimtarisë së pakontrolluar antropogjene në këtë

ekosistem të rëndësishëm hidrografik, me vlerë të madhe ekologjike dhe ekonomike.

Aktualisht kërkohet përfshirja e planifikuar dhe serioze e përgjegjësive të dikastereve të interesuara për të fituar kohën e humbur në drejtim të zgjidhjes së shqetësimeve të trashëguara dhe të paraqitura me kohë në lidhje me dëmtimin e sistemit liqenor të Prespës.

Baza teorike

Baza teorike e vlerësimit të individualitetit natyror të sistemit liqenor të Prespës ka shërbyer llogaritja e bilancit ujor të rrjetit hidrografik të këtij sistemi.

Në sistemin liqenor të Prespës, bilanci ujor mund të llogaritet vetëm duke patur parasysh strukturën specifike hidrografike të këtij sistemi i cili nuk ka emisar sipërfaqësor për shkarkimin e ujërave të tepërta të këtij bilanci, si lumi Buna në liqenin e Shkodrës ose lumi Drini i Zi në liqenin e Ohrit. Shkarkimi i ujërave të tepërta të sistemit liqenor të Prespës realizohet në rrugë nëntokësore, nëpërmjet burimeve të zonës si Shën Naun – Tushemisht – Drilon, që ndodhen në bregun JL të liqenit të Ohrit. Në këto kushte ekuacioni i bilancit ujor të sistemit liqenor të Prespës ka formën:

$$W_p = \left(W_R^p - W_A^p \pm V^p\right) \qquad (1)$$

W_R^p - vëllimi i ujit që grumbullohet në pellgun ujëmbledhës të liqenit të Prespës nga reshjet atmosferike

W_A^p - sasia e ujit që largohet nga sipërfaqja e pasqyrës së liqenit të Prespës nëpërmjet procesit të avullimit

V^p - sasia e ujit që mbetet ose largohet nga liqeni i Prespës për pasoja të ndryshimeve të niveleve për një interval të caktuar kohe - Δt

– Vëllimi i ujit W_R^p llogaritet nëpërmjet vartësisë:

$$W_R^p = \left(W_P^p + W_L^p\right) \qquad (2)$$

ku:

W_P^p - sasia e ujit që bie në sipërfaqen e përgjithshme të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Prespës, pa sipërfaqen e pasqyrës së liqenit

W_L^p - sasia e ujit që bie në sipërfaqen e pasqyrës së liqenit

– Vëllimi i ujit W_A^p llogaritet nëpërmjet vartësisë:

$$W_A^p = x_0^p \cdot \alpha_{0,1}\left(F_P^p - F_L^p\right) \qquad (3)$$

ku:

x_0^p - shtresa e reshjeve vjetore të rëna në pellgun ujëmbledhës

$\alpha_{0,1}$ - koeficienti i rrjedhjes

F_P^p - sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Prespës

F_L^p - sipërfaqja e pasqyrës së liqenit të Prespës

– Vëllimi i ujit W_L^p llogaritet nëpërmjet vartësisë:

$$W_L = x_{0,2} \cdot F_L^p \qquad (4)$$

ku:

$x_{0,2}$ - shtresa e reshjeve që bie në sipërfaqen e liqenit

F_L^p - sipërfaqja e pasqyrës së liqenit të Prespës

– Vëllimi i ujit V^p llogaritet nëpërmjet vartësisë:

$$V^p = E \cdot F_L^p \qquad (5)$$

ku:

E - shtresa e ujit që avullon

– Vëllimi i ujit V^p llogaritet nëpërmjet vartësisë:

$$V^p = \Delta H_L^p \cdot F_L^p \qquad (6)$$

ku:

ΔH_L^p - ndryshimi i niveleve të ujit në liqen

- $\Delta H_L^p = \left(H_{n+1} - H_n\right)$

Madhësia H_{n+1} dhe H_n, shënojnë nivelin e liqenit, përkatësisht para dhe pas intervalit të kohës për të cilën janë kryer llogaritjet e bilancit ujor.

F_L^p - sipërfaqja e pasqyrës së liqenit H_1

$$H_1^{'} = \frac{\left(H_{n+1} - H_n\right)}{2}$$

Duke vendosur vlerat përkatëse në ekuacionin (1) atëherë barazimi i bilancit ujor për liqenin e Prespës është:

$$W_P = \left\{\left[\alpha_{0,1} \cdot x_{0,1}^p \left(F_P^p - F_L^p\right)\right] - \left(E_L^p \pm \Delta H_L^p \cdot F_L^p\right)\right\}$$

Analiza e rezultateve

I. Hidrografia

Liqenet e Prespës, respektivisht Prespa e Vogël dhe Prespa e Madhe, renditen ndër liqenet kryesore të Gadishullit të Ballkanit. Rrjeti hidrografik i këtyre liqeneve grumbullon ujërat e një pellgu ujëmbledhës me sipërfaqe të përgjithshme prej F = 1404 km^2. Ky pellg ka një lartësi mesatare të territorit prej H = 1184 m mbi nivelin e detit, që flet për natyrë tipike malore të këtij pellgu.

Sipërfaqja e përgjithshme e pasqyrës së ujërave të këtij sistemi liqenor është S = 329 km^2 prej të cilave Prespës së Madhe i përkasin S_1 = 285 km^2 dhe Prespës së Vogël S_2 = 44 km^2. Meqenëse këto dy liqene e kanë lartësinë mesatare shumëvjeçare të nivelit të ujit të përafërt me njëri-tjetrin, rreth h = 850 m mbi nivelin e detit, është arritur në konkluzion se në këtë rast kemi të bëjmë në të vërtetë me një liqen të vetëm, por me një ndryshim se gjatë periudhës së lagët të vitit (X – V) kur nivelet janë të larta, të dy pjesët komunikojnë me njëra-tjetrën, duke formuar një të tërë, ndërsa gjatë periudhës së thatë (VI – IX) kur nivelet janë të ulëta, ato shkëputen, duke formuar kështu dy Prespat, respektivisht: Prespën e Madhe dhe Prespën e Vogël.

Për sa i përket shtrirjes gjeografike, liqenet e Prespës ashtu si edhe liqeni i Ohrit gjenden në anën lindore të Egjeut dhe i përkasin zonës ujëmbledhëse të detit Adriatik. Ky është një nga liqenet më të mëdhenj të grupit të liqeneve

Desaretik. Liqenet e Prespës shtrihen në kufijtë shtetëror të Shqipërisë, FYROM-it dhe Greqisë. Ai është një sistem liqenor tipik malor me thellësira relativisht të mëdha që arrin deri 54 m. Volumi i ujërave të këtij sistemi liqenor është V = 5,2 miliardë m^3 dhe vija rrethbregore është L = 151 km e gjatë.

Liqeni i Prespës është me origjinë tektonike karstike. Ai është formuar në miocenin e sipërm ose në pliocen. Brigjet e larta erozive kanë një zgjatje të përgjithshme prej L = 89 km, ndërsa brigjet e ulëta që shtrihen në trajtën e plazheve me përbërje të imta granulometrike kanë një zgjatje prej L = 61 km.

Liqeni Prespa e Vogël futet në territorin shqiptar deri në 5,75 km, ndërsa gjerësia luhatet nga minimum 125 m në Grykën e Ujkut, në skajin jugperëndimor të liqenit deri në 1500 m midis fshatrave Shuec dhe Buzë Liqeni.

Liqeni i Prespës së Vogël është më i cekët se sa Prespa e Madhe. Veçanërisht ai është më i cekët gjatë brigjeve me reliev relativisht të rrafshët. Në këto cekëtina ka një vegjetacion



ujor shumë të zhvilluar.

Fillimisht, në Prespë është formuar një liqen i vetëm. Ai u nda në dy pjesë nga sedimentet që ka sjellë gjatë mijëvjeçarit lumi Shën Greman, i cili rrjedh nga mali Vamis në Greqi. Këto dy liqene ndahen sot nga një rrip toke 3 km e gjatë dhe 1,2 km e gjerë, ku ndodhet kanali nëpër të cilin rrjedh uji nga liqeni i Prespës së Vogël në Prespën e Madhe.

Liqeni i Prespës së Vogël ka dy dalje sipërfaqësore: njëri në Grykën e Ujkut në skajin jug-lindor të liqenit, nëpërmjet kanalit të Ventrokut ka lidhje me lumin e Devollit, dhe i dyti në skajin veri-perëndimor të liqenit. Në Fig.1 paraqitet harta e pellgut ujëmbledhës të sistemit liqenor: "Ohri-Prespa e Madhe-Prespa e Vogël"

Fig. 1 Harta e pellgut ujëmbledhës të sistemit liqenor "Ohër – Prespa e Madhe – Prespa e Vogël"

Prespa e Vogël i përket strukturës hipsometrike. Zona e Prespës është kodrinore malore. Duke filluar nga rreth 850 m mbi nivelin e detit në fushën e Devollit, drejt liqeneve të Prespës fillojnë e ngrihen kodrat e Bitinckës me lartësi 962 m. Më në lindje fillojnë malet. Rreth Prespës së Vogël ka disa maja malesh të larta, nga veriu drejt jug-lindjes: Maja e Shqipes (1456,7 m), e Leskës (1318,8 m), e Kolamit (1214,7 m), e Osojës (1335,9 m), të cilat ndodhen në veri-perëndim të liqenit dhe Maja e Skërkaj (1238 m) dhe e Boskos (1385 m) në jug të liqenit. Rreth liqenit të Prespës së Madhe ka maja më të larta se ajo e Zonjës (2035,4 m),

si edhe disa të tjera më të ulëta si Maja e Golloçukës (1320 m), e Mandraved (1170,4 m), e Kushit (1342,3 m), e Podinjes (1131,1 m), e Breqinjas (1201,8 m) dhe e Kallogjerit (1480 m). Karakteristikë e zonës janë ndryshimet e mëdha të lartësisë së aleve brenda një largësie të vogël horizontale. Në këtë zonë vërehen shumë shpate malorë të mëdhenj, të cilët shpesh varen poshtë deri në brigjet e liqeneve. Këto shpate kanë lartësi në 10-100 m e deri 450 m.

Peizazhi i zonës është tipik karstik në pjesët ku shtrihen gëlqerorët: me gropa, mikroreliev të thepisur, me kanale dhe shpella e zgavra karstike.

Në përgjithësi mjedisi është *arid* dhe pa shumë vegjetacion. Por, në disa sektorë ka bimësi dhe pyje. Pyjet e dushkut të Majës së Zonjës, si edhe e majës së Kallogjerit dhe faqes së Osojës në Prespën e Madhe, si dhe Koria e Trenit (1267,9 m) në Prespën e Vogël i japin një bukuri shumë të madhe krahinës.

Për sa i përket ndërtimit gjeologjik liqenet e Prespës shtrihen rrëzë strukturës karbonatike të Malit të Thatë. Ky formacion karbonatik përfaqëson një horst të përbërë nga gëlqerorë të periudhës së trisikut të sipërm – jurasikut të poshtëm. Veprimi tektonik gjatë periudhave gjeologjike ka qenë intensiv dhe mbi gëlqerorët triasiko-jurasikë janë takuar, vende-vende, edhe gëlqerorë të kretakut të sipërm, si edhe depozitime flishore të moshës së eocenit të mesëm, të formuar rreth 30 milion vjet më parë. Në skajin veri-perëndimor të liqenit të Prespës së Madhe janë vendosur edhe depozitime të reja argjilo-ranore të Pliocenit, të formuar rreth 5,5 milion vjet më parë. Vende-vende, në brigjet e liqeneve të Prespës, atje ku ka kryesisht depozitime argjilo-ranore të pliocenit si dhe flishore të eocenit të sipërm, janë shtrirë edhe depozitime të shkrifta, argjila, suargjila, surëra, popla, zhure, çakëll të periudhës së kuaternarit të ri, të cilët vazhdojnë të vendosen edhe në ditët tona. Liqeni i Prespës së Vogël, në territorin shqiptar e ndërpret edhe një veçim shkëmbinjsh magnetikë ultrabazikë, të cilët kanë kontakte tektonike me gëlqerorët.

Depozitimet pliocenike janë terrigjene argjilo-ranore kontinentale, që tregon se janë grumbulluar në liqene ndërmalore e në deltat e lumenjve që janë derdhur në to. Ky fakt dëshmon se nën veprimin e neo-tektonikës, sipas lidhjeve kontraste të ngritjeve dhe të zhytjeve në brigjet e liqenit të Ohrit dhe të Prespës, u krijua depresioni ku janë sedimentuar depozitimet (Aliaj Sh. Etj. 1995). Këta liqene janë formuar gjatë pliocenit, këtu e rreth 5,5 milion vjet më parë, dhe ka përfunduar krijimi i tyre në kuaternar. Krahas kësaj, ekziston veprimtaria karstike. Nga të dy këto veprimtari, tektonika dhe karsti, u krijuan kushtet e përshtatshme për formimin e liqenit të Prespës.

Të gjitha shkëmbinjtë i janë nënshtruar një procesi intensiv erozioni. Me vitet, sasi e madhe e sedimenteve aluviale janë transportuar dhe depozituar në fundin e këtyre liqeneve. Ndërtimi gjeologjik i trevës është edhe faktori kryesor që kushtëzon qëndrueshmërinë e brigjeve të liqeneve të Prespës. Në kushtet kur në

brigjet e liqeneve zhvishen gëlqerorë, këto brigje janë të larta, vende-vende të thepisura. Veçanërisht në skajin jugperëndimor të Prespës së Vogël ka brigje të thepisur. Lartësia e këtyre brigjeve luhatet nga 10 deri 50 metra. Në shpatin verior të Grykës së Ujkut ndodhen shkëmbinjtë e Spilies, të cilët fillojnë nga bregu i liqenit e deri në lartësinë 1150 metra. Në këta shkëmbinj ka gremina me lartësi 10 m deri 50 m. Në të tjerë sektorë, shpatet ndodhen disa metra larg vijës së ujit, të ndarë nga ajo nga një rrip bregu zhavoror. Brigjet janë relativisht të paqëndrueshme në zonat ku shtrihen depozitime ranoro-argjilore të pliocenit, flishe të eocenit, si dhe depozitime të kuaternarit, e veçanërisht konuset e derdhjes, si në fshatrat Shuec dhe BuzëLiqeni. Dy fshatrat Shueci dhe Buzë Liqeni janë vendosur në brigje relativisht të rrafshët, çka shpjegohet me praninë e shkëmbinjve ultrabazikë të serpentizuar. Në brigjet e të dy liqeneve ka kone të derdhjes së përrenjve, të cilët gjatë verës janë të thatë.

II. Limniologjia

Liqeni i Prespës karakterizohet nga një regjim i veçantë dhe i komplikuar limniologjik për shkak të shtrirjes së tij në brendësi të Gadishullit të Ballkanit dhe i lartësisë së madhe mbi nivelin e detit. Elementet kryesorë të këtij regjimi janë: a) Klima; b) Tektonika e ujërave; c) Nivelet; d) Stratifikacioni dhe përzierja vertikale.

a) *Klima*

Sipas rajonizimit klimatik të Shqipërisë (Monografia: “Klima e Shqipërisë”, botim i Akademisë së Shkencave, 1985), pellgu ujëmbledhës i liqenit të Prespës shtrihet në zonën klimatike Mesdhetare Malore (respektivisht rajoni IVc). Por në këtë pellg një ndikim të madh ka edhe klima kontinentale. Si rrjedhojë kjo zonë në përgjithësi karakterizohet nga dimra të ftohtë dhe të zgjatur dhe verë relativisht të nxehtë me kontraste të temperaturës së ajrit dhe të sasisë së reshjeve atmosferike.

Parametrat kryesorë hidroklimatik janë: Radiacioni diellor; Temperaturat e ajrit; Lagështia e ajrit; Reshjet atmosferike dhe Era.

Radiacioni diellor është një nga komponentët kryesore të bilancit termik. Pellgu i liqenit të Prespës karakterizohet mesatarisht nga 2318 orë me diell/vit.

Temperatura e ajrit varion nga t_a = 1,2^{0}C në Janar që është muaji më i ftohtë i vitit deri t_a = 18^{0}C në gusht që është muaji më i ngrohtë, duke patur një mesatare vjetore prej t_a = 10,6^{0}C.

Lagështia e ajrit varion nga ℓ_0 = 78% në muajin janar deri në ℓ_0 = 55% në gusht, duke patur një mesatare vjetore prej ℓ_0 = 68%.

Reshjet atmosferike variojnë përkatësisht nga X_0 = 26 mm në korrik deri X_0 = 71 mm në nëntor, duke patur një mesatare vjetore prej X_0 = 57,2 mm.

Era Shpejtësia e erës varion nga v = 0,9 m/s në muajin dhjetor deri v = 2,3 m/s në

muajin qershor, duke patur një mesatare vjetore prej v = 1,8 m/s.

Bilanci ujor i sistemit liqenor të Prespës mund të llogaritet duke patur në konsideratë strukturën specifike hidrografike të këtij sistemi, i cili siç dihet nuk ka emisar sipërfaqësor të këtij bilanci, siç është lumi Buna në liqenin e Shkodrës, ose Drini i Zi në liqenin e Ohrit. shkarkimet e ujërave të tepërta të sistemit liqenor të Prespës realizohet në rrugë nëntokësore.

b) Termika e ujërave

Veçoritë termike të ujërave të Prespës përcaktohen nga shkalla e ndikimit të kushteve fiziko-gjeografike të territorit, kryesisht nga struktura hipsometrike dhe regjimi klimatik.

Ujërat e liqenit të Prespës janë veçanërisht të ftohta gjatë periudhës së dimrit sepse ky liqen nga pikëpamja hipsometrike jo vetëm që ndodhet në një lartësi të madhe, por edhe duke qenë një liqen relativisht i cekët, ujërat e tij gjatë kësaj periudhe përzihen dhe i nënshtrohen një procesi intensiv ftohjeje. Si rrjedhojë e temperaturave të ujërave të liqenit të Prespës gjatë periudhës së ftohtë të vitit zbret deri në 0^0C, ndërsa në kushte të veçanta dhe kryesisht gjatë ngjarjeve të jashtëzakonshme atmosferike, si ajo e muajit shkurt të vitit 1928, sipërfaqja e liqenit ngriu në një trashësi prej disa centimetra, kryesisht kjo gjatë zonës së tij bregliqenore. Në liqenin e Prespës temperatura mesatare e ujërave të këtij liqeni lëkundet nga $t_w = 3,7^0 C$ në muajin shkurt deri $t_w = 22,4^0 C$ në gusht, duke patur një mesatare vjetore prej rreth $t_w = 17,3^0 C$.

c) Nivelet

Gjatë periudhës shumëvjeçare 1947-90, nivelet relative të ujit të liqenit të Prespës kanë ndryshuar përkatësisht nga H = 111 cm në muajin nëntor deri H = 165 cm në muajin qershor, duke patur një mesatare vjetore H = 136 cm. Gjatë kësaj periudhe, amplituda maksimale e lëkundjeve të niveleve të liqenit të Prespës ka qenë A = 3,5 m. Mirëpo, duke filluar nga viti 1989 është evidentuar një ulje e niveleve të liqenit të Prespës së Madhe me një ritëm mesatar 80 cm në vit (N. Meçaj 1999). Për shkaqet e kësaj dukurie të rëndësishme e shqetësuese, nuk ka ende ndonjë shpjegim të plotë e të argumentuar shkencërisht. Sipas studiuesit grek Katsadorakis, kjo ulje është pasojë e veprimtarisë së tërmeteve (Katsadorakis et al. 1996).

d) Strafikacioni dhe përzierja vertikale

Meqenëse liqeni i Prespës ka thellësira jo shumë të mëdha, i gjithë volumi i ujërave të këtij liqeni i nënshtrohet procesit të përzierjes vertikale, nga sipërfaqja deri në truallin e tij.

Gjatë periudhës së ngrohtë të vitit, për shkak të bilancit termik pozitiv, zona epilimnione e liqenit të Prespës është e përbërë nga shtresa të veçanta ujore të vendosura njëra mbi tjetrën me veçori të ndryshme fiziko-kimike. E kundërta ndodh gjatë periudhës së ftohtë të vitit si rrjedhojë e largimit të nxehtësisë nga liqeni për në atmosferë nëpërmjet

procesit të nxehtësi-këmbimit, dendësia e ujërave të shtresave sipërfaqësore të këtij liqeni zmadhohen. Kur ky zmadhim arrin deri në ato përmasa saqë stratifikacioni ose qëndrueshmëria e shtresave sipërfaqësore bëhet baras ose pak më i madh se ai i shtresave më të thella të këtij liqeni, prishen kushtet e stratifikacionit vertikal dhe shtresat ujore të liqenit të Prespës i nënshtrohen procesit të përzierjes konvektive vertikale. Përzierja e përvitshme vertikale bën të mundur që në liqenin e Prespës të realizohet një ventilim i plotë i volumit ujor të tij. Në këto kushte, ujërat e liqenit të Prespës që furnizojnë liqenin e Ohrit nëpërmjet rrugës nëntokësore shquhen për uniformitet e njëtrajtshmëri në veçoritë e tyre fiziko-kimike.

Në Fig. 2 paraqitet shpërndarja vjetore e elementeve kryesorë të regjimit limniologjik të liqenit të Prespës: x_0 – reshjet atmosferike (në mm), temperatura e ajrit – t_a (në ^{0}C) dhe niveli i ujit – H (në cm).



Fig. 2 Shpërndarja vjetore e elementëve kryesorë të regjimit limniologjik.

x_0 – reshjet atmosferike (në mm), temperatura e ajrit – t_a (në ^{0}C) dhe niveli i ujit – H (në cm)

III. Hidrologjia

Regjimi hidrologjik i rrjetit hidrografik të sistemit liqenor të Prespës është trajtuar nëpërmjet marrjes parasysh të dy komponentëve kryesorë përbërës të këtij sistemi që janë: Rrjeti lumor dhe Burimet e ujërave nëntokësore.

1) Rrjeti lumor.

Afluentët kryesorë që derdhen në liqenin e Prespës janë: lumi Goleme, Istoçna, Kranska dhe Brajnica në FYROM. Në liqenin e Prespës derdhin ujërat e tyre edhe disa lumenj të tjerë më të vegjël dhe përrenj që ndodhen në territorin e Shqipërisë dhe të Greqisë.

2) Rrjeti i burimeve

Krahina e Prespës është e pasur me resurse të ujërave nëntokësore, të cilat lidhen edhe me ekzistencën e dy liqeneve të Prespës si edhe me infiltrimin e ujërave të reshjeve atmosferike në masivin e karstëzuar karbonatik të malit të Thatë.

Në rrëzën perëndimore të malit të Thatë, duke filluar nga zona e Progrit dhe më në veri deri në Tushemisht të Pogradecit, ndodhen një sërë burimesh karstike. Prurjet e tyre kushtëzohen nga rrugët karstike nëntokësore. Prurje më të mëdha, rreth 500-600 l/sek, kanë patur tre burime Golloborde-Mançurishtë-Progër. Më në veri, pothuajse rregullisht në largësi 2 km njëri nga tjetri shtrihen burime ose grupe burimesh me debit rreth 1 deri 100 l/sek, ndërsa në veri në burimet e Tushemishtit, në bregun e liqenit të Ohrit, prurja arrin deri 2500 l/sek. Karakteristikë e burimeve karstike

është vendosja e tyre në lartësi pothuajse të njëjtë mbi nivelin e detit, duke filluar nga 830 m deri në 930 m. Burimi i Ventrokut, tek stallat e Grykës së Ujkut ka patur prurje 13,8 l/sek. Nën nivelin e Prespës së Vogël ose në të njëjtin nivel, ndodhen burimi Nr.1 dhe Nr.2 tek stallat e Maçurishtit, burimi i Progrit, si dhe ai në rrëzë të Kodrës së Hardhisë në Zvezdë. Burime nëntokësore uji, me debite të vogla, ka edhe në drejtim jugor nga liqeni i Prespës së Vogël, të cilët ndodhen në kuota më të larta sesa niveli i liqenit të Prespës së Vogël.

Studimet hidrogjeologjike izotopike kanë vlerësuar se burimi i Progrit dhe ata të Maçurishtës kanë përmbajtje izotopike pothuajse të njëjtë dhe në raporte si të ujërave të liqenit të Prespës. Kjo dëshmon për ushqimin e tyre edhe nga ujërat e liqenit të Prespës së Vogël (R. Eftimi, 1996).

Në fushën e Devollit dhe të Korçës shtrihen pellgjet ujëmbajtës artezianë. Horizonti i tyre ujëmbajtës përbëhet nga rëra dhe zhavorr të kuaternarit, të tarracave të lashta të lumenjve, të cilat janë të mbuluara nga shtresa argjilore të papërshkueshme.

Element i rëndësishëm i rrjetit hidrografik të liqenit të Prespës është edhe sistemi nëntokësor i shkarkimit të ujërave të tepërta të bilancit ujor të tij. Ky sistem hidrogjeologjik është i përbërë nga një numër i madh të çarash, ponorash, zgavrash dhe shpellash karstike të cilat ndodhen si në brigjet ashtu edhe në truallin e këtij liqeni. Nga këto, më i rëndësishmja është Ponora e Zaverit monument natyre e cila ndodhet në bregun JP të liqenit të Prespës, në afërsi të fshatit Goricë. Ujërat e tepërta të bilancit ujor të liqenit të Prespës, me një prurje mesatare vjetore prej rreth Q_0 = 12-16 m^3/s shkarkohen nëpërmjet rrugës nëntokësore në liqenin e Ohrit, i cili ndodhet 157 m më poshtë.

Shkarkimi i ujërave të Prespës në liqenin e Ohrit, realizohet kryesisht nëpërmjet burimeve Shën Naum-Tushemisht-Drilonit të cilët ndodhen në brigjet JL të këtij liqeni.

Në Fig. 3 paraqitet shpërndarja vjetore e elementeve të bilancit ujor të liqenit të Prespës: Q_0 – Rrjedhja ujore (në m^3/s); E_0 – Avullimi (në cm); H – Nivelet (në cm); X_0 – Reshjet (në mm).



Fig. 3 Shpërndarja vjetore e elementeve të bilancit ujor të liqenit të Prespës: Q_0 – Rrjedhja ujore (në m^3/s); E_0 – Avullimi (në cm); H – Nivelet (në cm); X_0 – Reshjet (në mm).

IV. Biodiversiteti

Biodiversiteti i Prespës së Vogël dhe zonës përreth është shumë i pasur (Bega F. 2000, Bino T. 2000, Qosja Zh. 1979, Shumka S. 2000, Rakaj N. 2000). Flora e zonës përfaqësohet nga 71 lloje drurësh dhe shkurresh, si edhe bimë ujore. Ndër

përfaqësuesit e florës ujore mund të përmenden Caratophyllum sp., Myriophyllum sp., Lemna Minor, Trapa Natans, Nymphaea Alban etj. Midis drurëve dallohen Querqus Cerris, Querqus Pubescens, Querqus Petrea, Fagus Silvatica, Oatria Caprinifolia, Fracinus Ornus, Carpinnus Betulus, Acer Pseudoplantanus, Pinus Nigra, Abies, Ingland Regia, Castanea Sativa, Corulys, Juniperus, etj. Në Prespë klasa Salicetea purpurta përfaqëson formacione kaçubore ose dhe drurore të shelgjeve në mjedise të përmbytura ujore. Fauna e liqenit Prespa e Vogël shquhet për praninë e peshqve të rrallë si Rutilus prespensis, Chordrostoma prespensis, Bafbus prespensis, Cyprinus carpio, Salmotrutta perstericus, etj. Pelikani kaçurrel (Pelecanus crispus Bruch), që njihet edhe me emrin laradash, jeton edhe në liqenet e Prespës ku ushqehet kryesisht me peshk. Ai mbrohet si shpend i rrallë. Pelecanus onoctotalus, Pholacrocorax pygmeus, Ardea purpures, Plegadis falcinellus, Egretta alba janë përfaqësues të tjerë të zogjve. Ka edhe shumë kafshë në këtë treve, si Canis lupus, C. aureus, Lutra lutra, Felix silvestris, Meles meles, Uesus arctos, etj.

Midis tri liqeneve të Ohrit dhe dy të Prespës, Prespa e Vogël ka veçorinë se është me tri statuse ndërkombëtare. Nga viti 1957, pellgu i këtij liqeni është shpallur Park Kombëtar, në përputhje me Konventën Ramsar dhe njihet si hapësirë me rëndësi ndërkombëtare dhe zonë speciale e mbrojtur (79/409/EEC) si hapësirë e rëndësishme për shpendët (ICBP-IVVRB). Ky liqen është një objekt i rëndësishëm limniologjik, jo vetëm për potencialin e madh hidrik, por edhe për vlerat e larta dhe specifike ekologjike që ka.

Pamje nga Liqeni i Prespës

V. Veprimtaria antropogjene

Shqipëria, Greqia dhe Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, të cilave u përkasin liqenet e Prespës, krahas interesit të përbashkët për ruajtjen e biodiversitetit kanë edhe interesat e veta specifike hidro-ekonomike në nivel kombëtar, në të cilat përfshihen: prodhimi i energjisë elektrike, ujitja, zhvillimi i industrisë së peshkimit, i eko-turizmit etj. Deri tani, nga të tri shtetet kufitare, përdorimi hidro-ekonomik i pellgut ujor të liqenit të Prespës ka patur karakter shumë sporadik dhe krahinor, që është diktuar nga strukturat përkatëse politike dhe sociale të secilit vend. Në rrugën e shfrytëzimit të pasurive ujore të këtij sistemi nuk ka patur ndonjë marrëveshje midis shteteve, bilaterale ose disa paleshe, madje as në nivelet e ulëta rajonale. Kjo praktikë ka lejuar veprimtari njerëzore të pakontrolluara dhe të pakoordinuara, të cilat në mënyra të

ndryshme kanë dëmtuar vlerat e veçanta natyrore të sistemit liqenor: Prespa e Vogël – Prespa e Madhe. Kësisoj, mungesa e planeve për veprimet përkatëse si dhe të platformave për bashkëpunimin shkencor dhe ekonomik të bazuar në Aktet e Ligjshmërisë ndërkombëtare, ka dëmtuar në një farë shkalle krijimin e hapësirës së nevojshme për shfrytëzimin kompleks dhe integral të pasurive ujore të këtij sistemi liqenor, për qëllime hidro-ekonomike, duke ruajtur ekuilibrin ekologjik, aq më tepër kur këto mjedise janë me vlera ndërkombëtare.

Për rrjetin hidrografik të sistemit liqenor të Prespës nuk disponohet informacioni i nevojshëm për vlerësimin e shkallës së shfrytëzimit të potencialit ujor të këtij sistemi për interesa hidro-ekonomike nga secili shtet përkatës kufitar.

Në Shqipëri gjatë periudhës 1976-2000, liqeni i Prespës së Vogël u përfshi si element përbërës dhe i rëndësishëm i skemës ujitëse të Fushës së Devollit e Fushës së Korçës. Në përputhje me këto skema ujitëse nëpërmjet një kanali të posaçëm me prurje $Q_0 = 10\ m^3/s$, translokoheshin e depozitoheshin në liqenin e Prespës së Vogël, nga lumi Devoll, një volum për rreth 90 milion m^3 ujë gjatë periudhës së lagët të vitit (X – V). Ky volum ujor, gjatë periudhës së thatë të vitit (VI – IX) rimerrej dhe shfrytëzohej për ujitjen e tokave bujqësore. Pjesa përbërëse e translokimit të ujërave të lumit Devoll për në liqenin e Prespës së Vogël ishte dhe ndërtimi i një dekantori të posaçëm i cili do të shërbente për frenimin e lëndëve të ngurta aluvionale, para se ujërat e lumit Devoll të depozitoheshin në këtë liqen. Mirëpo siç mund të shihet edhe nga përbërja e imët granulometrike e aluvioneve të ngurta të lumit Devoll, ato nuk janë ndaluar nga dekantuesi. Në këto kushte vetë liqeni i Prespës së Vogël ka luajtur rolin e një dekantuesi gjigant natyror. Studimet e kryera kanë treguar se në Prespën e Vogël janë akumuluar rreth 1,2 milion m^3 aluvione lumore në brigjet dhe truallin e këtij liqeni, duke cenuar në mënyrë drastike vlerat e tij natyrore që janë dëmtuar dhe tjetërsuar, të biodiversitetit, dëmtim të sistemit hidrografik karstik të liqenit të Prespës së Vogël në territorin shtetëror shqiptar, dëmtime të monumenteve natyrore dhe kulturore shqiptare siç është shpella e Trenit etj.

Konkluzione

1. Nëpërmjet evidentimit të veçorive kryesore natyrore të sistemit liqenor të Prespës si: Hidrografi, Limniologjia, Hidrologjia, Biodiversiteti dhe veprimtaria antropogjene argumentohet domosdoshmërisht marrja e masave të nevojshme për mënjanimin e impaktit të veprimtarisë së pakontrolluar antropogjene në këtë ekosistem të rëndësishëm hidrografik me vlera të mëdha ekologjike dhe hidro-ekonomike.

2. Kërkohet përfshirja e planifikuar dhe serioze e dikastereve të interesuara dhe përgjegjëse për të fituar kohën e humbur në drejtim të zgjidhjes së shqetësimeve të trashëguara dhe të paraqitura shkencërisht me kohë në lidhje me dëmtimin e sistemit liqenor të Prespës.

3. Në programet dhe projektet si kombëtare dhe ndërkombëtare për biodiversitetin e sistemit liqenor të Prespës krahas punës së mirë që është bërë deri tani për trajtimin e parametrave me natyrë biotike të këtij sistemi, të mund të përfshihen gjithashtu edhe studimi i parametrave abrotikë ku do të mund të gjenin zgjidhje edhe shqetësimet e paraqitura në këtë punim.



Foto. Akumulimi i aluvioneve të ngurta të lumit Devoll në liqenin e Prespës së Vogël

Literatura

Pano N. – Pasuritë ujore të Shqipërisë. Botimi i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2015

Pano N. etj. – Hidrologjia e Shqipërisë. Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2015

Pano N. – Hidrologjia e lumit Drini i Zi për aksin e Skavicës. TGK – Goup, Milano 2009

Pano N., Frashëri A., Frashëri N., Beqiraj G., Bushati S. – A review of human activity and the demages to the micro Prespa Lake. Published by the Academy od Science of Albania. JNTS, vol XIX (2) Tiranë 2014.

Nga: Prof.Dr.Niko Pano,

Prof.Dr.Gudar Beqiraj, Akademik

Prof.Dr.Salvator Bushati, Akademik

MORATORIUMI PËR KONCESIONET DHE PPP-TË - NEVOJË E KOHËS...

"Nën një sistem koncesioni shteti i jep një ekskluziviteti të drejtën për të financuar, për të ndërtuar, për të marrë në pronësi, për të operuar, dhe për të mirëmbajtur një infrastrukturë publike për një periudhë kohe të caktuar, dhe për të ngarkuar përdoruesit për këtë shërbim"[1].

Nga: Dr. Zef Preçi

Qëndra Shqiptare për Kërkime Ekonomike

Për koncesionet dhe format e ndryshme të tyre duke përfshirë së fundi edhe partneritetin publik-privat është folur dhe shkruar shumë sidomos mbas vitit 2000. Siç dihet, koncepti i marrëveshjeve të koncesionit jepet në shumë përkufizime, por të gjithë duket se flasin për të njëjtat çështje. "Nën një sistem koncesioni shteti i jep një ekskluziviteti të drejtën për të financuar, për të ndërtuar, për të marrë në pronësi, për të operuar, dhe për të mirëmbajtur një infrastrukturë publike për një periudhë kohe të caktuar, dhe për të ngarkuar përdoruesit për këtë shërbim"[1].

Është një fakt i njohur se qeveritë shqiptare të pas vitit 1991 janë ndeshur në mënyrë të vazhdueshme me kufizimet në burimet e financimit për zbatimin e programeve të veta politiko-qeverisëse. Kjo ka ndodhur në kushtet kur infrastruktura e trashëguar nga periudha e ekonomisë së centralizuar ka qenë vjetruar dhe e paaftë që t'ju përgjigjet kërkesave të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Domethënë nëse në infrastrukturën "soft" siç është kuadri rregullator dhe institucional për funksionimin e ekonomisë së tregut ka qenë e pranishme mbështetja e gjerë e BE-së dhe SHBA-së, në infrastrukturën

[1] *Shih: http://schwarzlaw.ca/the-need-for-concession-laws-in-developing-countries/*

"hard" (fizike) si dhe për futjen në qarkullimin ekonomik të pasurive natyrore strategjike të vendit ka qenë e nevojshme që të kërkohen e të gjenden burime të tjera financiare. Por është një fakt i njohur se në Shqipëri, ashtu si dhe në vendet e tjera në zhvillim në përgjithësi kanë munguar e mungojnë jo vetëm burimet financiare, por edhe përvoja operacionale për të ndërmarre programe zhvillimore me përfshirjen e sektorit privat. Kjo situatë ka bërë që investitorët private perëndimor të kenë patur rol përcaktues si në përzgjedhjen e formës së koncesionit, ashtu edhe në injorimin apo mosrespektimin e një sërë kushtesh që lidhen me përmbushjen e detyrimeve ndaj punëtoreve që humbasin vendet e punës për efekt të ristrukturimit të fuqisë punëtore, etj. Ndërkaq vitet e fundit qeveria ka tentuar gjerësisht të mbështetet në "partneritetin publik-privat", gjë që është sanksionuar edhe në programin e saj politiko-qeverisës.[2]

Qëllimi i këtij shkrimi është analiza e problemeve që kanë dalë në procesin e thithjes së investimeve të huaja në formën e koncesioneve ose/edhe të përfshirjes së operatorëve ekonomike private në ofrimin e shërbimeve të ndryshme publike.

Mbi bazën e kësaj analize, si dhe të ballafaqimit të gjendjes aktuale të koncesioneve të Shqipërisë me përvojën edhe problemet që kanë dalë në procesin e zbatimit të kontratave të koncesioneve në vende të ndryshme të botës, sidomos atyre të Bashkimit Evropian, në vijim do të sillen disa argumente në favor dhe kundër një moratoriumi në mundësimin e kontratave të reja koncesionare dhe të partneriteteve publike- private.

Nga një analizë e ecurisë që kanë patur koncesionet[3] në ekonominë shqiptare gjatë periudhës mbas vitit 1991 dhe sidomos mbas vitit 2000, mund të evidentohen një sërë problemesh, natyrisht pa qenë shteruese. Ndër to mund të përmendim:

1. **Afatet e miratimit të kontratave koncesionare dhe afatet e zbatimit të koncesioneve.** Të dhënat tregojnë se në fillimet e viteve 2000, mbi bazën e një kuadri ligjor të mangët e në mungesë të përvojës përkatëse apo "rasteve të suksesshme", negociatat për kontratat koncesionare në burime të rëndësishme natyrore si kromi, etj., kanë zgjatur me vite, ndërsa periudha e operimit të koncesionit ka qenë e kufizuar në 20-25 vjet maksimumi. Kjo situatë ka ndryshuar me kalimin e kohës dhe nën presionin e koncesionarëve, një numër kontratash koncesionare janë miratuar thuajse fare pa debat në Kuvendin e

2 http://www.akti.gov.al/dokumenta/programi_qeverise_2013_2017.pdf, fq.31

3 Për arsye metodologjike, analiza do të bazohet në burime të hapura, dhe do të citohen vetëm emrat e kompanive që vijnë nga burime të referueshme, dmth nga raporte të njohura të të tretëve.

Shqipërisë, janë miratuar me urgjencë dhe përfshijnë periudha shumë të gjata kohore, domethënë janë duke u prezantuar në kontrata koncesionare me deri edhe 99 vjet. Domethënë jo vetëm nuk është respektuar principi i respektimit të ciklit të biznesit por kontratat janë ndërtuar në një mënyrë të tillë që vendos palën e huaj/investitorin në një pozitë të privilegjuar sa i takon biznesit dhe nxjerrjes së fitimeve nga aktiviteti, por edhe në atë juridike, domethënë kontratat "janë blinduar" juridikisht me qëllim që të pamundësohet shqyrtimi ligjor procedural apo në përmbajtje në periudhat që vijnë.

2. I**nvestimet, pamundësia e kontrollit të zbatimit të projekteve**. Në morinë e problemeve që kanë lindur nga zbatimi i kontratave koncesionare në vendin tonë, sidomos gjatë dekadës së fundit, padyshim madhësia e investimeve/vlera e deklaruar zyrtarisht e tyre mbetet "çelësi" që ka garantuar jo vetëm pozitën e privilegjuar të investitorit në raport me palën shqiptare, por edhe "mekanizmi" përmes të cilit janë injoruar e pse jo edhe janë cënuar në disa raste rëndë interesat e ekonomisë kombëtare shqiptare. Në vlerësimin tim, çmoj së kështu ka ndodhur në një numër investimesh koncesionare në energjetike, në nxjerrjen dhe në shfrytëzimin e naftës, etj. Rasti me i fundit është çështja e pretendimeve të autoriteteve fiskale shqiptare mbi shpenzimet e fryra të raportuara nga kompania më e madhe e nxjerrjes së naftës shqiptare dhe "humbja me nder" prej tyre e këtij rasti, ndonëse ka dyshime të arsyeshme se nëse ndërmerret një hetim i thelluar administrativ, kompania në fjalë nuk mund të provojë se ka investuar milionat e deklaruara si investime, ashtu sikurse dyshohet se gjatë gjithë veprimtarisë së saj në vendin tonë, ka qenë e lidhur me rrjete të caktuara politike përmes ndikimit prej këtyre të fundit në përzgjedhjen e kompanive vendase apo të huaja të shërbimit. Pra dyshohet edhe për korrupsion në nivel politik, por që organet ligj-zbatuese nuk ofrojnë asnjë evidencë në mbështetje të këtij përfundimi. E vetmja evidencë, në gjykimin tim, është tolerimi që organet fiskale dhe ato ligj-zbatuese ju kanë bërë koncesionarëve të tillë, gjë që ka çuar në borxhe tatimore prej dhjetëra miliona Eurosh a më shumë, si dhe fakti se edhe mbas zbulimit të këtyre borxheve, nuk ka patur asnjë ndëshkim në nivel drejtuesish të njësive përkatëse monitoruese e mbikëqyrëse - përgjegjëse për nxjerrjen e detyrimeve tatimore si kundrejt çdo investitori apo koncesionari/biznesi tjetër në Republikën e Shqipërisë.

3. **Mungesa e transparencës rreth përmbajtjes së kontratave**

koncesionare. Është një fakt i njohur që shumë raporte kërkimore, raporte studimesh apo raporte mbi rezervat e burimeve natyrore, vend-ndodhjen e tyre, projektet fillestare teknike, ekonomike, etj., janë keqadministruar gjatë çerek shekullit të fundit. Kjo si për shkak të dobësimit të zbatimit të ligjit dhe të ndryshimeve të shpeshta në drejtimin e institucioneve politike atyre të vartësisë të ministrive përgjegjëse për këto burime, ashtu edhe për shkak të zvogëlimit të interesit të qeverive për mirë-menaxhimin e burimeve natyrore të vendit, për trajtimin e tyre si mjet për rritjen e punësimit dhe për reduktimin e varfërisë, për shtimin e prodhimit vendas dhe të eksporteve shqiptare mbi këtë bazë. Në ketë proces mendoj se themelore mbetet rritja e interesimit të lobeve të biznesit vendas dhe të huaj në drejtim të shfrytëzimit në kushte të favorshme të këtyre burimeve, por edhe përdorimi i burimeve natyrore si mjet për sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme për elitën politike drejtuese të radhës. Kjo shpjegon faktin se me gjithë ndryshimin e maxhorancave të qeverisë - një rotacion ky që është kryer përherë e më normalisht, përveç zhurmës në periudhën e fushatës zgjedhore, nuk kemi asnjë evidencë për amendime ligjore apo institucionale që lidhen me kontratat koncesionare e që do të çonin në përmirësimin e administrimit të burimeve natyrore, pra në shtimin e të ardhurave që derdhen në buxhetin e shtetit nga këto burime. Përkundrazi, kemi të bëjmë me një "proces shembullor vijimësie", madje edhe në raste flagrante siç ishte rasti i kontratës së skanimit të kontejnerëve në dogana, që u ratifikua nga dy maxhoranca qeverisëse të njëpas-njëshme dhe që ishte objekt kritikash dhe thirrjesh për abrogim si një marrëveshje ndërkombëtare në dëm të interesave publike dhe të procesit të integrimit Evropian të vendit deri edhe nga Departamenti i Tregtisë Ndërkombëtare i OKB-së[4].

4. **Dobësitë e institucioneve monitoruese e mbikëqyrëse të veprimtarisë së kompanive koncesionare**. Një problem më vete përbejnë edhe dobësitë e institucio-neve monitoruese e mbikëqyrëse të veprimtarisë së kompanive koncesi-onare. Këto institucione karakteri-zohen nga paqëndrueshmëria nga pikëpamja funksionale e tyre, nga lëvizjet e shpeshta të stafit, nga lëvizja herë më pranë e herë më larg nga zyra

[4] *"Tarifa paguhet edhe kur ngarkesa nuk skanohet, e madje edhe në pikat doganore ku nuk ka fare skanera të instaluar. Kjo është një praktikë e papranueshme. Ajo krijon një taksë efektive, e cila nuk është bazuar në ligj, ndaj duhet të hiqet". Per me shume, shih: http://fronti.al/portali/okb-i-kerkon-qeverise-shqiptare-te-heqe-skanimin-doganor/*

e kryeministrit të radhës, por gjithnjë nën një kontroll të rreptë të tij ose/edhe të stafit të këshilltarëve, dhe përgjithësisht pak ose aspak nën autoritetin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Për më tepër, me gjithë përpjekjet e institucioneve financiare ndërkombëtare për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e këtyre institucioneve, përsëri ato gjenden pa ndonjë model të ndërtimit institucional të tyre, jashtë çdo vendimmarrjeje të rëndësishme në fushën e koncesioneve, në kushtet e mungesës së transparencës së veprimtarisë dhe raportimit përkatës, etj. Duhet përmendur si pozitiv fakti se vitin që shkoi qeveria vendosi më në fund të hartojë një regjistër të koncesioneve[5], por që regjistri në fjalë ende nuk është aktiv dhe asnjëri nuk mund të thotë se kur ky instrument i rëndësishëm për një "qeverisje të mirë" të pasurive publike do të jetë aktiv dhe në dispozicion të palëve të interesuara.

5. **Ndikime mjedisore të pakontrolluara**. Pavarësisht faktit se investimet private, e ndër to koncesionet shumëvjeçare në sektorin e prodhimit të energjisë me bazë ujin ofrojnë rreth 1/4 e energjisë elektrike që konsumon ekonomia shqiptare aktualisht, problemet mjedisore të ndodhura për këtë shkak janë mjaft të mprehta. Ato shtrihen që nga dëmtimi i pamjes/bukurive natyrore te shkeljet e legjislacionit për ndërtimet në zonat e mbrojtura dhe në parqet kombëtare, deri në prishjen e eko-sistemeve, pengimin e sigurimit të ujit të pijshëm në nivele të mjaftueshme dhe për ujitjen e tokave bujqësore. Por problemi më i madh në këtë sektor duket se është fiksimi në kontratat koncesionare i çmimit të blerjes së energjisë që prodhohet nga ana e entet publike, në kundërshtim si më modelin e tregut, ashtu edhe duke injoruar ligjësitë e këtij tregu, pa folur për spekulimet e dyshuara të disa investitorëve të mëdhenj lidhur me shumën e investimeve të kryera.

6. **Prania e gjerë dhe në rritje e kompanive offshore.** Siç dihet, kompanitë e njohura si "kompani offshore" janë kompani të ligjshme, që regjistrohen në një numër të kufizuar ishujsh, por edhe në disa vende të botës duke përfshirë edhe Zvicrën e SHBA-në, të njohura për koston e lirë të hyrjes në biznes, kohën e shpejtë të regjistrimit të kompanive/transaksioneve të tyre në vetëm disa orë apo në çdo ditë të javës (d.m.th edhe në ditët e pushimit e festave zyrtare, etj), për ruajtjen e sekretit sa u takon pronarëve të vërtetë të kompanive/aksionarëve të tyre, bordeve mbikëqyrëse, kryerjes së transaksioneve të komplikuara bankare që nuk

[5] *Shih: http://www.oranews.tv/vendi/themelohet-regjistri-elektronik-per-koncesionet/*

mund të gjenden, etj. Madje kjo situatë shqetësuese, mbas publikimit të një skandali ndërkombëtar fund vitin që shkoi të njohur si "Panama Papers"[6] është bërë objekt i ndërmarrjes së akteve ligjore në nivel ndërkombëtar për stabilizimin e situatës. Në qasjen e saj reaktive, apo mbas fakti të ndodhur, edhe eksponentë të rëndësishëm të qeverisë shqiptare u angazhuan për hetimin e veprimtarive të ngjashme në vendin tonë (pra për investigimin e përfshirjes së mundshme të politikanëve të lartë në afera korruptive përmes kompanive offshore, si dhe në amendimin e kuadrit ligjor përkatës me qëllim vendosjen e kushteve transparente për praninë e investimeve të huajave në formën e koncesioneve nga kompani të njohura, pra jo të tipit "offshore"[7]. Por me keqardhje konstatohet se pavarësisht deklarimeve zyrtare, kryesisht për të qetësuar ndjeshmërinë negative të opinionit, të gjitha kontratat e reja koncesionare prej asaj apo që janë aktualisht në proces shqyrtimi nga qeveria shqiptare vijnë nga kompani offshore, pra asgjë nuk ka ndryshuar, por situata sa vjen e po përkeqësohet më tej. Kur them "situata po përkeqësohet", e kam fjalën për ndikimin më të madh negativ të këtij tipi të kontratave koncesionare: pakësimin e kontributeve fiskale nga shfrytëzimi i pasurive natyrore të Shqipërisë në buxhetin e shtetit. Kjo sepse studime serioze tonat dhe të huaja kanë provuar së këto kompani, duke shfrytëzuar: hapësirat ligjore në vendet e origjinës apo dobësitë institucionale dhe sistemin politik të korruptuar në vendet ku investojnë, kryerjen e operacioneve të ndërlikuara financiare ndërmjet kompanive të përfshira në të njëjtin rrjet "offshore", fuqinë ndikuese të anëtarëve të ndryshëm të bordit (të njohur për publikun e gjerë apo për vendin ku investojnë) - shpesh herë edhe ish-zyrtarë apo funksionarë të lartë politikë nga vendet e origjinës së koncesionarit, si dhe lobistë të fuqishëm pranë qeverive të vendeve ku investohet, arrijnë të boshatisin llogaritë e të ardhurave të kompanive offshore përmes rritjes fiktive të shpenzimeve dhe të investimeve në tërësi, pagave super të majme për stafe fantazmë ose për persona reale, por pa asnjë lidhje me kompaninë apo pa ushtruar asnjë funksion në menaxhimin e saj. Domethënë në mënyrë formalisht legjitime, tërthorazi kompensojnë lobistët apo përfituesit e vërtetë nga shfrytëzimi grabitqar i pasurive të vendit. E njëjta gjë ndodh edhe sa u takon individëve të caktuar ish-zyrtarë dhe ish politikanë të lartë në vendet ku kryhet investimi,

[6] *Shih: http://www.balkaneu.com/albania-panama-papers/*
[7] *Shih: http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/04/06/manjani-kompanite-offshore-do-tregojne-pronaret-dhe-aksionet/*

kontribues në hartimin e marrëveshjeve të tilla, për disa syresh edhe në rastin e vendit tonë ka indicie dhe të dhëna të tërthorta se kanë përfituar e vazhdojnë të përfitojnë deri edhe pas më shumë së një dekade nga hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve koncesionare. Domethënë kufizimi me ligj i mundësisë së pranisë së kompanive offshore në vendin tonë, edhe pse në nxitim e sipër lidershipi i vendit tashmë ka shpërndarë në këtë mënyrë thuajse shumicën e pasurive natyrore të vendit, mbetet një domosdoshmëri për të mbrojtur interesat themelore të qytetarëve shqiptare si dhe për të mundësuar krijimin e burimeve që përshpejtojnë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Aktualisht në Shqipëri, më shumë se gjysma e kompanive koncesionare janë të tipit offshore, p.sh në nxjerrjen dhe shfrytëzimin e naftës (por edhe në sektorë të tjerë), dhe ndërkaq kontributet e tyre në buxhetin janë në rënie. Madje kjo rënie shumë shpejt do të jetë e dukshme në sektorin e naftës, ku siç dihet me rritjen e shkallës së shfrytëzimit përtej një kufiri të caktuar, rritja e kuptueshme e kostos për nxjerrjen nga thellësi më të mëdha dhe rënia e presioneve nuk mund të mos çojë në rritjen e kostos së nxjerrjes së naftës në tërësi dhe për rrjedhojë edhe të mbajtjes në nivele të larta të shpenzimeve të kompanive përkatëse, domethënë të zvogëlojë në minimum mundësitë e parashikuara/pritshme të drejtpërdrejta të përfitimeve buxhetore të palës shqiptare siç edhe është përcaktuar në marrëveshjet përkatëse koncesionare.

7. **Mungesa e kompanive të njohura ndërkombëtarisht "brand name".**

Në ndryshim nga fillimet e tranzicionit kur në ekonominë shqiptare u ofruan kompani të mëdha të njohura ndërkombëtarisht për prezencën e tyre në tregjet përkatëse prej shumë dekadash apo edhe kompani shumëkombëshe të interesuara për t'u përfshirë në procesin e privatizimit apo në marrëveshjet koncesionare, me kalimin e kohës situata ka ndryshuar në favor të kompanive të reja, që krijohen posaçërisht për një veprimtari koncesionare të caktuar, që përdorin vetëm siglën apo emrin tregtar/të biznesit të "kompanisë mëmë" dhe mandej administrohen nga partnerë të njohur, por me shumë nga ato të panjohur vendas, etj. Kjo për faktin, sipas mendimit tim, se kompanitë "brand name" janë më të interesuara për rajone më të mëdha se një ekonomi e dobët dhe anemike si ekonomia shqiptare, ashtu edhe për faktin së zhvillimi institucional dhe klima e të bërit biznes në vendin tonë ka evoluar tejet ngadalë dhe prania e korrupsionit dhe barrierave të ndryshme është gjerësisht e pranishme. Largimi nga Shqipëria i kompanive "brand name" dhe zëvendësimi i tyre me kompani

kineze përmes shitjes së aksioneve tek këto të fundit, është edhe fenomeni më i ri në koncesionet e ekonomisë shqiptare, i shfaqur gjerësisht gjatë tre viteve të fundit. Mendoj se ky fenomen reflekton sa klimën e pafavorshme të biznesit, aq edhe faktin së politikat fiskale të ndjekura nga qeveria gjatë kësaj periudhe duket se kanë dobësuar apo edhe dëmtuar rëndë avantazhet konkurruese dhe krahasuese të vendit.

8. **Devijimi nga objektivat e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian.** Studimet tregojnë së çfarëdo politike qeveritare që nuk përputhet me objektivat e integrimit Evropian të vendit çon njëkohësisht si në shtimin e fitimeve të pamerituara të kompanive përfituese nga koncesionet dhe partneritet publike-private, ashtu edhe në shkeljen e angazhimeve politike të vendit ndaj këtij procesi. Këtu është rasti për të përmendur kuadrin ligjor në fuqi për investimet strategjike[8], që pa hezitim mund të thuhet se përmban "elementë të kapjes së shtetit", përveç se bie në kundërshtim të hapur me vetë procesin e integrimit Evropian të Shqipërisë. E njëjta gjë mund të thuhet për kontratën për skanimin e kontejnerëve në dogana, në të cilën ligj-vënësi, duke njohur faktin së përmes kësaj kontrate koncesionare po shkelen detyrimet e vendit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, vendosi në tekstin e ligjit përkatës përcaktimin e pranuar nga investitori për detyrimin e rishikimit të saj pa penalitete ndaj shtetit shqiptar të marrëveshjes në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE[9].

Përgjithësisht duhet pranuar se, përtej retorikës politike të ditës, vitet e fundit janë ndërmarrë një sërë eksperimentesh të kushtueshme për taksa-paguesit në shkallë të gjerë, siç është rasti i kontratës koncesionare/partneritetit publik-privat të "check-up"-it apo kontrollit mjekësor të personave të moshës 40-60 vjeç, kontrata e ngjashme për sterilizimin e pajisjeve mjekësore, etj. Përmes këtyre kontratave, nëpërmjet një procesi në të cilin ka munguar kështillimi me publikun dhe palët e interesuara, ballafaqimi me "përvojat e qeverisjes së mirë" të financave publike dhe posaçërisht në sektorin e shëndetësisë, ka munguar transparenca mbi të dhënat e biznes-planeve përkatëse e mbi të gjitha janë përzgjedhur kompani pa përvojën e nevojshme në sektor e në ndonjë rast edhe pa kurrfarë lidhje me të, por thjesht si rezultat i lobimit politik, është arritur që shuma të

[8] *Shih: http://www.panorama.com.al/dy-ligje-dhe-dhjete-probleme/*

[9] *Shi: https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/11/relacion_ligji_investimet_strategjike_21782_1.pdf fq.2*

konsiderueshme prej dhjetëra e qindra miliona Eurosh nga taksat e qytetarëve gjatë tërë dekadës që vjen të "akaparohen" domethënë të adresohen me siguri 100% në llogaritë e kompanive të përzgjedhura në këtë mënyrë. Kontrata të tilla, sipas mendimit tim, janë të diskutueshme rreth bazës së tyre ligjore, si dhe për faktin se duke qenë së risku është 100% në anën e palës shtetërore - qeverisë (pra nuk ekziston risk për palën e biznesit), duken krejtësisht të njëjta me një prokurim të drejtpërdrejtë — pa konkurrencë dhe që rrok periudha të gjata kohe që nuk kanë lidhje me ndonjë cikël biznesi.

9. **Ruajtja apo krijimi i pozitave monopoliste, domethënë sigurim i fitimeve të pamerituara gjatë periudhës së koncesionit.**

Një problem më vete përbejnë edhe parashikimet specifike në kontratat koncesionare të kufizimeve në treg që çojnë në sigurimin e fitimeve të pamerituara nga kompanitë koncesionare si dhe kufizojnë hyrjen e operatorëve të tjerë në treg. Shembulli më klasik në rastin e vendit tonë është kontrata koncesionare e Aeroportit të Rinasit. Madje edhe negociatat e mëvonshme nuk bënë gjë tjetër përveç se zgjatën afatin e përfitimeve, sipas meje, të pamerituara, të kompanisë në fjalë pa patur asnjë siguri nëse dhe nga kush do të kryhen investimet në aeroporte të tjera civile që, teorikisht, mund të sillnin njëlloj konkurrence në tregun e fluturimeve civile[10].

10. **Ndryshimi i shpeshtë dhe në mjaft raste edhe jotransparent i pronësisë/aksionerëve të kompanive koncesionare.**

Një problem më vete është mënyra se si koncesionarët penetrojnë në ekonominë e vendeve të varfra, me institucione të dobëta e me korrupsion të gjerë si yni dhe mënyra se si ato operojnë mbas nënshkrimit të kontratës koncesionare. Një numër rastesh, madje edhe në radhët e investimeve me serioze në ekonominë shqiptare, dëshmojnë se fillimisht shfaqen kompani offshore me emra serioze apo të lidhura me kompani të njohura, por mbas nënshkrimit të kontratës koncesionare, apo mbas disa vitesh, ato shesin aksionet dhe kalojnë ose në duart e personave të panjohur pa ndonjë lidhje me kriteret mbi të cilat është fituar kontrata fillestare ose/edhe të partnerëve apo pronarëve të vërtetë të tyre, në disa raste edhe vendas. Në disa raste të tjera, sipërmarrjet vendase përdorin - besoj kundrejt ndonjë pagese të majme - emra të kompanive të mëdha, me dijeninë e këtyre të fundit, dhe kështu ato përdoren thjesht si mbulesë për

[10] *Shih: http://www.reporter.al/rinasi-miliona-euro-shtese-per-klauzolen-e-monopolit/*

marrjen përsipër të aseteve të rëndësishme strategjike të vendit apo kontrata shumë milionëshe shërbimesh publike, të cilat në një proces konkurrues normal do të ishte e pamundur të merreshin[11]. Problemi komplikohet më tej mbas nënshkrimit të kontratave koncesionare për shfrytëzimin e aseteve strategjike të vendit apo për ofrimin e shërbimeve të rëndësishme publike, si p.sh në shëndetësi. Kompani të tilla nuk disponojnë mjetet e nevojshme financiare, pra nuk kanë fuqi investuese reale, nuk njihen dhe/ose mbështeten nga bankat e investimeve dhe institucionet financiare ndërkombëtare që mbështesin projektet zhvillimore (në rastin e aseteve strategjike) si dhe përkeqësojnë shërbimin ndaj publikut (në rastin e shërbimeve) ose/edhe shesin - diku hapur dhe diku fshehur në mënyrë korruptive - aksionet e tyre tek persona të tretë me lidhje të fuqishme oligarkike ose të krimit të organizuar, duke rrezikuar pasuritë e vendit, apo duke i keqmenaxhuar ato, siç është p.sh rasti i kompanisë ARMO[12].

11. **Shtrirja e veprimtarisë në shërbime publike/veprimtari tradicionale të shtetit edhe/ose në veprimtari me përfshirje mafioze dhe të dyshuar për korrupsion.**

Një kërcënim më vete përbën shtrirja e "investimeve", në fakt interesave të një numri biznesesh, drejt shërbimeve publike primare që në botën e sotme qeverisen apo ofrohen nga vetë shteti dhe janë pjesë thelbësore e funksioneve kushtetuese të tij, si në tatime-taksa, dogana, etj. Në Shqipëri ky proces është i pranishëm kryesisht në formën e të ashtuquajturave "ofertë e pa kërkuar", por që në fakt fsheh interesa të mëdha biznesi, kryesisht të asaj pjese të biznesit që është rritur e zhvillohet nën mbrojtjen politike apo që njihen ndryshe në opinionin publik si biznese të oligarkisë së vendit. Në kushtet e sotme, kjo është aq e vërtetë sa janë bërë dhe po bëhen tentativa për të transferuar nën kontrollin e bizneseve të tilla shërbime të rëndësishme shtetërore, kuptohet duke përdorur emra kompanish të huaja apo mbulesa me strategji zhvillimore etj. por që ju mungojnë justifikimi dhe argumentimi përkatës se përse duhen ndërmarrë nisma të tilla, ju mungojnë plan-bizneset përkatëse, miratimi i tyre kryhet në kushtet e mungesës së plotë të transparencës, jashtë monitorimit të institucioneve të tilla të ligjshme siç është Avokatura e Shtetit, etj,. (siç është rasti i koncesionit të sipërfaqeve të parkimit në qytetin e Vlorës) apo me përfshirjen e kompanive të dyshuara si korruptive dhe me rekorde

[11] *Shih: http://www.reporter.al/kompania-guacke-qe-fshihet-pas-projektit-morgan-per-portin-e-karpenit/*
[12] *Shih: http://www.monitor.al/e-verteta-e-fshehur-e-armo-s-u-shit-apo-u-fal/*

të njohura në këtë fushë (p.sh koncesioni në diskutim i trajtimit të mbetjeve në Tiranë), etj.

12. **Roli i kufizuar i Kuvendit të Shqipërisë, me një mbipërfaqësim të sipërmarrësve dhe të oligarkëve, një pjesë e tyre në një konflikt të hapur interesi.**

    Në një vend me demokraci funksionale, pra në një republikë parlamentare, Kuvendi luan një rol të madh në mbrojtjen e interesave publike, në frenimin e agresivitetit të grupeve të interesit dhe posaçërisht të oligarkisë dhe rrjeteve të lobistëve për të shfrytëzuar në interesin e tyre asete të rëndësishme strategjike të vendit, për të penguar konkurrencën, për të instaluar praktika anti-konkurruese, pra për sigurimin nga ana e tyre të fitimeve të pamerituara në treg duke ndëshkuar padrejtësisht konsumatorët dhe konkurrentët. Për fat të keq, debatet e përgjegjshme rreth këtyre temave në Kuvendin e Shqipërisë ose mungojnë, ose janë në një rreth të kufizuar anëtarësh të këtij institucioni që për një numër arsyesh - themelore ndër to është mënyra së si formohet kuvendi - nuk arrijnë të përçojnë sinjalet e duhura të biznesit, e mbi të gjitha nuk arrijnë të garantojnë mbrojtjen e duhur institucionale dhe ligjore të interesave themelore të vendit në këtë drejtim.

13. **"Zgjidhja me mirëkuptim" e konflikteve për kontratat koncesionare, por në çdo rast në favor të palës së huaj…**

    Është një shqetësim në rritje që nga njëra shteti shqiptar duhet të mbrojë interesat e veta duke ofruar nga ana tjetër edhe garancitë e nevojshme juridike të njohura ndërkombëtarisht dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për sipërmarrjet e huaja që veprojnë në ekonominë shqiptare. Historia e konflikteve të lidhura me privatizimet apo me kontratat koncesionare dëshmon se për shkak të mënyrës se si janë hartuar kontratat koncesionare, të shkallës së gjerë të përfshirjes së palës së huaj në hartimin e dokumenteve përkatëse, të boshllëqeve të mundshme në procedurat e zgjidhjes së konflikteve si dhe të mungesës së kapaciteteve të palës shqiptare, këto konflikte përfundojnë në favor të palës së huaj. Kjo ndodh si në rastin kur konflikti shqyrtohet përmes arbitrazhit përkatës (p.sh rasti i investimit të trenit elektrik në hekurudhën e shpejtë Tiranë-Durrës me General Electric Ltd.,), ashtu edhe në rastet kur zgjidhjet e konflikteve kontraktuale kryhen me mirëkuptim (p.sh konflikti i qeverisë shqiptare me kompaninë CEZ me rastin e shtetëzimit të kësaj të fundit nga shteti shqiptar). Kjo situatë sjell në vëmendje nevojën e rritjes së transparencës dhe të kapaciteteve të

institucioneve shqiptare të përfshira në hartimin, mbikëqyrjen, monitorimin e kontratave koncesionare.

Për të gjitha problemet e renditura me sipër, por edhe për të tjera si këto, mendoj se qeveria shqiptare duhet të pezullojë për një periudhë të arsyeshme kohe, p.sh të paktën për 6 muaj nënshkrimin e kontratave të reja koncesionare si dhe të përdorë këtë periudhë për kryerjen e analizave të nevojshme që do të çonin në amendimin, rishikimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator bazë si dhe të legjislacionit sekondar në fushën e koncesioneve dhe të kontratave të ashtuquajtura "partneritete publike-private".

Nga: Dr. Zef Preçi

Qëndra Shqiptare për Kërkime Ekonomike

Ç'DUHET TË DIJË NJË AUDITUES MBI MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE

Një auditim duhet të jetë burim i çmuar për të gjithë palët e interesuara, duke qenë shembull i evolucionit të kohës së fundit në Ekomenaxhimin e Mbetjeve Urbane në kontekstin e Bashkimit Evropian. Nxjerrja në pah e Ekonomicitetit, Efiçiencës dhe Efektivitetit i ndihmon Entet Shtetërore për të matur rezultatet e tyre, për të përcaktuar (gjetur) mundësi të tjera për rritjen e rezultateve me të njëjtën kosto.

Nga: Prof.Dr.Sazan Guri

"G&G" Group

**ekspert mjedisi & hidrogjeolog dhe ekspert i jashtëm i KLSH*

Rasti Bashkia Lushnje

Abstrakt

Një ambient i pastër dhe i shëndetshëm është pjesë dhe ngastër e cilësisë së jetës, që ne dëshirojmë për veten tonë tani dhe për fëmijët tanë në të ardhmen. Shkallët që ngjisim e zbresim përditë në pallatin tonë, rrugët e shtëpisë, oborri i shkollës, përtej qytetit etj., kërkojnë dashuri e kujdes prej nesh, në mënyrë që të bëhen për ne mjedisi, ku të bashkëjetojmë me ajër të pastër, ushqim të shëndetshëm, duke u kthyer në hapësira mikpritëse të bashkëjetesës tonë qytetare. Mbeturinat nuk janë vetëm gjëra të cilat ne nuk na nevojiten më, as gjëra që na mbesin nga prodhimi i mallrave të ndryshme. Ato janë edhe gjëra me të cilat ne mund të përfitojmë. Eliminimi i mbeturinave urbane përbën një hallkë jetike në konceptin fillim-përfundim të menaxhimit të mbeturinave urbane. Theksi i tanishëm mbi parandalimin e ndotjes, si dhe zhvillimi i teknologjive të trajtimit ka si rezultat pakësimin e volumit të mbeturinave urbane, të cilat duhet të eliminohen. Parandalimi i mbeturinave do të jetë një element kyç i një politike të integruar. Masa të forta fillimisht nevojiten për të nxitur ripërdorimin, reduktimin dhe riciklimin dhe përpunimin e mbetjeve, e cila quhet ndryshe edhe "hierarkia e mbetjeve". Edukimi i qytetarëve për të reduktuar, ricikluar mbetje nuk është zgjidhja e plotë, por është një fillim i mbarë. me moton: Riciklo për të kursyer energji, material, sipërfaqe…..!

Hyrje

KLSH prej disa vitesh ushtron auditime në fushën e mjedisit, disa prej të cilave kanë qenë auditime performance. Menaxhimi i mbetjeve urbane është më kompleks se thjesht vend depozitimi i tyre në një fushë (landfill). Eliminimi i mbeturinave urbane përbën një hallkë jetike në konceptin fillim - përfundim të menaxhimit të mbetjeve urbane. Theksi aktual mbi parandalimin e ndotjes, si dhe zhvillimi i teknologjive të trajtimit ka si rezultat pakësimin e volumit të mbetjeve urbane, të cilat duhet të eliminohen. Synimi i auditimit është të japë një panoramë të përgjithshme të funksionimit të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve Urbane dhe të përshkruajë konkretisht instrumentat dhe realizimin e saj.

Sepse, Administrimi i Mbetjeve Urbane është kryer dhe vazhdon të kryhet në mënyrë primitive. Ato shkarkohen në gjendje të lirë, në vend të papërshtatshëm e të ndaluar, në breg lumi, pranë zonave të banuara, duke shkarkuar një shpërndarje të pakontrolluar të tyre, të cilat kanë ndikuar në ndotje të ajrit, tokës dhe ujit.

Paradokset e menaxhimit të mbetjeve

Grumbullohen në vend depozita të hapura në natyrë; Nuk kryhet asnjë lloj përpunimi; Vendosen në depozitime të shkrifta, toka buke; Hidhen pranë sistemeve ujore (lumenj, hidrovore); Digjen në gjendje të lirë dhe jashtë kushteve të kontrollit mjedisor. Nëpërmjet këtij shkrimi do donim të informonim nga njëra anë shoqërinë civile dhe publikun, mbi gjendjen e menaxhimit të mbetjeve urbane, përsa i përket grumbullimit të tyre, trajtimit, reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe groposjes, me qëllim përmirësimin e këtyre proceseve në të ardhmen, të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mjedisin përreth dhe në shëndetin e popullsisë, dhe nga ana tjetër audituesit që angazhohen për kryerjen e një auditimi mbi menaxhimin e mbetjeve urbane.

Rëndësia e një auditimi

I gjithë ekipi e konsideron auditimin si një sfidë reale, jo vetëm për zhvillimin e moduleve të kërkuara nga Strategjia Kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve, por edhe për nivelet e perfomancës së qeverisjeve vendore në këtë drejtim. Paralelisht, auditimi hap drejtime të reja për kontrolle e këshillime të mëtejshme deri në ballafaqime ligjore, dhe njëherazi shërben si manual për zbatimin e metodave ekologjike të trajtimit të mbetjeve urbane në të gjitha nivelet e qeverisjeve lokale dhe qëndrore. Koha është për të bërë një zhvillim ndryshe, më të fokusuar, më të koordinuar dhe më të përgjegjshëm.

Besojmë se Objektivat e Qeverisjes dhe ato të MSA-së sigurojnë një mundësi për të bërë pikërisht këtë.

Një auditim duhet të jetë burim i çmuar për të gjithë palët e interesuara, duke qenë shembull i evolucionit të kohës së fundit në Ekomenaxhimin e Mbetjeve Urbane në kontekstin e Bashkimit Evropian. Nxjerrja në pah e Ekonomicitetit, Efiçiencës dhe Efektivitetit i ndihmon Entet Shtetërore për të matur rezultatet e tyre, për të përcaktuar (gjetur) mundësi të tjera për rritjen e rezultateve me të njëjtën kosto. Në mënyrë më specifike, KLSH-ja përbën atë institucion që këshillon dhe ndihmon për përmirësimin e proceseve të punës, sidomos aty ku efiçienca është e vështirë për t'u matur, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike pa rritur shpenzimet.

Mbetjet, për shkak të sasisë së përgjithshme, përbërjes dhe ndikimit negativ në mjedis dhe shëndetin human, konsiderohen si një ndër problemet kryesore sot në Shqipëri. Mungesa e menaxhimit të Trajtimit të Integruar të Mbetjeve Urbane ka shkaktuar një shpërndarje të pakontrolluar të plehrave, të cilat shkaktojnë ndotje të mëdha që lidhen me tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrin dhe erën (aromat). Pesë parimet që duhen zbatuar për të zgjidhur krizën e mbetjeve në një mënyrë sa më të mirë mjedisore, si dhe nga ana e kostove ekonomike, janë:

1. Zgjidhja duhet të jetë sa më e thjeshtë;
2. Zgjidhja duhet të jetë lokale;
3. Njehsimi i zgjidhjes me ekonominë lokale;
4. Njehsimi i zgjidhjes me zhvillimin e komunitetit lokal;
5. Zgjidhja e bazuar në metodat inxhinjerike

Për pasojë, çdo Bashki duhet të zhvillojë strategjinë e vet të depozitimit të mbetjeve, ku rindarja në shesh grumbullimi dhe më pas vendgroposja, pa dyshim luajnë rolin më të rëndësishëm. Dhe nga ana tjetër, do donim të ngremë nivelin e grupeve auditues të Organit më të lartë të kontrollit të shtetit, se si menaxhohen dhe shpërndahen lekët e taksa paguesve shqiptarë në përgjithësi dhe të qytetarëve në veçanti, po ashtu edhe donatorëve. Që të sigurojë sukses një program i bashkuar menaxhimi i mbetjeve urbane duhet të zhvillohet në një stil të bashkërenduar. Planifikimi i një sistemi *reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimi efektiv* kërkon një arritje sistemi. Vendimet rreth koleksionimit, marketingut, dhe procesit të tyre janë të lidhur me njëri-tjetrin. Të marrësh një vendim rreth një elementi të programit të menaxhimit të mbetjeve urbane pa marrë parasysh efektin e vendimit ndaj elementëve të tjerë mund të çojë drejt një programi jo efektiv dhe të shtrenjtë, me një kritikë të shtrirë tek publiku dhe një pjesëmarrje të dobët. Meqenëse publiku (qytetarët, familjet dhe bizneset) duhet të mbështeten në pjesëmarrje, duke ndarë një përqindje të lartë të mbetjeve apo të materialeve të papërdorshme, programi duhet të jetë i planifikuar në përputhje me

leverdinë dhe mbështetjen e publikut, si objektiv kryesor.

Gjetja e një pyetsori

Na duhet të dimë mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak që ka si objekt të tij "Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane".

Gjithë operacioni për këtë lloj shërbimi, sa kushton në vit dhe si specifikohen zërat e punës me financat përkatëse?

A ka një program për Edukimin Publik, dhe si është realizuar ajo?

A kini evidenca për gjenerimin e mbetjeve, dhe nga këto sa rezultojnë se mund të jenë mbetje të rrezikshme?

Në rast së Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e kryerjes se Edukimit Publik Ambiental

Sa % e mbetjeve mblidhen në rang qyteti dhe sa në rang rrethi?

Si mblidhen dhe dokumentohen shqetësimet e banorëve, cilat janë praktikat tuaja?

Kini në dispozicion qindra pika mbledhje të MbU-ve, dhe rreth 650 kontenierë, mesatarisht për një Kompani, sa kosha për banorë rezulton dhe a kontrollohet gjithë zona urbane e Bashkisë, sa në qytet dhe sa nëpër fshatra?

Fusha e mbetjes, që punon qysh prej 40 vjetësh, si mbulohet ajo?

Çfarë bëhet me mbetjet inerte dhe ato industriale?

A ka kryer Bashkia studime për depistimin e banorëve përreth vend hedhjes se mbetjeve urbane në hyrje të qytetit?

A ka konsulta për anamnezë të banorëve në spitalet e qytetit?

A ka marrë Bashkia masa, ku të analizojë kampione për ndotje uji, toke dhe ajri?

Sa ka rezultuar në euro/ton pranimi i mbetjeve urbane për secilën metodë të propozuar për asgjësimin e mbetjeve urbane?

A kini kryer bashkëpunime me publikun për zgjedhjen e metodës më optimale për asgjësimin e mbetjeve urbane apo për riciklimin e tyre dhe si?

A ka projekte të tjera në të ardhmen për menaxhimin e mbetjeve urbane, dhe nëse, cilat janë ato?

A kryhet trajtimi i ujërave leksiviate që dalin prej landfill-it?

A kryhet trajtimi i gazrave që emetohen prej landfill-it?.

Cila është perspektiva e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane dhe studime për përzgjedhjen e shesheve për asgjësimin e tyre?

A mund të zbërtheni se si menaxhohet taksa e qytetarëve lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

Cili është numri i telefonit për komunikim me publikun dhe a mbahet libri i ankesave prej qytetarëve?

Kini raste për konstatim të mbeturinave të rrezikshme dhe mekanizmat e rrugët që kini ndjekur?

Njohuritë bazë mbi të cilën mund të ngrihet një auditim

Ilustrim me rastin dampa e rrethit Lushnje

Çfarë substancash të dëmshme lëshohen në ajër nga djegia e mbeturinave urbane?

Djegiet e plehrave çlirojnë kimikate kancerogjene dhe helmuese, duke përfshirë:

- metalet e rënda (të tilla si zinku, bakri, plumbi, kobalti, kadmiumi, arseniku merkuri, kromi, beriliumi, etj);
- gazet, duke përfshirë fluorurin e hidrogjenit;
- materialet organike pjesërisht të djegshme, siç është polyvinyl chloride,
- mbetjet herbicide dhe mbetjet e drurëve;
- kimikate të tjera organike, duke përfshirë hidrokarburet aromatike polycyclic, si dhe
- dioksinat dhe furanet.

Emetimet ose lëshimet në ajër nga djegiet përmbajnë nivele të larta të metaleve të rënda të tilla si; plumbi, kadmiumi, mërkuri, kobalti, zinku, bakër.

Përbërës të tjerë të rrezikshëm janë dhe ata organikë, si heksaklor-butadina, heksaklorobenzina dhe heksakloroetani. Madje, këto tre tipe janë të pranishëm në përqendrime të rëndësishme tek mbeturinat. Duke qenë se përmbajnë shumë klor, në përgjithësi konsiderohen shumë të rezistueshme edhe ndaj djegies së plehrave, dhe si të tilla vazhdojnë të marrin pjesë në zinxhirin ushqimor, që d.m.th se vazhdojnë të përcillen me anë të ushqimeve deri te marrësi i fundit që është njeriu. Djegia e mbetjeve urbane, sidomos kur kanë edhe sasia jo të vogla nga ato mjekësore, përbëjnë rastin, si një nga burimet më kryesore të prodhimit të dioksinës helmuese, njësoj si merkuri apo substanca të tjera helmuese në mjedisin përreth. Njerëzit që jetojnë brenda 7.5 km të zonës së djegies së mbetjeve urbane kanë më shumë të ngjarë që t'u shkaktohen kancere të ndryshme, sipas një studimi të vitit 1996 për 14 milion njerëz që jetojnë pranë tyre.

Studimi u bë në dy faza. Statiskisht u gjetën rritje të mëdha për të gjitha kanceret e kombinuara si:

- kanceri i stomakut, kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit, kanceri i mëlçisë, kanceri i laringut, kanceri i mushkërive, kanceri i mitrës.

Midis njerëzve që jetojnë 3 km larg një djegiet e mbetjeve qofshin termike (me

ane teknologjie të incenerimit) qofshin në natyrë, kancerët e sistemit të limfës dhe leukemisë u ngritën në mënyrë të ndjeshme. Faza e dytë e studimit ekzaminoi historinë e kancerit. Midis këtyre njerëzve, statiskisht kishte rritje të ndjeshme për të gjitha kancerët; kanceri i stomakut, kanceri i zorrës së trashë dhe i rektumit; kanceri i mëlçisë, kanceri i mushkërive dhe kanceri i mitrës. Ky është studimi i parë i ekzaminimit të rreziqeve të kancerit nga djegia termike të mbetjeve urbane midis popullsisë së përgjithshme. Nivelet prej 22 pjesë për milion në qumështin e lopëve flasin për nivel të lartë të ndotjes nga dioksina.



Në rastin konkret, mbështetur në analizat e kryera rezulton se në ajër lëshohen me patjetër të gjithë elementët e sipërmendur, por që në vendin tonë nuk është e mundur që të matën, me përjashtim të pluhurit apo grimcave të pluhurit PM10, që arritëm ta masim dhe që ka rezultuar 5-6 herë më e ndotur se norma. (shih tabelën më poshtë dhe atë origjinale). Theksojmë se matjet për përmbajtjen e pluhurit në ajër janë kryer, jo gjatë fazës së djegies, por në momente normale e qetësie të dampës së mbetjeve, që natyrisht në momentin e djegies së plehrave mund të themi se krahasimi është me herë më pak i ndotur. Gjithsesi, nga matja e kryer rezulton se lënda pezull është 4 herë më e lartë se norma e vendit ose 6 herë me e lartë se norma evropiane.

Çfarë dëmtimesh mund të sjellë në shëndetin e njeriut përqendrimi i atyre substancave tej nivelit të sipërpërshkruar?

Dioksina dhe përbërësit klorikë organikë që lidhen me to janë substanca jashtëzakonisht helmuese që kanë një sërë ndikimesh të kundërta tek njerëzit dhe tek kafshët, edhe kur janë në doza jashtëzakonisht të vogla. Këta përbërës janë të qëndrueshëm në mjedis dhe grumbullohen në përqendrime të mëdha, ndërsa lëvizin në zinxhirin e ushqimeve, duke u përqendruar tek yndyra, veçanërisht tek qumështi. Ato janë të shpërndara në të gjithë zonën e vendit për shkak të djegies së mbetjeve, dhe në këto raste janë të pranishme në çdo banor të popullsisë pranë djegies. Dioksina dihet që shkakton zhvillimin e qelizave kancerogjene. Duke bashkëvepruar direkt me AND-në nëpërmjet një mekanizmi të bazuar në receptor, dioksina vepron gjithashtu edhe si një përçarës endikronal me ndikime të kundërta mbi sistemin e riprodhimit, zhvillimit dhe imunitetit. Organizmat në zhvillim janë të prekshme në të gjitha speciet e studiuara dhe ekspozimet embrionale ndaj dioksinës, zakonisht kanë ndikime të qëndrueshme

afatgjata. Dioksina është në gjendje të ndërhyj në metabolizmin tiroid të foshnjave. Ato ndërhyjnë në sisteme hormonale. Emetimet e dioksinës mund të takohen lehtë në zinxhirin e ushqimit. Është llogaritur se një litër qumësht do të përhap aq dioksinë sa një njeri mund të marrë duke thithur ajrin, duke qëndruar pranë një lope për tetë muaj.

Furanet, sikundër dhe doksinat janë një tjetër përbërës helmues të prodhuar nga djegia e plehrave. Furanet bëjnë pjesë në një familje kimikatesh me ngjashmëri të madhe me dioksinën, të cilat mund të shkaktojnë dëmtime shëndetësore, njësoj si dioksina. Të dy këta elementë mund të shkaktojë kancer dhe vepron si një përçues endokrinal me kundër ndikime në sistemin e riprodhimit, zhvillimit dhe imunitetit. Në vendin tonë, djegia termike e plehrave mund të jetë përgjegjëse për mbi 90% të emetimeve e dioksinës të transportuara në rrugë ajrore.

Metalet e rënda janë të pranishme në shumë rrjedhje të mbetjeve dhe nuk mund të shkatërrohen as edhe kur digjen në qiell të hapur, si rasti në fjalë. Ato përfundojnë në hi ose çlirohen si emetime ajrore. Metalet e rënda parashtrojnë rrezik për shëndetin në përqendrime të vogla, për shkak të helmueshmërisë së lartë të metaleve të veçanta si merkuri, plumbi dhe kadmiumi. Metalet tipike të emetuara nga djegia termike përfshijnë:

Kobalti që rezulton nga procesi i dampave të pambuluara, dhe me nënshtrojë të përshkueshme, si rasti i dampës në fjalë. Ai është element bioakumulues në trupin e njeriut, si dhe është helmues për veshkat dhe sistemin nervor.

Plumbi, i cili shkakton çrregullime nervore; kadmiumi, i cili shkakton dëme në veshka, hypertension dhe dëmtime gjenetike.

Merkuri ndërhyn në zhvillimin normal të trurit, sapo shndërrohet në formën e tij organike në mjedis. Në vizionin tonë, niveli i merkurit, për shkak të djegies dhe ndotjes së ujërave nga poshtë dampës duhet të jetë e mjaftueshme për të nxitur shtetin të paralajmërojnë femrat shtatzëne, si dhe femrat në moshën e riprodhimit që të mos konsumojnë produkte bujqësore të dala nga kjo zonë ose të prekura nga ujërat lokale. Ai shkakton defekte në lindje, dëmtime në sistemin imunitar dhe çrregullime nervore;

Metale të tjera të rënda përfshijnë Cadniumin, Zinkun dhe Bakrin.

Produktet e djegies së pa plotë janë kimikate, që nuk gjenden në rrjedhjen e mbetjeve fillestare, por që formohen gjatë djegies. Ato përfshijnë kimikate të rrezikshme, siç është benzeni, kloroformi dhe tetraklorur karboni.

Ndotësi	**Ndikimet mbi shëndetin dhe mjedisin**
I. Gazet okside	
Dioksidi i sulfurit	Keqëson simptomat e zemrës dhe të sëmundjes së mushkërive, duke përfshirë kollën dhe të ftohurën, astmën, bronshit dhe emfizemën. Është helmuese për bimët. Mund të gërryejë statujat dhe metalet. Shenjë paralajmëruese për shirat acidë.
Oksidet e azotit	Përqëndrimet e larta mund të jenë fatale; në nivele më të ulëta mund të rrit ndjeshmërinë për infeksionet virale, siç është gripi, të ngacmojë mushkëritë, shkaktojë bronshit dhe pneumoni. Është helmues për bimët. Shenjë paralajmëruese për shirat acidë.
II. Organikët	
Dioksina dhe furanet	Një kancerogjen i vërtetuar njerëzor sipas Organizatës Botërore të Shëndetit të Agjensisë Ndërkombëtare për Kërkimet mbi Kancerin. Një hormon ambjental, ku dioksina bie ndesh me sistemin endikronat të trupit. Shkakton probleme të riprodhimit dhe të zhvillimit. Është e lidhur me endometriosis. Nivelet e larta të ekspozimeve ndaj aksidenteve industriale kanë dhënë si rezultat chloracne, kanë shndërruar funksionin e mëlçisë, si dhe kanë shkaktuar probleme në lëkurë. Sëmundjen e Chico-edima tek kafshët, që lidhet me neglizhimin e të ushqyerit për harenga dhe pulëbardhat.
PCB	Në ekspozime të larta mund të shkaktojë chloracne, çrregullime në mëlçi dhe të verdhët. Mund të shkaktojë gjithashtu dhe defekte në lindje.
III. Metalet e rënda	
Plumbi	Në ekspozimet kronike dhe të mprehta, fëmijët mund të vuajnë çrregullime neurologjike, si dhe femrat mund të ndjejnë probleme

	të riprodhimit.
Merkuri inorganik	Mund të shkaktojë çrregullime serioze neurologjike si dhe probleme të veshkave është kancerogjen i mundshëm për njerëzit sipas EPA-s të Shteteve të Bashkuara.
Metili merkurit	Helm riprodhues. Është vërtetuar që shkakton tumor tek minjtë në rast se dozat janë të mëdha. Është gjithashtu dhe një kimikat i përçimit endikronal, duke shkaktuar një keqësim të funksioneve të gjendrave tiroide.
Kadmiumi	Sipas EPA-s është një kancerogjen i mundshëm për njerëzit. Mund të shkaktojë kancerin e mushkërive, që lidhet gjithashtu me çrregullimet e veshkave.
Kromi	Mund të shkaktojë dëmtime në mëlçi dhe në veshka si dhe çrregullime në frymëmarrje.
Arseniku	Sipas EPA-s është një kancerogjen i mundshëm për njerëzit. Mund të shkaktojë dëmtime në mëlçi dhe në veshka.

Në rastin objekt studimi çfarë pasojash kanë ardhur konkretisht tek banorët e zonave përreth? Edhe kjo kërkon të ndërhysh në anamnezat e banorëve të qytetit të Lushnjes në përgjithësi, dhe në ata banorë përreth zonës së dampës në veçanti, e cila kërkon një mikrostudim të posaçëm. nga takimi që patëm me spitalin e Lushnjes, me doktoreshën e sëmundjeve pulmonare na u tha se kemi shumë pacient në Lushnje me ketë sëmundje, por që doktoresha në fjalë në vizitat që kryente dhe në studimin e saj për gradën doktoraturë, e lidhte shkakun me blozën e druve të përdorur për djegie. Nga ana tjetër, Doktoresha pranoi se nuk kishte njohuri për dampën që digjesh në qytetin e Lushnjes. Në interpretimin tonë, mendojmë se shkaku i sëmundjeve të

shumta pulmonare duhet të jetë me bazë pikërisht:

- mostrajtimi i mbetjeve,
- mos mbulimi i tyre dhe
- aq më keq djegia e tyre, dhe jo bloza e druve,

që kanë të përbashkët si lëndë të dalë nga djegia e plehrave apo e druve, blozën, pluhurin, monoksidin e carbonit, H_2S, etj., që janë përshkruar më sipër.

Cili është ndikimi i mbetjeve urbane në ujërat mbi dhe nëntokë? A ndikojnë këto mbetje në prishjen e ekuilibrit ekologjik?

Sqarojmë se uji për përdorim shtëpiak duhet të gëzojë sipas klasave këto cilësi e standarde

- Klasa 1A - Ajo karakterizon ujërat të konsideruara të paprekura nga ndotjet, të afta të kënaqin përdorimet si pirje e gatim. Zakonisht këto ujera kanë ngjyrë blu.
- Klasa 1B - Të një kualiteti pak më të ulët, këto ujëra gjithashtu mund të kënaqin të gjitha përdorimet. Ngjyra e tyre është e gjelbër.

Gjendja dhe shpërndarja e treguesve të veçantë të ujërave të pijshëm që merren në një studim ***(shih standardet sipas tabelës C)***

1. Era, shija, ngjyra – pa erë të huaj, në shije normale dhe pa ngjyrë.
2. Ph - Norma e këshillueshme është 6 deri 8.5
3. Amoniaku nuk këshillohet në sasitë më të larta se 0.05µgr/l
4. Nitritet nuk këshillohet në sasitë më të larta se 0.01µgr/l.
5. Kalciumi - Norma e këshilluar 75mgr/l, ajo e pranueshme 200mgr/l,
6. Kloruret - norma e këshilluar (25µgr/l), 1 në kufij të pranueshëm (200mgr/l)
7. Sulfatet – norma e këshilluar (25mgr/l). Norma e pranueshme është 250 µgr/l.
8. Zinku - Norma 0.1mgr/l e pranueshme deri 5mgr/l.
9. Plumbi- norma e lejuar është 50mkgr/l.
10. Bakri- ndodhet në sasira të vogla 50-80mkgr/l.

Kësisoj, u kryen matje në ujërat sipërfaqësorë midis dampës dhe shtëpisë më të afërme të saj dhe një kampion tjetër për ujërat sipërfaqësorë u morr në kanalin pranë dampës, ku shkarkojnë si

ujërat e dampës së djathtë dhe asaj të majtë që është formuar rishtas. Për këto ujëra kemi rezultatet e mëposhtme:

Nga kjo analizë kupton se:

- metalet e rëndë në ajër dhe më pas në ujë si zinku – Zn dhe plumbi – Pb, p.sh janë respektivisht 2 dhe 3,5 herë më të larta se normalja ose ajo kufi, ndërkohë që përmbajtja e Bakrit – Cu dhe e kobaltit është në normë.

U kryen matje edhe në ujëra nëntokësorë, për të cilën u morën dy kampione, njeri në thellësinë 3m nga sipërfaqja dhe 10 m larg dampës, pra në shtëpinë më të afërt dhe tjetri në po atë thellësi por 20 m larg dampës nëpër familje konkrete që e kanë përdorin këtë ujë dhe ende e përdorin.

Për ujërat nëntokësorë të pusit 10m larg dampës së mbetjeve kemi tabelën e mëposhtme.

Për ujërat nëntokësorë të pusit 20m larg dampës së mbetjeve kemi tabelën e mëposhtme.

Nr	**Treguesit kimikë**	**Ujë pusi (2)**	**Norma Standarde**	**Sasia e ndotjes Në % më e lartë se norma**
1	Shija dhe era (numër hollimi)	Normale		
2	Ngjyra dhe pamja e jashtme (mg/l shkalla Pt/Co)	Normale		
3	Ph (njesi pH)	7,03	6.5-8.5	
4	Konduktiviteti elektrik (uS/cm)	***1600***	≤ 400	400%
5	Kalciumi (mg/l)	***102***	75mgr/l,	25%
6	Lëndët pezull (mg/l)	***4***	≤30µg/liter ose 0.03 mg/litër	1330%
7	Turbullira (njësi FTU)	2		
8	Alkaliniteti Total (mg ekv/l)	6,8		
9	Karbonate(mg/l)	0		

10	Bikarbonate (siHCO$^-_3$) (mg/l)	414,8		
11	Amonjaku (mg/l)	***0,903***	≤0.1	900%
12	Nitrite (mg/l)	0	≤0.1	
13	Nitrate (mg/l)	gjurmë	≤0.1	
14	Fortësia totale (^{o}gjermane)	***378***	18-30 quhen ujera të forta	1000%
15	Fosfate (mg/l)	***1,48***	≤0.7	200%
16	Lënda organike(mg/l)	1,6		
17	Kloruret(mg/l)	***158,6***	25µgr/l),	600%
18	Sulfate(mg/l)	***250***	25mgr/l.	1000%
19	TDS (mg/l)	800		

Nga kjo analizë për ujëra nëntokësorë kupton se pothuajse të gjitha parametrat cilësorë të ujit janë shumë më të larta se standardet dhe normat kufi.

Çfarë dëmtimesh mund të sjellë në shëndetin e njeriut ndotja e ujërave të mbitokës dhe nëntokës tej nivelit të lejuar dhe a kanë ardhur pasoja në shëndetin e banorëve të zonave përreth?

Duke qenë se dampa nuk është e ndërtuar nga një shtresë argjilore e papërshkueshme, e cila duhet të ishte të paktën, sipas rregullores së Komisionit Evropian, jo më pak se 1m trashësi, bëhet e mundur që ujërat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë të pësojnë ndikime negative apo helmim të tyre deri në të papërshtatshëm për t'u përdorur jo vetëm për njerëzit, por edhe për botën e gjallë, dhe as për vaditje të produkteve bujqësore. kjo ka shpjegim të thjeshtë dhe madje nuk ka nevojë të vërtetohet, sepse janë praktikat më se të njohura botërore që automatikisht të çojnë në këto përfundime. p.sh të gjitha lëngjet e helmëta që dalin nga djegia e mbetjeve dhe nga ngjeshja e tyre në rrugë gravitative shkojnë drejt tabanit të deponisë apo fushë mbetjeve, dhe më tej ato iu drejtohen ujërave kanalorë sipërfaqësorë dhe mandej atyre nëntokësorë freatik që ndodhen në këtë zonë në afërsi 1,5-2m pranë sipërfaqes së tokës. Këto ujëra janë bazë e furnizimit të rrëkeve, përroskave e lumenjve, por më tepër të ujërave të gruntit që marrin pjesë në zinxhirin ushqimor të njeriut, duke qenë pjesë e ujërave të tokës bujqësore. Si përfundim, ato janë pjesë e rritjes së bimës, duke iu dhënë atyre kripra e elementë kimik mbi norma që mandej shkojnë në produkte bujqësore, por më tepër në produktet blegtorale e pastaj te njeriu, si marrësi i fundit, e pastaj në shëndetin e përkeqësuar të tij. Ky lloj dëmtimi i shëndetit përmblidhet në kreun e katërt të Kodit Penal, neni 202 për

ndotjen e ujit. Parë në këtë prizëm, kemi ndotjen e tokës, por që ende nuk mbështetet me ligj në Kodin penal. Gjithsesi, nga ndotjet e ujërave të plehrave të quajtura ujëra leksiviate ose acide, si kur digjen plehrat, si dhe kur nuk digjen, pra kur nuk trajtohen me mbulim nga poshtë, nga anash ose nga sipër, kemi ndotje me ndikim tepër të lartë të ujërave sipërfaqësorë, të ujërave nëntokësorë dhe të tokës ose e thënë ndryshe prishje të ekuilibrave të ekosistemeve natyrorë, e për pasojë edhe të atyre njerëzorë.

A nevojitet leje mjedisore për kryerjen e shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane?

Po, patjetër që nevojitet leje mjedisore për kryerjen e shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane, sepse leja mjedisore presupozon që kompania i nënshtrohet një analize mjedisore, një performance mjedisore, duke qenë se kryen një investim dhe një realizim të një vepre me ndikim në publik dhe me taksa publike. nga ana tjetër leja mjedisore të kërkon më parë një proces analizimi mjedisor ose raportim mjedisor, pas të cilës e ka radhën plani i veprimit në mjedis, më pas rregullorja, deri te marrëdhëniet me publikun. E kundërta të shtyn të gabosh.

Në rastin objekt hetimi, a është realizuar përpunimi i mbetjeve urbane në fushën e depozitimit të mbeturinave sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes?

Në bazë të pikës 9.1 "Volumet e punimeve", faqe 25, parashikohet përpunimi i mbetjeve urbane për 91 ditë. Nga vëzhgimet e bëra jo vetëm për këtë rast, por edhe në kuadrin e studimeve e projekteve pilot që kemi dashur të këshillojmë Bashkinë e Leshnjes vite më parë, nuk kemi vërejtur që kjo dampë t'i nënshtrohej një procesi trajtimor. Praktikisht, Bashkia e mëparshme Lushnje është këshilluar që të marrë disa kamiona në ditë argjilë nga pak km larg dhe ta trajtojë me mbulim ditor, javor dhe mujor këtë dampë. Kjo këshillë, vetëm sa është pasqyruar në kontratë, por nuk vërejmë se është zbatuar në kushte praktike, ndaj dhe kemi pasur djegie të tyre. Djegia, me patjetër lidhet me njeriun. Ose ato vetëndizen, në rastin e temperaturave ekstreme në stinën e ngrohtë, për shkak se ato nuk trajtohen, mbulohen, etj., ose ato i djegin për të ulur volumin, në mënyrë që të mos kërkojnë trajtimin e duhur. Këto janë praktika të njohura tashmë, dhe të qëllimshme.

Nga ana e kontraktuesit Bashkia Lushnjë, a është kryer një studim gjeomjedisor, dhe a është përgatitur një raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis për përcaktimin e vendit për depozitimin e mbeturinave të ngurta urbane dhe voluminoze?

Deri më sot, nuk janë kryer studime gjeomjedisore dhe nuk janë porositur nga kontraktuesi studime të tilla. Ndoshta, sepse dampa e hapur dhe e pa organizuar është e trashëguar nga sistemi i kaluar, por gjithsesi një studim gjeomjedisor apo një Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis enkas për këtë vend hedhje apo dampë e hapur do të sillte një perfomancë

tjetër të sistemimit të mbetjeve. Do të sillte një detyrim dhe përgjegjësi tjetër, si nga ana e Bashkisë apo Kontraktorit dhe Kompanisë së kontraktuar. Duhet të ekzistojë një studim për menaxhim të integruar të mbetjeve urbane për këtë Bashki të kryer aty nga viti 2009, diku para zgjedhjeve të fundit lokale, por ai nuk është shoqëruar me plan lokal të veprimit në mjedis, si dhe rregullore për administrimin dhe për zgjidhje lokale të mbetjeve urbane, e cila përbën detyrim për Bashkinë në fjalë. Por, vetë dampa ose fusha e mbetjeve nuk ka, as studim sheshi, as studim gjeomjedisi, e as Raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis - VNM.

Nga: Prof.Dr.Sazan Guri

"G&G" Group

GJYKATA EUROPIANE E AUDITIMIT DHE ZYRA SUPREME AUDITIMIT TË POLONISË NË LIDHJE ME REZULTATET E SHPENZIMEVE BUXHETORE 2014-2020 TË BE-SË

Aktivitetet e auditimit të NIK forcojnë mekanizmin e përmirësimit të menaxhimit dhe auditimin e fondeve të BE-së në administratën publike polake.

Nga : Beata Blasiak-Nowak & Marzena Rajczewska

Këshilltare në Departamentin e Auditimit të Administratës Publike të NIK-ut

Në përputhje me nenin 317 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)[1], Komisioni Evropian (KE) është përgjegjës për zbatimin e buxhetit, por nuk është i përfshirë aktualisht në përditshmërinë e zbatimit të një pjese të rëndësishme të tij. Në bazë të nenit 59 të Rregullores Financiare (FR)[2], pjesa më e madhe e buxhetit të BE-së zbatohet bashkërisht nga KE dhe administratat e shteteve anëtare nën procedurën[3] e "*menaxhimit të përbashkët*". Në rastin e fondeve nën menaxhimin e përbashkët, KE-ja mbështetet në shtetet anëtare për zbatimin e programeve operacionale në nivel kombëtar. Nga ana tjetër, institucionet përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e këtyre programeve akordojnë grante për përfituesit përfundimtarë (p.sh. autoritetet lokale, sipërmarrësit, fermerët, etj).

---

[1] *Version i konsoliduar i TFEU (OJ C 326, 26.10.2012, p.47-390).*

[2] *Në bazë të nenit 59 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në 25 tetor 2012 mbi zbatueshmërinë e rregullave financiare për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (EC, Euratom) Nr 1605/2002 (OJ L 298, 26.10.2012, f. 1-96) (Rregullorja Financiare). Rregullorja përmban të gjitha parimet dhe rregullat që rregullojnë zbatimin e buxhetit të BE-së. Ajo është horizontal në natyrë dhe është e aplikueshme për të gjitha fushat e shpenzimeve dhe të të gjitha të ardhurave. Rregulla të tjera të aplikueshme për zbatimin e buxhetit gjenden në rregulloren sektoriale që mbulojnë politikat individuale të BE-së.*

[3] *Më gjerësisht, shih S. Fazakas, " Zbatimi i buxhetit të Bashkimit Evropian - përgjegjësitë dhe realiteti", dhe Kontrola Państwowa (Auditimi i jashtëm), çështje të veçanta nr. 1/2007, f. 8.*

Shteti Anëtar është përgjegjës për: ngritjen e një sistemi menaxhimi dhe kontrolli që të përputhet me kërkesat e përcaktuara në ligjin[4] e BE-së; duke siguruar se ky sistem funksionon në mënyrë efektive në parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e parregullsive.

KE ushtron një rol mbikëqyrës, duke siguruar që struktura dhe procedurat e sistemit të përmbushin kërkesat. Për këtë qëllim, ajo verifikon efektivitetin e funksionimit të sistemit dhe, nëse është e nevojshme, vendos korrigjime financiare.

Përgjegjësia e Shteteve Anëtare në lidhje me menaxhimin e përbashkët të buxhetit të BE-së përforcohet, në mënyrë të veçantë në nenin 59 të rregullores financiare. Kur një auditim i kryer nga KE ose Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA) konstaton se buxheti është zbatuar gabimisht, Shteti Anëtar është përgjegjës për korrigjimet që janë bërë nga risjellja e fondeve të paguara padrejtësisht nga buxheti i BE-së. Vendimet që kanë të bëjnë me korrigjime të tilla janë marrë nga KE.

Në Poloni, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së lidhur me Komisionin Evropian në maj 2014[5], pagesat nga Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit për periudhën 2014-2020 bëhen nga programet operative ku përfshihen 6 kombëtare dhe 16 rajonale[6]. Përgjegjësia për ushtrimin e auditimit mbi përvetësimet nga Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit shtrihet kryesisht në Shtetin Anëtar, dhe në veçanti në institucionet përgjegjëse për zbatimin e programeve operative me bashkë-financim nga fondet e BE-së. Procedurat e auditimit të zhvilluara nga shteti anëtar duhet të kenë dy karakteristika kryesore:

- duhet të jenë në gjendje për të zbuluar parregullsitë në mënyrë efektive para se ndonjë kontribut publik të paguhet;
- nuk duhet të pengojnë projektet e kryera nga përfituesit.

Karakteristikat e auditimit para faktit

Llojet e mëposhtme të auditimit dallohen në literaturë për kriterin e kohës së zbatimit: para faktit, në vazhdim dhe pas faktit. Sipas S. Kałużny, shqetësimi për një auditim para faktit, i destinuar për aktivitete apo vendime dhe veprime që

[4] *Rregullorja (EU) nr 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 dhjetor 2013, përcakton dispozitat e përbashkëta për Fondin Europian të Zhvillimit Rajonal, Fondi Social Europian, Fondin e Kohezionit, Fondin Bujqësor Europian për Zhvillimin Rural dhe detar si dhe Fondi i Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1083/2006 (OJ L 347, 20.12.2013, fq. 320, i ndryshuar), së bashku me rregullat e zbatimit.*

[5] *https://www.funduszeeuropejskie.gov.pl/media/881/Umowa_ Partnerstwa_pl.pdf*

[6] *Më gjerësisht, shih informacionin mbi rezultatet e auditimit të NIK dhe përgatitjes së sistemit për zbatimin e politikave strukturore për vitet 2014 deri në vitin 2020 në https://www.nik.gov.pl/kontrole/wyniki-kontroli-nik/kontrole,13142.html*

janë ende pa kryer[7]. Sipas mendimit A. Sylwestrzak, një auditim para faktit konsiston në shqyrtimin e një çështje para se të kryhen veprime, psh ajo mund të përmbajë auditimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me investimin e synuar para implementimit[8] të saj. Ajo mund të marrë formën e një auditimi mbi rezultatet e planifikuara për t'u arritur, nga të cilat varet disbursimi i grantit nga fondet e BE-së.

Sipas S. Jedrzejewska dhe H. Nowicki, një auditim para faktit bën të mundur që të ketë një ndikim në përmbajtjen e objektivit të një veprimi të veçantë nga organi që është duke e shqyrtuar për ta ndërmarrë. Në këtë fazë, ndikimi i organit që kryen auditimin është veçanërisht intensiv, kjo mund të rezultojë jo vetëm në një ndryshim në përmbajtjen dhe formën e veprimit të propozuar, por edhe në braktisjen e tij. Shpenzimet buxhetore eficiente të BE-së duhet të jenë prioritet i institucionit që jep fondet. Vlen të përmendet, siç theksohet dhe nga autorët e sipërcituar, që organi i auditimit ushtron një ndikim të drejtpërdrejtë në veprimin e propozuar, si dhe mbi drejtimin e tij, ai angazhohet në një farë mase në kontrollin e aktivitetit dhe mban përgjegjësi për saktësinë[9]. Z. Dobrowolski beson se auditimi para faktit është një mjet për verifikimin dhe vlerësimin e një aktiviteti të planifikuar. Prandaj është një auditim për objektivat, jo për operacione që tashmë janë kryer, dhe si i tillë mund të përshkruhet si paraprak. Një auditim para faktit parandalon gabimet dhe mashtrimet në operacione[10] në të ardhmen. Rezultatet e auditimeve para faktit në programet operative dhe projektet e bashkë-financuara, financohen nga këto programe dhe mund të përdoren nga një Shtet Anëtar për të menaxhuar fonde nga buxheti i BE-së në mënyrë eficiente, me qëllim arritjen e rezultateve optimale.

J. Jagielski tërheq vëmendjen për një aspekt negativ të auditimit para faktit, i cili është verifikimi dhe vlerësimi i qëllimeve që të thotë se, ndërhyrja në funksionimin e subjekteve të audituara është vonuar dhe një auditim i tillë komplikon rrjedhën e zbatimit të detyrave të caktuara. Për më tepër, auditimet para faktit nuk japin hapësirë për vlerësimin e gjithë

[7] *S. Kałużny, Kontrola wewnętrzna. Teoria i praktyka. (Auditi i Brendshëm. Teoria dhe Praktika). PWE (Polish Economics Publisher), 2008, p. 28.*

[8] *A. Sylwestrzak, Auditimi i administratës publike në Republikën e Tretë polake (Auditimi i administratës publike në Republikën e tretë të Polonisë). Publikuar nga Universiteti i Gdansk, f. 9.*

[9] *S. Jedrzejewska, H. Nowicki, (Auditimi i administratës publike). Publikuar nga Comer, 1995 p. 18.*

[10] *Z. Dobrowolski, Bazat Teorike të Auditimit). Publikuar nga Organon, 2003, fq 47. Z. Dobrowolski, faktorët e eficiencës në auditimin shtetëror.Publikuar nga PWSZ (Kolegji Profesional Publik), Sulechów, 2004, fq 40. Z. Dobrowolski, Vazhdimësia dhe Ndryshimet. Organet e auditimit shtetëror në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian). Universiteti i Zielona Gora, 2008, f. 30.*

veprimtarisë, të cilat përndryshe do të mund të eliminojnë dhe ndreqin supozimet themelore të pasakta. Së fundmi, si rezultat i vlerësimeve fillestare dhe miratimit në drejtim të aktivitetit të synuar, përgjegjësia për këtë lloj verifikimi, i një pjese të rezultateve për aktivitetin e kryer, transferohet tek organi që kryen verifikimin.[11].

Rëndësia e auditimit para faktit është theksuar nga përfaqësuesit e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) që i përkasin INTOSAI. Pjesa e dytë e Deklaratës së Limës parashikon që, ndër të tjera, para-auditimi paraqet një lloj para-fakt për shqyrtimin e aktiviteteve administrative ose financiare. Auditimi para-faktit efektiv është i domosdoshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të fondeve publike që i janë besuar shtetit. Ajo mund të kryhet nga një Institucion Suprem Auditimi ose nga institucione të tjera të auditimit. Auditimi para faktit nga një Institucion Suprem Auditimi ka avantazhin e të qenit në gjendje për të parandaluar dëmtimin para se të ndodhë, por ka disavantazhin e krijimit të një ngarkese të tepërt të punës dhe zbehje të përgjegjësive[12].

Përfaqësuesit e SAI-ve të INTOSAI-t kanë theksuar gjithashtu se ndërsa 'a posteriori' i auditimit mund të gjejë vetëm parregullsi kur ato kanë ndodhur tashmë dhe kur është më e vështirë për t'i korrigjuar ato, auditimi 'a priori', sjell nga ana tjetër një sanksion të menjëhershëm: refuzimin për të autorizuar zgjidhje juridike ose financiare të përcaktuar nga SAI[13] në rast parregullsie.

Në Poloni, grupi për standardizimin e terminologjisë së auditimit në administratën publike[14] përcakton auditimin para-fakt si auditim që kryhet pas përfundimit të fazës përgatitore të implementimit të një aktiviteti të veçantë, program apo detyrë, por para marrjes së vendimit për zbatimin e tij[15].

ECA dhe NIK - audituesit e shpenzimeve buxhetore të BE-së

Gjykata Evropiane e Audituesve është themeluar nga neni 285 i Traktatit për të kryer auditimin e financave të BE-së. ECA shqyrton llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve të BE-së dhe të të gjitha organeve të vendosura nga BE-ja. ECA shqyrton ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e të ardhurave të BE-së, shpenzimeve dhe

[11] *J. Jagielski, Kontrola administracji publicznej (Auditimi në administratën Shtetëror). LexisNexis 2006, p. 41.*

[12] *12 ISSAI 1 - The Lima Declaration at http://www.issai.org/media/12901/issai_1_e.pdf*

[13] *http://www.issai.org/media/96001/issai-1000e-incl-footnote-issais-100-400-1992.pdf*

[14] *Ky Ekip në 2004 ka punuar për termat dhe përkufizimet e nocioneve kryesore të lidhura me auditimin. Ekipi është i përbërë nga përfaqësues të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, Kancelari i Kryeministrit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme. Për më tepër, nga ana e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Anëtar të Kabinetit të Gjykatës nga Britania e Madhe kanë marrë pjesë si konsulentë në lidhje me fjalorin.*

[15] *Fjalor i termave që lidhen me auditimin në administratën publike. NIK 2005, f. 36.*

menaxhimin e qëndrueshëm financiar. Ajo përcakton vërejtjet e saj në raporte të veçanta, njofton në raste të parregullsive ose dyshimet për mashtrimit dhe jep opinione formale mbi legjislacionin e BE-së në lidhje me çështjet financiare.

Pas mbylljes së çdo viti financiar, mbi bazën e rezultateve të të gjitha auditimeve të kryera në vitin e caktuar, ECA harton një raport vjetor për zbatimin e buxhetit të Bashkimit Evropian që përmban, në mënyrë të veçantë, një deklaratë sigurie për besueshmërinë e llogarive financiare të BE-së në një vit të caktuar[16]. ECA e transmeton këtë raport institucioneve të tjera të BE-së dhe e publikon atë në Gazetën Zyrtare të BE-së. Raporti vjetor i ECA-s i bëhet prezent Senatit dhe Sejm (dy dhomat e parlamentit polak). Ajo i bëhet prezent edhe NIK dhe ministrive të interesuara (më shpesh Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit, dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural). Rezultatet e punës së ECA-s janë përdorur nga KE, PE dhe Këshilli, si dhe nga Shtetet Anëtare, për menaxhimin e buxhetit të BE-së. Procedura vjetore e raportimit sipas të cilit PE, bazon vendimin e tij për rekomandimet nga Këshilli, vendos nëse zbatimi i buxhetit të vitit të kaluar i KE-së ka qenë kënaqshëm, ku përshkruhet në një masë të konsiderueshme në raportin vjetor të ECA-së. KE zbaton buxhetin[17] në përgjegjësinë e vet dhe në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, ndërsa PE ushtron kontroll politik mbi zbatimin e buxhetit.

Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë (NIK), e cila auditon shpenzimet publike, ku përfshihen fondet nga buxheti i BE-së.

NIK është institucioni shtetëror më i lartë i auditimit në Poloni. NIK shqyrton përdorimin e fondeve buxhetore të BE-së nga organet e administratës publike polake, personat juridikë dhe njësitë organizative. Rezultatet e auditimeve në institucionet kombëtare për zbatimin e fondeve të BE-së dërgohen në Sejm dhe

[16] *Në bazë të nenit 287 (1) të Traktatit, "Gjykata e Auditimit siguron Parlamentin Evropian dhe Këshillin me anë të një deklarate sigurie, për besueshmërinë financiare, ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të cilat do të publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian".*

[17] *Në bazë të neneve 290 dhe 291, 317 me 319 dhe 321 të 323 i TFBE, nenin 179 të Traktatit Euratom dhe dispozitat e Rregullores (BE-së, Euratom) Nr 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 25 tetorit 2012, "Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (EC, Euratom)" Nr 1605/2002 (OJ L 298, 26.10.2012, f. 1-96), Vendimi i Komisionit (BE), nr 1268/2012 e 29 tetor 2012 mbi rregullat e zbatimit të Rregullores (EU , Euratom) nr 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit (OJ L 362, 31.12.2012, f. 1-111) dhe dispozitat e Marrëveshjes Ndërinstitucionale të 2 dhjetorit 2013 ndërmjet Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit për disiplinën buxhetore, për bashkëpunim në çështjet buxhetore dhe në menaxhimin financiar të shëndoshë (OJ L 373, 20.12.2013, f. 1-11).*

Senat, në Këshillin e Ministrave dhe organet e tjera të interesuara, si dhe publikohet në faqen zyrtare të NIK.

NIK auditon menaxhimin e fondeve publike për projektet e bashkë-financuar nga Fondet Strukturore, por nuk është i përfshirë drejtpërdrejtë në zbatimin e fondeve. Parimet e përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e burimeve nga Fondet Strukturore sipas ligjit polak janë të përcaktuara në aktin e Financave Publike[18].

Rregullat për zbatimin e programeve Operative në zonën e Politikave të Kohezionit janë duke u financuar nga perspektiva financiare gjatë viteve 2014 - 2020, subjektet e përfshira në zbatimin e këtyre programeve, politikat dhe mënyrat e bashkëpunimit mes tyre janë të përcaktuara në Aktin e politikave të kohezionit mbi parimet që rregullojnë zbatimin e programeve të financuara nga perspektiva financiare[19] gjatë viteve 2014-2020.

Përdorimi i drejtë i fondeve të marra nga buxheti i BE-së është prezent në të gjitha planet e auditimit të NIK për vitet[20] në vijim. Auditimet për fondet e shpenzuara të BE-së konsistojnë në radhë të parë në verifikimin, nëse përfituesit kanë projekte të zbatueshme në përputhje me marrëveshjet e financimit të projektit, legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e nxjerra nga autoriteti drejtues, organi i ndërmjetëm ose organi zbatues. Pra përfituesit përbëjnë një grup që i nënshtrohet dëpërdrejtërejt një verifikimi të tillë.

NIK kontrollon dhënien e fondeve publike për projektet me bashkë - financim me fondet e BE-së, dhe shqyrton sistemet për menaxhimin dhe kontrollin e programeve operative në nivele të ndryshme. Përveç auditimit vjetor për zbatimin e buxhetit të shtetit, gjatë të cilit shqyrtohen disa aspekte të zbatimit dhe përdorimit të fondeve të BE-së, NIK kryen kontrolle të veçanta në të cilat shqyrtohen çështje të tilla si:

- përcaktimi dhe funksionimi i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të miratuara për programet operative individuale;
- rezultatet e zbatimit të projekteve të realizuara në programet operative;
- kapaciteti institucional i administratës polake për të siguruar pjesëmarrjen e tij në mënyrë efektive në BE.

Shpenzimet e fondeve të BE-së auditohen në mënyrë të pavarur si nga ECA dhe NIK. Kjo kërkon bashkëpunim mes këtyre dy institucioneve. Deri më sot, bashkëpunimi

[18] *Akti Financave Publike i datës 27 gusht 2009 (2013 Fletorja e Ligjeve, pika 885, i ndryshuar).*

[19] *Akti i 11 korrikut 2014 mbi parimet që rregullojnë zbatimin e programeve në fushën e politikës së kohezionit të financuar gjatë 2014-2020 (Fletorja e Ligjeve, pika 1146, i ndryshuar).*

[20] *Planet vjetore të punës së NIK që datojnë nga viti 2008 dhe mund të gjenden në https://www.nik.gov.pl/kontrole/plan-pracy-nik/*

në mes të ECA dhe NIK[21] ka përfshirë kryesisht auditime pas-faktit, ndër të tjera:

- pjesëmarrja e audituesve të NIK si vëzhgues në auditimet e ECA-s të kryera në Poloni;
- lehtësimi i kontakteve të ECA-s me organet kombëtare të cilat duhet të auditohen, në mënyrë që të mund të marrin të dhëna dhe dokumente që ju duhen për të kryer auditimet;
- shqyrtimi i gjetjeve paraprake të dërguara nga ECA në vijim të çdo auditimi dhe, kur justifikohet, paraqitja e komenteve në këto përfundime; dhe
- shkëmbimi i planit periodik të punës.[22]

Në vitin 2014 ECA ka bërë 21 vizita auditimi në Poloni. Këto ekzaminime janë të fokusuara kryesisht në ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve në lidhje me deklaratën e sigurisë. ECA gjithashtu ka kryer auditime të performancës në Poloni në lidhje me :

- programet tregtare të BE-së;
- aktivitetet e transferimit të njohurive dhe shërbime këshilluese në kuadër të programit të zhvillimit rural (RDP);
- efektiviteti i politikës së BE-së për luftimin e eutrofikimit në Detin Baltik;
- përmirësimin e sigurisë për furnizimin me energji.[23]

NIK analizon fushat në të cilat janë zbuluar parregullsi nga ECA në vijimësi. NIK shpesh e bën përdorimin e informacioneve të tilla gjatë hartimit të planit të tij të punës dhe kryerjen e analizave të riskut.

Polonia është një nga përfituesit më të mëdhenj të fondeve evropiane. Auditimet e NIK dëshmojnë se autoritetet polake shpenzojnë para nga fondet e BE-së në mënyrë eficiente dhe korrekte[24]. Në

[21] *H. Weber, Kontrola zewnętrzna w Unii Europejskiej oraz współpraca najwyższych organów kontroli i Europejskiego Trybunału Obrachunkowego w kontroli środków Unii (Auditimi i jashtëm në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimi ndërmjet SAI-ve të BE-së dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve për auditimin e fondeve të BE-së); Kontrola Państwowa (Kontrolli i Shtetit), Çështja Speciale No 1/2007.*

[22] *J. Mazur, Aktywność Najwyższej Izby Kontroli w Unii Europejskiej (aktiviteti i Zyrës së Auditimit të Shtetit polak në Bashkimin Evropian); Kontrola Państwowa nr 3/2014 (State Audit No 3/2015).*

[23] *Sprawozdanie z działalności NIK w 2014 r. (Raport për punën e Zyrës Supreme e Auditimit të Polonisë në vitin 2014) në https://www.nik.gov.pl/plik/id,8902.pdf.*

[24] *Më poshtë jepen shembuj të informacionit mbi rezultatet e auditimit të NIK: Realizacja przez beneficjentów spoza sektora finansów publicznych projektów współfinansowanych ze środków funduszy europejskich - na przykładzie Programu Operacyjnego Innowacyjna Gospodarka (P/11/003); Upraszczanie zasad wdrażania funduszy strukturalnych (P/12/019) (Thjeshtimi i rregullave për zbatimin e Fondeve Strukturore) në https://www.nik.gov.pl/-kontrole/P/12/019/;ps://www.nik.gov.pl/kontrole/P/12/019/; Trwałość projektów współfinansowanych z funduszy strukturalnych na przykładzie wybranych Regionalnych Programów Operacyjnych (P/13/196) (Qëndrueshmëri e projekteve të bashkë-financuara nga*

analizën e zbatimit të buxhetit përfshihen kapituj të veçantë përkushtuar shpenzimeve të BE-së.

Ka një mbivendosje të përgjegjësive midis NIK-së dhe ECA-s për të audituar administrimin dhe përdorimin e granteve nga buxheti i BE-së, administratës polake dhe përfituesit. ECA shqyrton zbatimin e buxhetit të BE-së dhe menaxhimin e financave të BE-së nga ana e KE-së;

Grafiku 1

Numri i ditëve të kaluara nga audituesit e ECA-s për vizitat e auditimeve në 2014



Fondet Strukturore) https://www.nik.gov.pl/-kontrole/P/13/196/; Zamówienia publiczne współfinansowane z Europejskiego Funduszu Rozwoju Regionalnego (P/14/009) (Prokurimi publik i bashkë financuar nga ERDF) at https://www.nik.gov.pl/kontrole/P/14/009/; Przygotowanie systemu wdrażania polityki strukturalnej na lata 2014-2020 (P/14/003) (Përgatitja e sistemit për zbatimin e politikës strukturore për vitet 2014 deri në vitin 2020) në https://www.nik.gov.pl/kontrole/P/14/003/.

Megjithatë, mbi 80% e shpenzimeve të BE-së zbatohet nga Shtetet Anëtare, auditimet e ECA-s janë kryer kryesisht në territorin e Shteteve anëtare. Grafiku më sipër tregon numrin e ditëve të kaluara nga audituesit e ECA-s për vizitat në shtetet anëtare në vitin 2014. Polonia ka marrë numrin e dytë më të madh të vizitave nga stafi auditues i ECA-s, pas Italisë. Numri i madh i vizitave të audituesve të ECA-s në Poloni rrjedh nga fakti se një sasi e konsiderueshme e buxhetit të BE-së është shpenzuar këtu. Për këtë arsye, Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë është një partner i rëndësishëm bashkëpunimi për ECA-n.[25]

Në raportin vjetor për zbatimin e buxhetit të Bashkimit Evropian të 2014[26] ECA tërhoqi vëmendjen për çështjen e arritjes së rezultateve të planifikuara nga Shtetet Anëtare në marrëveshjet e partneritetit të lidhura me Komisionin Evropian, si dhe rezultatet e planifikuara në përputhje me strategjinë Europa 2020. ECA ftoi institucionet Supreme të Auditimit të Shteteve Anëtare në këtë shqyrtim, duke përfshirë edhe Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë. Ky ekzaminim kishte tiparet e auditimit para-faktit, sepse, edhe pse është e vërtetë se ajo është kryer vetëm pas përfundimit të marrëveshjeve

[25] *nik.gov.pl/kontrole/analiza-budzetu-panstwa*

[26] *http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/annualreports-2014/annualreports-2014-EN.pdf*

të partneritetit dhe programeve operative nga Komisioni Evropian, në të njëjtën kohë ishte ende para fillimit të zbatimit të programeve operacionale dhe pagesave paraprake.

Konkluzionet e këtij shqyrtimi të kryer në bashkëpunim me institucionet Supreme të Auditimit të Polonisë dhe Portugalisë ka qenë subjekt i kapitullit 3 të Raportit Vjetor të ECA-s me titull "*Marrja e rezultateve nga buxheti i BE-së*". Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë në bashkëpunim me Gjykatën Evropiane të Auditimit për vendosjen e gjendjes aktuale të fakteve, në bazë të të cilit opinioni i auditimit ishte formuluar më pas.

Raporti vjetor i vitit 2014 i ECA-s, në të cilën përfshihen rezultatet e analizës dhe vlerësimit të NIK, është publikuar më 10 nëntor 2015. Në pikën 3.38 të raportit, në Kapitullin 3 me titull "Marrja e rezultateve nga buxheti i BE-së "(faqe C373 / 99), ECA ka deklaruar si vijon: "Ne u bazuam mbi një analizë të kuadrit ligjor dhe të një shembulli të një prej pesë marrëveshjeve të partneritetit, së bashku me një program për çdo marrëveshje. Këtë vit kemi kryer shqyrtimin e këtyre dokumenteve për Poloninë dhe Portugalinë, në bashkëpunim me Institucionet e Larta të Auditimit të këtyre Shteteve Anëtare. Bashkëpunimi përfshin edhe punën paralele audituese, shkëmbimin e dokumenteve të planifikimit dhe gjetjeve, dhe aktivitetet që kanë për qëllim shkëmbimin e njohurive dhe përvojave fituar në këtë fushë.[27]

Shtetet anëtare supozohen të arrijnë objektivat e planifikuara në marrëveshjen e partneritetit duke bashkë-financuar projektet në programet operacionale të pranuara nga komisioni europian[28]. Këto rezultate janë vlerësuar në bazë të zërave të menaxhimit financiar (ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet), në përputhje me Artikullin 30 për rregullat financiare, të cilat mbulojnë:

a) inpute – financiar, human, material, organizator ose rregullator që do të thotë se ka nevojë për implementimin e programit;
b) outpute – derivatet e programit;
c) rezultate – efektet e menjëhershëm të programit mbi të adresuarin direkt ose pjesëmarrësin;
d) impakti – ndryshime afatgjata në shoqëri që janë, të paktën pjesërisht, të lidhura me veprimet e BE-së.[29]

---

[27] *http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/annualreports-2014/annualreports-2014-EN.pdf.*

[28] *Më gjerësisht, shih B. Błasiak-Nowak, M. Rajczewska, Polityka spójności Unii Europejskiej na lata 2014-2020. programowych Przygotowanie dokumentów (politika e kohezionit të BE-së për 2014-2020. Përgatitja e dokumenteve të programit) dhe Kontrola Państwowa nr 3/2015.*

[29] *Raporti vjetor për zbatimin e buxhetit të të Bashkimi Evropian në vitin 2014, p. 84.*

ECA ka vendosur theksin në rritjen e auditimit "para - faktit", sepse rezultatet e këtyre kontrolleve mund të kenë një impakt me të madh në përmirësimin e operacionit nën ekzaminim, veçanërisht në rastin e auditimeve të performancës. Në raportin vjetor të ECA-s mbi buxhetin e BE-së publikuar në 10 Nëntor 2015, Presidenti kërkon adoptimin e një qasjeje krejt të re të menaxhimit të investimeve dhe të shpenzimeve të BE-së. Ndryshimet madhore në operacionet e të gjithë përgjegjësve për mënyrën se si fondet e BE-së menaxhohen janë esenciale. Siç duket qartë nga prezantimi i raportit vjetor të ECA-s në PE, vendimmarrësit e BE-së duhet, ndër të tjera, të rakordojnë më së miri buxhetin me prioritetet strategjike afatgjata të BE-së. Ligjvënësit e BE-së duhet të sigurojnë që programet shpenzuese të jenë të qarta rreth rezultateve që do të arrihen, ndërkohë që menaxherët financiarë duhet të sigurojnë që paratë e shpenzuara të pajtohen me rregullat dhe arritjet me rezultatet e kërkuara.[30]

Në kontekstin e kësaj forme të re të bashkëpunimit me ECA-në, stafi i NIK ndërtoi një opinion mbi bashkëpunimin me një ekspert të jashtëm[31]:

1) analiza dhe vlerësimi i kohezionit ndërmjet strategjisë, marrëveshjes së partneritetit Europe 2020 dhe periudha 2014-2020 e OP-së;

2) analiza dhe vlerësimi në qoftë së është vënë theksin mbi rezultatet e marrëveshjes së partneritetit dhe OP-së nga 2014 deri në 2020.

Në mars 2015 NIK i dërgoi ECA-së një raport duke përcaktuar opinionin e arritur

[30] *See the ECA's press release on its 2014 annual report at http:// www.eca.europa.eu/-en/Pages/AR2014.aspx.*

[31] *Opinioni i NIK u hartua mbi bazën e rezultateve të ekzaminimit, ndër të tjera, të dokumenteve të mëposhtme: Programowanie perspektywy finansowej - uwarunkowania strategiczne (Programim i perspektivës financiare - kushtet strategjike), i cili u miratua nga Ministri për Zhvillim Rajonal në maj të vitit 2012;*

• Sposób organizacji prak nad dokumentami programowymi związanymi z perspektywą finansową UE 2014-2020 (Metodat për organizimin e punës në dokumentet programore në lidhje me perspektivën financiare të BE-së 2014-2020), të miratuar nga Këshilli i Ministrave në maj të vitit 2012;

• Poziconi i Shërbimevetë Komisionit mbi zhvillimin e Marrëveshjes së Partneritetit dhe programet në Poloni për periudhën 2014-2020, të miratuar nga Komisioni Evropian në shtator 2012;

• Założenia Umowy Partnerstwa 2014-2020 (Supozimet e Marrëveshjes së Partneritetit 2014-2020), të miratuar nga Këshilli i Ministrave në janar 2013;

• Projekt Umowy Partnerstwa (Marrëveshja Draft e Partneritetit për 2014-2020), e cila u hartua nga Ministri për Zhvillim Rajonal në korrik 2013;

• umowa Partnerstwa na lata (Marrëveshja e Partneritetit për 2014-2020) e miratuar nga KE më 17 dhjetor 2014;

•Projekt Regionalnego programu Operacyjnego Województwa Podkarpackiego (Draft ROP për Voivodeship Podkarpackie), të miratuar nga Komisioni Evropian në janar të vitit 2015;

•Regionalny Program Operacyjny Województwa Podkarpackiego (ROP për Voivodeship Podkarpackie), të miratuar nga Komisioni Evropian në shkurt 2015.

mbi bazën e rezultateve të analizave. Në këtë raport, NIK deklaroi se në rastin e Polonisë kishte një lidhje të qëndrueshme dhe të fortë ndërmjet strategjisë, marrëveshjes së partneritetit Europe 2020 dhe OP-së. NIK gjithashtu deklaroi se ka një fokus të veçantë kundrejt rezultateve si të marrëveshjes së partneritetit, ashtu edhe të Programit Operacional Rajonal *Podkarpackie Voivodeship*. Ky fokus drejt rezultateve është më i madh tani në perspektiven e re financiare 2014 – 2020, se sa ka qenë më parë në perspektivat pararendëse financiare të periudhave 2000-2006 dhe 2007 - 2013. NIK ka planifikuar të kryej në 2016 një auditim të rezultateve të implementimit të strategjisë EUROPE 2020, e titulluar (Përdorimi i Fondeve Strukturore për të rritur pjesëmarrjen e njerëzve nga mosha 20 deri në 64 në tregun e punës[32]). Ky do jetë një auditim i kryer njëherësh nga 10 Shtete Anëtare, ku ECA-a do veprojë si një vëzhgues. Do të kryhet në një linjë me programin e adoptuar nga Kontakti i Komitetit për Punën në Grup mbi Fondet Strukturuese[33] në fillim të 2016. Në 2015, si pjesë e këtij auditimi, Komiteti i Kontaktit mandatoi[34] Grupin e Punës për të ekzaminuar mënyrën, me të cilën Shtetet Anëtare përdorin Fondet Strukturuese për të arritur objektivat e strategjisë Europe 2020 në zonat e edukimit dhe/ose punësimit.

"*Europe 2020*" është strategjia 10-vjeçare e BE për rritjen dhe punën. Puna e saj nuk është vetëm të zgjidhë problemet që rrjedhin nga kriza por edhe të rrisë qëndrueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen. Fondet Strukturore të shpenzuara në Shtetet anëtare duhet të kontribuojnë për të arritur objektivat e strategjisë. Për shembull, në Poloni 71% e popullsisë e moshës 20 deri në 64 duhet të jetë e punësuar në 2020. Niveli i ulët i punësimit i të rinjve dhe të rriturve (në raport me mesataren e BE) është një shqetësim i veçantë në Poloni. Administrimi i tij duhet të krijojë kushtet për modernizimin e tregut të punës me një ide për të rritur nivelin e punësimit, ti mundësojë qytetarët të përftojnë aftësi të reja që do t'u mundësojnë atyre

[32] *Materiały analityczne do Planu pracy Najwyższej Izby Kontroli na 2016 rok (Materialet analitike për planin e Zyrës polake Shtetërore të Auditimit për vitin 2016), f. 16.*

[33] *Grupi i Punës për Fondet Strukturore, i cila u krijua nga Komiteti i Kontaktit të Kryetarëve të SAI-ve të BE-së dhe ECA, propozoi që në vitin 2016 dhe 2017 Shtetet Anëtare duhet të kryejnë auditimin e përdorimit të fondeve strukturore për të arritur objektivat e strategjisë Evropa 2020. Subjekt i kontrollit të mëvonshëm të Grupit të Punës është miratuar nga Komiteti i Kontaktit në takimin e Rigës në qershor 2015. NIK merr pjesë në punën e Grupit Punës për Fondet Strukturore dhe ka kryer auditime paralele që nga viti 2004.*

[34] *Rezoluta e Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të Bashkimit Evropian nga Grupi i Punës për Auditimin e Fondeve Strukturore CC-R-2015-03 në http: // www.eca.europa.eu/sites/cc/Lists/ CCDocuments / CC-R-2015-03 / CC-R-2015-03_EN pdf.*

të përshtaten me kushtet e reja dhe ndryshimet e mundshme/potenciale në karrierë, të ulin papunësinë dhe të rrisin produktivitetin e punës.

Konkluzionet

Aktivitetet e auditimit të NIK forcojnë mekanizmin e përmirësimit të menaxhimit dhe auditimin e fondeve të BE-së në administratën publike polake. Kontrollet e tij rrisin llogaridhënien e administratës publike ndaj qytetarëve polakë, dhe atë të Komisionit Europian ndaj Parlamentit.

ECA ka theksuar nevojën për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet parlamenteve, autoriteteve drejtuese dhe institucioneve të auditimit të shteteve individuale anëtare të BE-së. Ai është i mendimit se një bashkëpunim më i ngrushtë krijon hapësirë për përgjegjshmëri më të madhe. Polonia luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Bashkëpunimi auditues mes NIK dhe ECA është duke i dhënë një qasje të re zhvillimit të auditimeve të rregullshmërisë, financiare dhe të performancës, shkëmbimin e përvojave dhe raportimin e rezultateve të auditimit të të dyja parlamenteve kombëtare dhe evropiane.

Bashkëpunimi i NIK dhe ECA-s në lidhje me rezultatet e auditimit të shpenzimeve të buxhetit të BE-së në perspektivën financiare 2014-2020 me qëllim raportin vjetor të ECA-s, për vitin 2014 ka tejkaluar format e mëparshme të bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve. Detyra audituese kryhet së bashku dhe ka karakteristikat e auditimit para-faktit, e cila në këtë rast shqyrton, nëse mënyra në të cilën rezultatet e planifikuara në marrëveshjen e shoqërisë dhe në programin e zgjedhur operativ ka të ngjarë të kontribuojë në arritjen e objektivave të strategjisë *Evropa 2020*.

Rëndësia e një qasje të tillë të auditimit pas-faktit është rritur në kuadër të delegacionit të pushtetit dhe të përgjegjësisë për zbatimin e burimeve buxhetore të BE-së me shtetet anëtare në kuadrin e "menaxhimit të përbashkët", dhe rritjen e përgjegjësisë së shteteve anëtare për zbatimin e buxhetit të BE-së. Duke u tërhequr më shumë vëmendje për rezultatet e planifikuara para fillimit të zbatimit të programeve operative, si dhe kryerjen e më shumë auditimeve para - faktit, mund të kontribuojnë në mbledhjen më të mirë të këtyre detyrimeve nga administratat e shteteve anëtare.

(Botuar në EUROSAI Journal, nr.04, Prill 2016)

Përktheu: Elisa Metaj

Specialiste, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga : Beata Blasiak-Nowak & Marzena Rajczewska

Këshilltare në Departamentin e Auditimit të Administratës Publike të NIK-ut

KORRUPSIONI SI FENOMEN DHE MASAT QË DUHET TË MERREN ME QËLLIM LUFTIMIN E KËTIJ FENOMENI

Korrupsioni është përcaktuar si "Sëmundja e keqe" e kohëve moderne. Kjo vepër penale që së fundmi është shndëruar në dukuri, ka një ndikim të dyfishtë e shkatërrues mbi ekonominë, sigurinë dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore.

Nga: Mirela Kapo (Kandidate doc.) & Msc. Avjerina Bazaj

Departamenti Penal,Fakulteti i Drejtësisë,Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Korrupsioni është përcaktuar si "Sëmundja e keqe" e kohëve moderne. Kjo vepër penale që së fundmi është shndëruar në dukuri, ka një ndikim të dyfishtë e shkatërrues mbi ekonominë, sigurinë dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Duke parë përvojat e hidhura në shtetet fqinje, korrupsioni për Shqipërinë paraqet një sfidë që nuk duket të jetë e lehtë. Do të shohim se çfarë në të vërtetë është korrupsioni dhe pasojat që shkakton në një shtet në zhvillim apo të pazhvilluar, çfarë hapash duhet të ndërmerren me qëllim instituimin e një shteti ligjor.

Me fokus të vecantë do të përqëndrohemi në punën e institucionit suprem të auditimit në shtetin Shqiptar, KLSH-së, me punën e së cilit në mënyrë të veçantë gjatë viteve të fundit ka bërë që jo vetëm të parandalohet por edhe të luftohet fenomeni i korrupsionit.

Në fund do të japim disa rekomandime se si të zvogëlohet shkalla e korrupsionit në një shtet, me theks të veçantë në Shqipëri dhe hapat që duhet të merren nga Qeveria dhe qytetaret në mënynë që të zvogëlohet dhe mundësisht të zhduket kjo dukuri.

Luftimi i korrupsionit, pavarësisht nëse paraqitet në formën e vet aktiv apo pasiv, është jo i lehtë dhe duhet që të gjithë të japin kontributin tonë në mënyrë që të fitohet lufta. Prandaj duke pasur për bazë praktikat e shteteve që kanë luftuar korrupsionin me sukses edhe ne duhet të luftojmë në të njëjtën mënyrë nëse

dëshirojmë që të ndërtojmë një shtet të suksesshëm. Këtë ne duhet ta bëjmë në mënyra të ndryshme, në mënyrë që të zvogëlojmë sa më shumë problemet dhe pakënaqësitë që shkakton kjo sëmundje, që është në interes të popullit dhe të ndërtimit të një shteti ligjor dhe demokratik.

***Fjalët kyce**: Korrupsioni, aktiv, pasiv, demokracia, shtet ligjor, veper penal, sanksion etj.*

Hyrje

1. Kuptimi i korrupsionit

Fjala korrupsion ka prejardhje latine dhe kuptim të gjerë, por në thelb do të thotë *prishje, ndyrje, fëlliqje,...*[1]. Korrupsioni është aq i vjetër, sa edhe historia e njerëzimit. Një përkufizim i këtij koncepti nuk është kurdoherë i lehtë për shkak të larmisë së madhe të formave të shfaqjes së tij. Me gjithë atë, në të gjitha rastet janë prezent disa elementë të përbashkët si: dhunimi i ligjit, i rregullit apo i normave etike, dëmtimi i interesave publike, etj. Korrupsioni realizohet aty ku interesat publike priten me interesat e individëve, gjithmonë në favor të këtyre të fundit. "Korrupsion" do të thotë keqpërdorim i autoritetit zyrtar për përfitime personale, vendosja e një çmimi të paligjshëm për një shërbim ose përdorimi i pushtetit zyrtar për të promovuar qëllime të paligjshme. *"Korrupsioni është shpërdorimi i pushtetit të marrë me delegim për qëllime private"*[2]. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë janë bërë përcaktime ligjore të plota në nenet 244, 245, 259, 260,[3] në përputhje me Konventat Ndërkombëtare.

Korrupsioni është i njohur që nga kohët më të lashta. Ai është fenomen i përhapur në të gjitha pjesët e botës dhe është mendim i gabuar i atyre që mendojnë se korrupsioni është produkt i vetëm disa sistemeve. Fjala korrupsion është një term i paqartë. Edhe në literaturën profesionale përmban kuptime të ndryshme dhe të pa definuara. Ky definicion është aq i shumëllojshëm, aq sa janë edhe organizatat ndërkombëtare qeveritare e joqeveritare.

Në vija të përgjithshme, të gjitha burimet e përkufizojnë korrupsionin si "*shpërdorim të pushtetit publik për përfitime personale, siç është mitmarrja, nga nëpunësit publikë, marrëveshjet e fshehta në prokurorimet publike ose përvetësimi i fondeve publike*." Me një fjalë mund të themi se çdo kush që i shërben vetes, në mënyrë jo morale dhe jo etike, është korruptor.

P.sh. *GRECO*[4] (grup shtetesh të BE-së (kundër korrupsionit) të formuara më 1maj 1999), korrupsionin e definon me marrjen e mitos në mënyrë direkte apo indirekte nga personi që i është besuar një funksion publik apo privat, me qëllim përfitimi për vete apo edhe për persona tjerë.

[1] *Fjalori Latinisht-Shqip. Sabri Saliu, Tetove "Çabej" 2003, fq 86*

[2] *ITAP-i kursi "Etika dhe Korrupsioni", date 08- 09 Dhjetor 2003.*

[3] *Shih Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2010.*

[4] *Shih, për më tepër GRECO*

Kurse *OECD*[5], korrupsionin e definon me marrjen e mitos, apo dhënien e premtimit, nga çdo përfitues me qëllim përfitimi në mënyrë të paligjshme. Ekzistojnë edhe shumë Organizata të tjera, që korrupsionin thjesht e definojnë si keqpërdorim të detyrës si në sektorin publik apo privat.

Shqipëria një vend i dalë nga tranzicioni ka mjaft problem me korrupsionin. Ky i fundit shfaqet më së shumti në drejtësi dhe Administratë Publike, gjithashtu i pranishëm edhe në të gjitha fushat e tjera të jetës shoqërore. Sipas analistëve të ndryshëm në Shqipëri korrupsioni është një nga shkaqet kryesore të varfërisë që mbretëron sot në vendin tonë. Edhe pse kemi shenja të luftimit të korrupsionit mund të themi që korrupsioni në Shqipëri është në shkallë krahasimisht të lartë dhe ndodhemi përpara një vështirësie shumë të lartë të luftimit të tij.

Korrupsioni paraqitet në të gjitha shtetet, por me një shkallë më të gjerë preken shtetet të dala nga lufta, shtetet ish-socialiste, shtetet të dala nga diktatura të gjata, por në përgjithësi janë të prekura ato shtete të cilat kanë shkallë të ulët të demokracisë apo nuk kanë demokraci fare. Korrupsioni nga përvoja e mëparshme është parë të jetë fatal për shtetet në zhvillim dhe të pazhvilluara. Që në këto shtete korrupsioni është i pranishëm në formën më të brishtë të tij. Korrupsionin e hasim pothuajse në të gjitha ndërmarrjet publike. Psh. në shëndetësi, gjyqësor, dogana, politikë etj.

[5] *Shih, për më tepër OECD*

2. Cilët janë shkaqet e korrupsionit?

Faktorët dhe shkaqet e përhapjes së korrupsionit janë nga më të ndryshmet, ata janë institucionale dhe shoqërore. Disa prej tyre janë [6]:

Burokracia tradicionale dhe mos funksionimi si duhet i ligjit dhe i sistemit gjyqësor, përgjegjshmëria e ulët institucionale dhe mungesa e transparencës, të ardhurat e ulta dhe gjendja e rëndë ekonomiko e sociale, papunësia në masë të madhe. Tranzicioni dhe privatizimi i pronës shtetrore bëjnë që korrupsioni të lulëzoi në përmasa të mëdha. Këto përbëjnë një ambient të përshtatshëm për korrupsionin, i cili zëvëndëson ligjin dhe me para mund të kryhet çdo gjë.

Korrupsioni në vetvete është një fenomen abstrakt, por kur integrohet me personin nëpërmjet të cilit ai kryhet bëhet fenomen real. Në çdo shoqëri, pothuajse çdo njeri sprovohet më këtë dukuri negative. Në këtë luftë, shumë njerëz preken nga korrupsioni dhe gradualisht kjo dukuri pranohet si diçka normale pa të cilën nuk mund të kryhet asgjë.

Disa indikatorë të rritjes së korrupsioni janë të njohur. Në vijim do të veçojmë ndërhyrjen shtetërore në sferën e ekonomisë, nëpërmjet ligjeve dhe urdhëresave të ndryshme, sistemi fiskal, vendimet shtetërore për shpenzimet publike ku hynë edhe sigurimi i prodhimeve

[6] *Referuar analizës së bërë nga PHd Naim Mecalla "korrupsioni dhe pastrami i parave".*

me çmime që janë më të ulëta se në treg, financimi i partive politike etj.Por ndër indikatorët që më së shumti ndikojnë në rritjen e korrupsionit janë:

- *Burokracia tradicionale,*
- *Të ardhurat e ulta,*
- *Mosfunksionimi i sistemit gjyqësor,*
- *Kontrolli i pamjaftueshëm institucional,*
- *Rregullat ligjore jo transparente,*
- *Si dhe vet shembulli i udhëheqësve.*

Viteve të fundit janë paraqitur edhe disa indikatorë që kanë ndikuar me të madhe në rritjen e korrupsionit si p.sh:

- *Rritja e intervenimit të shtetit në ekonomi,*
- *Rritja e tregtisë ndërkombëtare,*
- *Si dhe ndryshimet e sistemeve qeverisëse, sidomos kalimi i sistemeve post socialiste në ato demokratike.*

3. Pasojat e korrupsionit në Shoqërinë Shqiptare

Duke qenë një fenomen negativ për çdo shoqëri, korrupsioni shoqërohet edhe me pasoja negative në segmente të caktuara të shoqërisë. Themi veprat korruptive pasi, këtu nuk përfshihen vetëm korrupsioni aktiv dhe pasiv por edhe vepra të tjera penale si shpërdorimi i detyrës etj.Pasojat e korrupsionit mund t'i ndajmë në pasoja ekonomike, sociale dhe politike.

a) Pasojat ekonomike

Përvoja ka treguar se korrupsioni ka dy pasoja kryesore mbi zhvillimin ekonomik. E para, meqenëse suksesi ekonomik varet kryesisht nga shpërndarja optimale e burimeve, ndryshimi i destinacionit të fondeve nëpërmjet aktiviteteve të korruptuara të menaxherëve dhe zyrtarëve përfaqëson një çrregullim të shpërndarjes dhe rrjedhimisht redukton burimet e disponueshme për rritje ekonomike. E dyta, korrupsioni frikëson investitorët dhe dekurajon investimet e huaja direkt duke zvogëluar kështu përdorimin e një burimi kapitali jetësor.

b) Pasojat sociale

Pasojat sociale të korrupsionit janë të shumta, por ato më të rëndësishmet dhe që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pasojat ekonomike të korrupsionit janë: e para, ulja e nivelit të jetesës për pjesën më të madhe të popullsisë, pasi duke ndryshuar destinacionin e fondeve, krijohet një hendek midis dy grupeve atyre që përfitojnë nga korrupsioni (që janë një numër i vogël krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë) dhe pjesës tjetër të popullsisë (taksapaguesve apo atyre që përfitojnë subvencione nga shteti) të ardhurat e të cilëve ulen me rritjen e nivelit të korrupsionit duke ulur në këtë mënyrë nivelin e tyre të jetesës (në Shqipëri një pjesë e mirë e tyre jetojnë nën ose në nivelin e varfërisë); e dyta, rritja e kriminalitetit, jo vetëm sepse korrupsioni në vetvete, përbën një vepër penale, por edhe sepse ndikon, indirekt, në rritjen e veprave të tjera penale si vjedhja. Këtë mund ta konstatojmë fare lehtë po të kemi parasysh të dhënat statistikore në lidhje me kriminalitetin në Shqipëri. Kështu numrin më të madh të veprave penale e përbën

vjedhja, në të gjitha format e saj, duke u pasuar nga vepra të tjera midis të cilave edhe veprat korruptive. Nga ana subjektive motivi i kryerjes së veprës penale të vjedhjes është përfitimi ekonomik. Duke qenë se me rritjen e shkallës së korrupsionit ulet niveli i të ardhurave për pjesën më të madhe të popullsisë, do të kemi një rritje të predispozicionit për kryerjen e vjedhjes si një alternativë për të siguruar të ardhura për jetesë.

c) Pasojat politike

Pasoja kryesore politike e korrupsionit është ulja e besimit të qytetarëve ndaj qeverisjes në përgjithësi dhe qeverisë në veçanti, si përgjegjësja kryesore për nivelin e korrupsionit. Por nga ana tjetër ulja e besimit ndaj qeverisjes dhe qeverisë shoqërohet me pasoja të rënda për shoqërinë që lidhen me forcimin dhe respektimin e shtetit të së drejtës dhe shtetit social, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore etj. Si shembullin më të mirë mund të sjellim korrupsionin në sistemin e drejtësisë, i cili ul ndjeshëm besimin e qytetarëve ndaj organeve të drejtësisë, gjë e cila është mjaft e dëmshme për demokracinë e një vendi, pasi lidhet drejtpërdrejtë me respektimin e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës. Këto të fundit mund të shihen si pasoja indirekte politike të korrupsionit.

Duke e cilësuar korrupsionin si një pengesë për stabilitetin ekonomik, shtetin e së drejtës dhe zhvillimin ekonomik dhe atë social në Shqipëri, përpjekjet për ta luftuar atë nuk kanë munguar dhe kanë qenë të vazhdueshme. Natyrisht që kjo luftë nuk mund të jetë spontane dhe sporadike por kërkon hartimin e një strategjie dhe ngritjen e strukturave të specializuara anti-korrupsion.

Eksperienca tregon se strategji të tilla kanë më shumë mundësi për të qenë të suksesshme nëse ato përmbajnë tre elementë, të cilët janë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin:

- Zbatimi i legjislacionit
- Parandalimi
- Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në përpjekjet anti-korrupsion

Me gjithë rëndësinë që kanë të tre këto elementë në këtë punim do të trajtojë vetëm të parin, pra zbatimin e legjislacionit si mjeti më efektiv në luftën kundër korrupsionit.

Me ndryshimet demokratike të pas viteve ’90 dhe rrjedhave të mëpasshme politiko-ekonomike, ishte i nevojshëm hartimi i një kuadri legjislativ të ri që do t’i përshtatej rrethanave të reja politike dhe ekonomike. Po ashtu aspirata për aderimin në Bashkimin Evropian kërkon, ndër të tjera, reforma në fushën legjislative, siç është përafrimi i legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së *(acquis communitaire*). Për të triumfuar në përpjekjet e tyre për anëtarësimin në BE, shtetet kandidate (midisi tyre edhe vendi ynë) duhet jo vetëm të përshtatin *acquis communitaire*, por edhe ta zbatojnë atë. Kjo u kërkon që të investojnë shumë për një administratë profesionale, për krijimin e institucioneve

dhe procedurave që do të mbështesin zbatimin praktik të legjislacionit ekzistues dhe të afta për ta përshtatur me legjislacionin e së ardhmes së parashikueshme.

Por në përpjekjet e tyre për zbatimin e legjislacionit, mund të krijohet një hendek zbatimi, i cili është deficiti ndërmjet një sërë normash ligjore dhe kapacitetit për ti vënë në jetë dhe për t'i zbatuar ato sipas standardeve demokratike. Siç edhe e kemi theksuar, një hendek zbatimi do të favorizojë korrupsionin. Prandaj është e nevojshme jo vetëm krijimi i institucioneve dhe procedurave që do të sigurojnë zbatimin praktikë të legjislacionit por edhe ushtrimi i një kontrolli mbi masën e zbatimit të legjislacionit. Një rol të madh në këtë drejtim luajnë organet e drejtësisë dhe organet e auditit.

Organet e drejtësisë, në mënyrë të vecantë prokuroria ka kompetenca të plota për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave që lidhen me korrupsionin. Lufta ndaj korrupsionit varet në një masë të madhe nga efektiviteti në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale korruptive nga organet e ndjekjes penale. Po ashtu edhe gjykata kanë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, pasi gjykimi me drejtësi dhe paanshmëri i çështjeve penale që paraqiten para tyre do të rrisë besimin e qytetarëve mbi punën e tyre, çka do të sjellë edhe rritjen e denoncimeve të veprave korruptive nga ana e tyre.

Organet e auditit, janë një hallkë shumë e rëndësishme e sistemit të kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit. Këtu mund të futen kryesisht organe që kanë në kompetencë kontrollin e jashtëm mbi veprimtarinë administrative si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive etj.

Rolin më të madh në këtë drejtim e kanë vetë qytetarët duke zbatuar vullnetarisht ligjin. Arritja e synimeve të politikave të ndjekura nga administrata publike varet në një masë të madhe nga përshtatja vullnetare e qytetarëve dhe ndërmarrjeve me legjislacionin. Një shembull është mbledhja e taksave mbi të ardhurat kur taksapaguesit individualë marrin përsipër llogaritjen dhe transferimin e shumave të detyruara. Në këtë kontekst, efekti kryesorë që kërkohet të arrihet, është të shmanget moszbatimi dhe të përforcohet vullneti për ta zbatuar tek pjesa më e madhe e atyre që nuk zbatojnë ligjin si mjeti më i mirë për të luftuar korrupsionin.

Sot në botë të gjitha shtetet janë apo pretendojnë të jenë shtete demokratike[7], e cila si formë e qeverisjes ka edhe anën e saj negative, përpos të mirave dhe mundësive të reja për shoqëri sjell edhe probleme të ndryshme në shoqëri. Njëri ndër problemet që sjell demokracia është korrupsioni, që zakonisht si dukuri është i shprehur në të gjitha shtetet e botës. Korrupsioni si dukuri bën që të pasurohen udhëheqësit, të pasurit, ata që korruptohen kurse në

[7] *Demokracia është sundimi i popullit për popullin dhe manifestohet në menyrë të drejtëpërdrejt dhe përmes përfaqësuesëve që sot kjo e funditështë më e aplikueshme.*

mënyrë direkte dëmton shtetin dhe indirekt shtresën e mesme dhe të ulët të shoqërisë.

Varësisht nga shkalla e demokracisë dhe ngritja ekonomike ndryshon edhe prania e korrupsionit. Ekzistojnë shumë shtete në botë me shkallë të lartë të demokracisë d.m.th me një ekonomi të zhvilluar, ku shkalla e korrupsionit është në nivelin më të ulët të mundshëm. Kurse shtetet që janë në tranzicion[8] d.m.th që janë të pazhvilluara dhe në zhvillim e sipër, është shprehur në formën më të brishtë të tij dhe ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë shumë probleme në implementimin e demokracisë.

Korrupsioni si fenomen, pa dyshim që është shumë i dëmshëm për shoqërinë. Kjo vjen nga fakti se individë apo grupe të ndryshme, interesat personale i vënë mbi interesat e përgjithshme, që është në kundërshtim të plot me ligjin. Një numër i madh ekonomistësh kanë qartësuar se shoqëria përjeton pasoja katastrofale nga korrupsioni, nga se vjen pengesa kryesore për zhvillimin e një vendi. Shumë institucione ndërkombëtare siç janë institucionet e Bankës Botërore dhe ato të BE-së, kanë vërtetuar se korrupsioni i zvogëlon të ardhurat shtetërore, duke i rritur shpenzimet publike, e kjo ndikon në bilancin defiëitar të pagesave, duke penguar edhe baraspeshimin e tyre. Korrupsioni e pamundëson, shpeshherë edhe e paralizon plotësisht veprimtarinë tregtare, duke e shkatërruar edhe sektorin privat, nëpërmjet pengimit të investitorëve të huaja. E gjithë kjo ka si pasojë, mbetjen mbrapa të teknologjisë vendore si dhe të zhvillimit të prodhimtarisë në përgjithësi, që është një nga faktorët vendimtarë të ecjes para të vendeve të pazhvilluara. Kur korrupsioni i fut rrënjët aq thellë sa të pengojë të drejtat e investitorëve, ekonomistët e ndryshëm theksojnë se atëherë shtetit i është shkëputur një nga obligimet parësore për funksionimin ligjor të tij si shtet. Në veçanti duhet të theksojmë se nuk është ekonomia i vetmi sektor që pëson nga korrupsioni. Korrupsioni godet rëndë zhvillimet e shoqërisë demokratike të shtetit, nëpërmjet pengimit të ekonomisë së tregut. Të veçojmë vetëm disa nga pasojat që e përfshijnë shoqërinë si pasojë e rritjes së korrupsionit, dhe mos pengimit të tij.

Korrupsioni ndikon në:

- *Humbjen e besimit për ekzistimin e drejtësisë ligjore,*
- *Humbjen e besimit publik ndaj shtetit, duke rrezikuar stabilitetin politik,*
- *Zgjerimin e mentalitetit korruptues, në të gjithë sektorët, edhe tek qytetarët, pasi që qytetari arsyetohet se, përderisa korruptojnë udhëheqësit publik pse të mos korruptoj edhe ai.*
- *Drejtpërsëdrejti ndikon në rritjen e mosbesimit në sistemin demokratik,*
- *Bënë rritjen e dallimeve mes të pasurve dhe të varfërve,*
- *Dukshëm zvogëlon investimet e huaja etj.*

[8] *Si Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, Shqipëria dhe shumë shtete tjera anë e kënd botës që janë në ndërtim të një shteti.*

Shkalla e korrupsionit ndër shtete vlerësohet nëpërmjet të dhënave të drejtpërdrejta apo edhe të tërthorta. Të dhëna më të besueshme për korrupsion janë të dhënat nga statistikat e ndryshme policore. Këto të dhëna janë të bazuara në ankesat dhe dënimet zyrtare për korrupsion. Gjithsesi të dhënat faktike vazhdojnë të jenë të vështira për tu mbledhur për mungesë besimi të qytetarëve te sistemi i drejtësisë. Pra korrupsioni është sfidë e pavarësisë dhe profesionalizmit të gjyqësorit, por edhe e Qeverisë, Parlamentit si dhe institucioneve tjera të administratës publike duke mos lënë anash as median dhe shoqërinë civile. Për këtë arsye për të arritur rezultatin e plotë për ekzistimin e korrupsionit brenda shtetit, zhvillohen metoda të ndryshme hulumtimi siç është edhe ajo e anketimit të qytetarëve përmes pyetësorëve zyrtar shtetëror. Sot treguesi më i saktë i rritjes së korrupsionit në botë është *Organizata Joqeveritare Ndërkombëtare IKP (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit)*. [9] Përmban sondazhe nga burime të besueshme duke përdor struktura të ndryshme statistikor që bazohen në të dhënat të cilat merren nga të anketuarit, me të dhëna për punëdhënësit, pastaj, nga analistë të ndryshëm si dhe publiku i gjerë. Para se të bëhen publike të dhënat për korrupsion, mblidhen të dhëna të tjera shtesë nga institucione të pavarura shtetërore për tre vite me radhë.

Formulimi i politikave kundër korrupsionit, për shtetet në tranzicion është i rëndësisë më të veçantë. Në radhë të parë duhet vendosur udhëheqje e besueshme nga populli, si dhe të rritet bashkëpunimi reciprok i dy palëve. Përpjekja e kthimit të besimit nga ana e qeveritarëve duhet të jetë maksimale. Besimi i krijuar në masë do të mundësonte edhe reforma të reja, vlera e të cilave do të rritej vetëm me rezultate objektive. Kjo do të ndikonte në uljen e papunësisë, dhe të varfërisë. Sado që korrupsioni si fenomen i ka indikatorët e përbashkët, sidomos në vendet postkomuniste apo vendet në tranzicion, korrupsioni dallon nga shteti në shtet, ashtu siç dallon edhe gjuha, tradita dhe zakonet e shtetit.

4. Kontrolli i Lartë i Shtetit si Institucioni më i lartë i auditimit publik në vend

Misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit është:

Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë nga pushteti qendror e lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjeshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat më të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

[9] *Shih për më tepër Organizata joqeveritare ndërkombëtare IKP (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit.)*

KLSH[10] me një angazhim të vazhdueshëm konstruktiv në luftën kundër korrupsionit, e konsideron të domosdoshëm hartimin e një ligji që të trajtojë në mënyrë të plotë rastet e përgjegjësive materiale të të punësuarve në sektorin publik, me qëllim parandalimin e dukurive që nxisin dëmtimin e fondeve dhe aseteve publike. Në kushtet e përgjegjësisë së ulët financiare të zyrtarëve publikë, ky institucion i ka rekomanduar Kuvendit në vijimësi për dy vitet e fundit radhazi hartimin e ligjit "Për përgjegjësinë materiale", në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

Krahas sa më sipër me praktika shkresore të veçanta [11], ky rekomandim i është adresuar Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendës Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kryetarit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend dhe Ministrit të Financave.

Nga auditimet e kryera, KLSH ka konstatuar mjaft probleme dhe shkelje të dispozitave ligjore në fonde të konsiderueshme publike, që kanë sjellë shpenzimin e tyre pa kriter dhe efiçiencë, ose

edhe më keq, shkuarjen dëm të një pjese të tyre, nga keq menaxhimi financiar. Institucioni më i lartë i auditimit publik është përpjekur të përcaktojë përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë që kanë kontribuar në këto keqpërdorime të fondeve publike, duke propozuar masa në formën e sanksioneve, kundrejt parregullsive financiare të shkaktuara prej tyre dhe të konstatuara.

Vlerësimi dhe matja e dëmit dhe adresimi i përgjegjësisë materiale kërkon procedura më konkrete, të detajuara. Përgjegjësia e përbashkët shfaqet edhe në formën e përgjegjësisë për vendimmarrjen publike. Një vendimmarrje e gabuar, rrjedhojë e një organi kolegjial (bord drejtues, këshill mbikëqyrës, komitet, etj), mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në menaxhimin e fondeve publike. Praktika na ka mësuar në shumë raste kur vendimmarrjet kolegjiale, kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në fondet shtetërore, por nuk kemi një rast të vetëm, kur shumat e humbura të jenë rikuperuar, si rrjedhojë e zhdëmtimit nga personat që kanë përgjegjësi materiale. Duhet theksuar se rol në vendimmarrjet kolegjiale nuk kanë vetëm anëtarët e forumit përkatës (bord, këshill, etj.) por mbi të gjitha Drejtuesit e Lartë të Institucioneve si edhe punonjësit që përgatisin vendimmarrjet, duke marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes. Ata nuk mund të lihen jashtë përgjegjësisë materiale solidare. Përgjegjësia materiale publike mund të jetë e plotë dhe e

[10] Raporti vjetor i K.L.Sh-së për vitin 2015.
[11] (Nr 659 Prot, datë 06.07.2015)

pjesshme. Pavarësisht përgjegjësisë së plotë të punëmarrësit (një nëpunës shtetëror), shuma e shpërblimit të dëmit ndaj fondit ose asetit përgjegjësia materiale mund të jetë e drejtpërdrejtë ose indirekte. Kështu, për dëmet e shkaktuara nga punëmarrësi, i cili ka përgjegjësi direkte, menaxherët e niveleve më të larta (shefi i sektorit, i drejtorisë e deri tek titullari i institucionit) mund të kenë përgjegjësi indirekte, për shkak se nuk i kanë ushtruar si duhet funksionet e mbikëqyrjes dhe kontrollit ndaj vartësit-përgjegjës i drejtpërdrejtë i shkaktimit të dëmit. Përgjegjësia indirekte e niveleve më të larta të menaxhimit shfaqet edhe në rastet kur dëmi nuk është vetëm monetar por lidhet me ndryshimin e destinacionit të burimeve publike, shkeljen e disiplinës financiare dhe buxhetore etj.

Objekt i këtij ligji duhet të jetë caktimi i shpërblimit të dëmit, sipas pjesëmarrjes dhe rolit të nëpunësit publik në shkaktimin e dëmeve. Ligji duhet gjithashtu të sigurojë një proces të qartë e transparent të shpërblimit të dëmit ndaj interesave publike, duke vendosur edhe një balancë mes mundësive reale të punonjësit zhdëmtues dhe duke ruajtur minimumin jetik. Ai duhet të sanksionojë përgjegjësinë materiale të titullarëve të subjekteve publike për vendimmarrjet e gabuara në dëm të interesave publike. Ligji duhet të përcaktojë po ashtu edhe kriteret se kur përgjegjësia materiale shndërrohet në përgjegjësi penale.

Për sa më sipër nga ana e KLSh është rekomanduar: Ngritja e një grupi pune[12] me specialist dhe përfaqësues të legjislativit, që do të vlerësojë dhe punojë për hartimin e Ligjit "Mbi përgjegjësinë materiale" në të cilën të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

5. Kallëzime penale të bëra ng ana e KLSH-së.

Në auditimet e realizuara përgjatë vitit 2015, janë konstatuar një sërë shkeljesh të qëllimshme të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi nga ana e një numri të konsiderueshëm nëpunësish dhe ish-nëpunësish të administratës shtetërore të të gjitha niveleve me pasojë jo vetëm shkaktimin e dëmeve ekonomiko-financiare ndaj buxhetit të shtetit por edhe dëmtimin e interesave të tjera ligjshme të shtetit Shqiptar, për të cilat KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzimet penale.

Në total numri i kallëzimeve për vitin 2015 ka qenë 51 kallëzime penale për 159 persona, nga

të cilët:

- 1 Ministër[13],

[12] Raporti vjetor K.L.SH, fq.22, pika 6.
[13] Aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë po zhvillohet procesi penal ndaj një ish Ministri, falë punës së suksesshme të bërë nga ana e KLSh-së, që

- 1 Avokat i Përgjithshëm i Shtetit,
- 1 Sekretar i Përgjithshëm Ministrie,
- 38 Drejtor Drejtorie,
- 13 Kryetar Bashkie,
- 2 Kryetar Komunash.

Trendi i kallëzimeve penale sipas niveleve të drejtimit për vitet 2014-2015 rezulton:

Ndërkohë që referuar kallëzimeve penale të kryera përgjatë vitit 2014 KLSH ka dërguar pranë organit të Prokurorisë 41 kallëzime penale për 149 persona.

Referuar të dhënave statistikore të ofruara nga ana e KLSH-së, ka një rritje të kallëzimeve si në auditimet e institucioneve të nivelit qendror dhe në atë vendor. Rritja është si në numër rastesh dhe në numër personash të kallëzuar.

Për vitin 2015 ***dëmi ekonomik*** që i është shkaktuar buxhetit si pasojë e shkeljeve të trajtuara në këto kallëzime penale arrin në ***85,837,736 mijë lekë*** nga ***5,069,494 mijë lekë*** që ka qenë për vitin 2014 dhe ***1,166,061*** lekë të vitit 2013.

Ajo që vlen të përmendet, për vitin 2015 është rritja e cilësisë së përgatitjes së dosjes për kallëzim penal fakt që ka shkurtuar edhe kohën e përgatitjes së kallëzimeve. Duke bërë krahasimin e kallëzimeve penale të realizuara për periudhën 2008-2011, me kallëzimet penale të realizuara në periudhën 2012-2015 rezulton se ato janë rritur me 3.2 herë.

6. Kontributi i KLSH-së për forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë të atyre që janë në poste të larta dhe shkelin ligjin si dhe në luftën kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit, në të cilën KLSH dhe institucionet e tjera shtetërore duhet të angazhohen, si dhe pritshmëritë e opinionit të gjerë publik në lidhje me punën tonë në këtë drejtim, parashtrojnë kërkesën e kryerjes së kësaj lufte në vazhdimësi, pa kompromis dhe ndaj çdo institucioni apo nëpunësi[14].

Kjo kërkesë e domosdoshme për arritjen e një standardi të pranueshëm mirëqeverisjeje, imponon nevojën e të pasurit të një vullneti të fortë dhe konstant institucional në mos tolerimin e asnjë rasti korrupsioni pavarësisht nivelit ku ai shfaqet apo shkallës së shtrirjes së tij.

Këtë vullnet dhe kontribut institucional, në forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë, sidomos ndaj zyrtarëve të lartë të administratës shtetërore, shkelës flagrant të ligjit dhe mosbesues ndaj ekzistencës së forcës ndëshkuese të shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka treguar në mënyrë konstante gjatë këtyre tre viteve të fundit ku në numrin e konsiderueshëm të rekomandimeve tona për dhënien e masave disiplinore, largimit nga detyra si dhe bërjes së kallëzimeve penale janë përfshirë

ka pasur si qëllim evidentimin e shkeljeve të kryera gjatë kohës që ka ushtruar funksionin public ky shtetas.

[14] Aktiviteti i K.L.SH-së, faqja web http://ëëë.klsh.org.al/ëeb/pub/raporti_i_performances_se_klsh_2015_2727_1.pdf

nëpunës të nivelit të lartë drejtues të administratës shtetërore.

Nisur nga shkalla e zbatueshmërisë së Urdhrit të Kryeministrit , nr. 70, datë 18.04.2006 "Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit ose të Ministrave" dhe e rezultateve që ai ka mundur të prodhojë deri më sot në praktikë, kërkohet që për vetë kushtet aktuale të administratës shtetërore si dhe nivelit të korrupsionit të perceptuar dhe konstatuar gjerësisht, ky urdhër nga qeveria e tanishme të pranohet ose të përmirësohet e ripërtërihet në kuadër ridimensionimit dhe rikonceptimit të luftës ndërinstitucionale kundër korrupsionit.

Përsa i përket luftës kundër korrupsionit, KLSH i është përmbajtur me rigorozitet detyrimeve dhe angazhimeve të tij institucionale si institucioni më i lartë dhe i pavarur i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, të sanksionuara këto në Ligjin e tij organik nr. 154/2014 "Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe në Planin Strategjik

Neni 15/gj i Ligjit nr. 154/2014, përcakton: "*Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet t'u drejtohet organeve të ndjekjes penale në rastet kur ndjekja e mëtejshme e zbulimeve nga auditimi është kompetencë e tyre*".

Për periudhën Janar – Dhjetor 2015, KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë 51 kallëzime penale për 159 persona, nëpunës dhe ish-nëpunës të administratës shtetërore të të gjitha niveleve, përfshirë këtu edhe Ministrin aktual të Energjisë dhe Industrisë dhe Avokatin e Shtetit.

Referuar akuzave penale të ngritura nga KLSH në këto kallëzime, shumica e tyre i përkasin veprave penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (57% të kallëzimeve penale) dhe "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", parashikuar nga nenin 258 i Kodit Penal (43% të kallëzimeve penale).

Në shkeljet e konstatuara nga KLSH gjatë auditimeve, të cilat i përcillen më pas organit të Prokurorisë, në formën e kallëzimeve penale, KLSH evidenton dhe argumenton kryesisht ekzistencën e elementëve të veprave penale të "Shpërdorimit të detyrës", "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", "Falsifikimit", etj.

Në angazhimin e KLSH, si institucion suprem auditimi, në luftën kundër korrupsionit, dy janë problemet kryesore të cilat shqetësojnë dhe në një farë mënyrë frenojnë arritjen e rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit: 1) Moszbatimi i pa argumentuar i rekomandimeve të KLSH nga ana e institucioneve shtetërore, sidomos përsa i përket masave disiplinore të largimit nga detyra të funksionarëve dhe drejtuesve të lartë shtetëror, për të cilët KLSH ka konstatuar një sërë shkeljesh të

rënda në ushtrimin e detyrës së tyre funksionale duke depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzime penale konkrete; 2) Përpjekja aktuale dhe tendenca e qëllimshme e forcave të ndryshme politike për të etiketuar disa prej auditimeve të KLSH si auditime politike.

Për sa më sipër dhe duke përmbledhur, duhet thënë se institucioni suprem i auditimit në Republikën e Shqipërisë ka kontribuar në mënyrë efikase me qëllim zbulimin e dëmit eknomik në vite. Konkretisht duke iu referuar të dhënave statistikore shihet se dëmi ekonomik i zbuluar në vitin 2008 është 4 miliard lekë, për vitin 2009 është 7.3 miliard lekë, ndërkohë që gjatë vitit 2012 e në vazhdim shënohet një trend në rritje për sa i përket zbulimit të dëmit ekonomik. Konkretisht shifrat flasin qartë së në vitin 2012 zbulueshmëria shënon 13.5 miliard lekë, në vitin 2013 -15 miliard lekë, viti 2015-125.8 miliard lekë.[15]

Këto shifra janë tregues i qartë se KLSH, si institucion suprem i auditimit ka kontributin e vetë, efikas dhe të çmuar në luftën kundër korrupsionit.

Auditimet e performancës në vitet 2012-2015 kanë njohur zhvillim cilësor dhe sasior, duke u rritur mbi 2,5 herë në krahasim me periudhën 2008-2011 referuar numrit të auditimeve dhe afro 4 herë referuar numrit të institucioneve të mbuluara me këtë lloj auditimi. Zhvillimi i auditimeve është në linjë dhe në përputhje të plotë me objektivat e paravendosura në planin strategjik 2013-2017 (të ripunuar) dhe me planin vjetor të vitit 2015.

7. Mënyrat për të luftuar korrupsionin.

Ashtu siç është problematike definimi i korrupsionit ashtu është edhe formulimi i politikave në secilin shtet për ta luftuar atë. Për këtë arsye, specialist profesionist të BE-së kanë formuluar edhe kritere të veçanta për luftimin e korrupsionit që duhet përmbushur nga të gjitha vendet që dëshirojnë të aderojnë në këtë bashkësi. Në rend të parë është sigurimi i gjyqësisë së pavarur, në zbulimin dhe dënimin e korrupsionit, që nuk duhet të mbetet i pa sanksionuar. Është me rëndësi të përkujtojmë rastin kur BE-ja më 2008 ka pezulluar fondin e konsiderueshëm të parashikuar për Bullgarinë pikërisht për shkak të mungesës së progresit në reformat antikorrupsion dhe në drejtësi, që argumenton këmbënguljen e Komisioni Evropian, për domosdoshmërinë e reformave. Edhe organizatat ndërkombëtare luajnë rol të veçantë në luftë kundër korrupsionit. *Në rend të parë* synohet krijimi i disponimit për ta luftuar korrupsionin, nëpërmjet programeve të ndryshme që u ofrohen. Bashkëpunimi me qytetarët është detyrë kryesore e këtyre programeve, pasi vetëm ky bashkëpunim do të sillte rezultatin e synuar.

Më 1999, OKB-ja në Kongresin e saj ka miratuar programin e plotë, për vendet e saj anëtare për të luftuar korrupsionin. Kurse Organizata për bashkëpunim dhe

[15] Aktivititeti I KLSh-së, të dhëna statistikore faqja 14, Raporti vjetor 2015.

zhvillim ekonomik OECD[16], në bashkëpunim me Agjencinë Qeveritare Amerikane për zhvillim USAID[17], kanë formuar rrjetin kundër korrupsionit, për vendet në tranzicion, që mundëson bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave, rreth indikatorëve të korrupsionit, të cilat ndihmojnë për formulimin e politikave për ta luftuar atë. Me një fjalë, korrupsioni është e keqja apo gangrena që edhe mund ta bëjë shtetin inekzistent. Qëllimi parësor i çdo qeverie duhet të jetë pikërisht luftimi i korrupsionit me të gjitha mekanizmat ekzistues.

8. Konkluzione

Si përfundim, mund të themi se korrupsioni është një fenomen që ka lindur me njerëzimin dhe do të zhduket bashkë me të. Por, duke qenë një ulçër e të gjitha shoqërive, që shkaktohet nga rrethana të përgjithshme të natyrës njerëzore dhe nga faktorë të veçantë që pasqyrojnë zhvillimin dhe natyrën e një shoqërie të caktuar dhe që shoqërohet me pasoja negative të natyrës ekonomike, sociale dhe politike, lufta ndaj tij mbetet përherë një sfidë e hapur dhe mjeti më efektiv për ta realizuar është zbatimi praktik i legjislacionit.

Në këtë drejtim, protagonistë janë vetë qytetarët, duke zbatuar vullnetarisht ligjin, për shkak të besnikërisë ndaj tij. Por kurdoherë, mbetet e hapur mundësia e moszbatimit nga të ashtuquajturit "kalorësit e lirë" (free-rider), të cilët mundohen të përfitojnë nga praktikat e institucionalizuara duke mos kontribuar në to dhe në këtë rast del në pah roli i organeve që merren drejtpërdrejtë me zbatimin e legjislacionit dhe atyre që kontrollojnë këtë zbatim dhe vënë në vend pasojat që rrjedhin nga ky moszbatim.

Ne jemi në ndërtim të një demokracie pra jemi në fazën e tranzicionit. Pikërisht nga praktikat e shteteve në tranzicion kemi vërejtur se korrupsioni si dukuri është parë të jetë si një nga sfidat më të rënda në ndërtim të një shteti demokratik. Institucionet e Shqipërisë duhet të kenë prioritet luftën kundër korrupsionit në mënyrë që të zhvillohet ekonomikisht shteti. Të përqendrohen kryesisht në luftën kundër korrupsionit dhe dënimin e të korruptuarve me gjobën e merituar. Mirëpo nuk mjafton vetëm institucionet që lufta kundër korrupsionit të fitohet, por duhet të vetëdijesohemi ne që mos të pranojmë të dhurojmë *mite* për kryerjen e një pune apo për zgjidhjen e një problemi që na paraqitet.

Korrupsioni është një sëmundje që ngadalë po e shkatërron Shqipërinë. Prandaj qytetarët dhe liderët tanë duhet t'i bashkojnë forcat që të asgjësojmë këtë sëmundje fatale derisa nuk është vonë. Luftimi i korrupsionit është jo i lehtë dhe duhet që të gjithë të japin kontributin tonë në mënyrë që të fitohet lufta. Prandaj duke pasur për bazë praktikat e shteteve që kanë luftuar korrupsionin me sukses edhe ne duhet të bëjmë projekte konkrete për luftimin e korrupsionit dhe ato të vihen në

[16] *Shih për më tepër Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik , OECD.*
[17] *Hptt/ëë.USAID,com*

përdorim. Duhet të bëhen thjeshtësime të procedurave qeveritare në mënyrë që të mundësohet dhe të perceptohet funksionimi më i mirë i biznesit dhe të minimizohen fushatë dhe hapësirat ku do të mund të vihet në pah korrupsioni. Krijimi i një kuadri të duhur ligjor dhe institucional për parandalimin e korrupsionit.

E kzistojnë edhe shumë hapa të ndryshëm që duhet të merren për luftimin e korrupsionit. Duhet që të përcaktohet me ligje çështja e korrupsionit si dhe të zhduken boshllëqet në legjislacionin ekzistues d.m.th të krijohen ligje të cilat caktojnë qartë atë që sot quhet *Korrupsion* dhe të përcaktohen qartë sanksionet që prekin personat të cilët ushtrojnë korrupsionin aktiv apo pasiv.Të përcaktohet qartazi nga kuadri logjor se çfarë kuptohet me termin "ushtrimi i korrupsionit nga zyrtarët e lartë". Cilët do të ishin zyrtarët e lartë, të cilët përmenden nga ligji?

Nuk janë vetëm institucionet të cilat duhet të luftojnë korrupsionin, por ekzistojnë edhe shumë faktorë që kanë rolë kyç në luftën kundër korrupsionit.

Nisur nga fakti se dënohet korrupsioni në format e veta "aktiv" dhe "pasiv" kjo ka bërë që qindra qytetarë të mos denoncojnë nga frika e ndëshkimit, pasi statistikat gjyqësore kanë treguar se janë dënuar në të njëjtën masë "autorët" dhe "të dëmtuarit" nga vepra penale.[18]

Do të ishte me eficiencë, që dhënësi i "mitës" të konsiderohet viktimë e veprës penale të korrupsionit dhe ndaj tij të ofrohet një politikë penale me qëllim rehabilitimin e viktimës dhe jo ndëshkimin e saj.

Një nga "luftetarët" që mund të themi është Katalizator i luftës kundër korrupsionit është media. Ngritja e kapacitetit të medias dhe lirisë së shtypit dhe lirin e shprehjes së gazetarëve dhe analistëve lidhur me korrupsionin dhe çështje të tjera lidhur me Shqipërinë.

Dihet se lufta kundër korrupsionit është e pamundur nëse kemi një varfëri të lartë dhe një mesatare të pagave çfarë është sot në Shqipëri. Prandaj duhet që të zhvillohen dhe implementohen strategji për zhvillim ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe ngritjene pagave të punëtorëve të institucioneve publike. Kryesisht të mësuesve dhe mjekëve si shtresat e shoqërisë shqiptare të cilat statistikisht janë më të prekurat nga korrupsioni për shkak edhe të të ardhurave të tyre modeste.

Një hap tjetër shumë i rëndësishëm do të ishte decentralizimi i pushtetit lokal dhe i shërbimeve publike, duke i vendosur shumë shërbime publike nën mbikëqyrjen e përbashkët me qeveritë komunale. Ky veprim do të plotësonte dëshirat e shumicës së Shqipëtarëve, të cilët besojnë se shërbimet do të funksiononin më mirë në nivelin lokal. Decentralizimi do të thjeshtësonte dhe kristalizonte fushatën e shërbimit, si dhe do ta sillte Qeverinë më

[18] Të dhëna statistikore të mara nga Gjykata e Shkallës së Parë për krime të Rënda.

afër qytetarit. Kjo do të mundësonte që të zvogëlohen fusha e veprimit të korrupsionit, sepse qytetari nuk do të ketë nevojë që të japë mitë apo ryshfet për tu pajisur me një dokument të udhëtimit sepse ai mund të nxirret shumë shpejt edhe pa ryshfet. Gjithë kjo do të sjellë një klimë ku do të përmisohet jeta e qytetarit në Shqipëri dhe do të minimizohet fenomeni i quajtur *korrupsion.*

Vetëm një bashkim i forcave do të mundësonte fitimin e luftës kundër korrupsionit sepse në këtë luftë nuk mundet të na ndihmoj askush. Kjo luftë do të fitohet vetëm më bashkim dhe punën e palodhshme dhe të pamëshirshme kundër të korruptuarve.

Biblografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2008
- Kodi i Proçedurës Penale së Republikës së Shqipërisë ,Tiranë 2010
- Kodi Penal i Republikes se Shqipërisë (Maj 2009).
- Organizata joqeveritare ndërkombë-tare IKP (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit)
- Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik, OECD.
- Raporti i misionit "Euralius për Shqipërinë"
- USAID
- GRECO
- OECD
- www.coe.int;
- Ismet Elezi, Komentar i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal, me ligjin nr.23 datë 01.03.2012. Shtëpia Botuese "Erik", Tiranë 2012 .
- Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2015.
- Aktiviteti i KLSH-së, faqja web http://www.klsh.org.al/web/pub/raporti_i_performances_se_klsh_2015_2727_1.pdf.
- Performance Vjetore e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë.

Nga: Mirela Kapo (Kandidate doc.) & Msc. Avjerina Bazaj

Departamenti Penal,Fakulteti i Drejtësisë,Universiteti i Tiranës

MUNDËSITË PËR ZBATIMIN E PRAKTIKAVE TË QEVERISJES SË MIRË DHE LLOGARIDHËNIES PËR NDJEKJEN DHE AUDITIMIN E OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË AMERIKËN LATINE

Nëse Qeverisja është trajtuar si "Aftësia e Shtetit dhe e Shoqërisë për të gjeneruar një sistem të ndërlidhur në fusha të ndryshme të qeverisjes, i cili garanton koherencën, saktësinë dhe efektivitetin e politikave publike në tërësi, pjesëmarrjen dhe vlerat etike; të gjitha sa më sipër nevojiten për të përmbushur të drejtat e qytetarëve, paqen, bashkëjetesën dhe prosperitetin ekonomik, mjedisor dhe social në mënyrë që të sigurojnë përmirësimin në tërësi të cilësisë së jetesës"

Nga: ***Luis Fernando Velasquez Leal***
Drejtor Ekzekutiv
Corporación Acción Ciudadana Colombia – AC-Colombia[1] director@ac-colombia.net

Bilanci i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit - OZHM- (2000-2015), në Amerikën Latine, Karaibe dhe në botë evidentoi disa mangësi në konceptimin, planifikimin, vlerësimin dhe procesin e monitorimit. Në fakt, formulimi i OZHM reflektoi mungesën e vizionit të plotë të zhvillimit në objektivat e propozuara, nga një perspektivë sistemike, e cila do të mund të çonte në rezultate më homogjene. Në veçanti, ekzistojnë katër aspekte të rëndësishme, të cilat merren parasysh gjatë formulimit të OZHM në mënyrë që të gjenerojnë një zhvillim të qëndrueshëm, të drejtë dhe të barabartë:

1. Prerja tërthore e çështjeve mjedisore në politikat e qëndrueshme publike për zhvillimin ekonomik dhe social;

[1] *Corporación Acción Ciudadana Colombia -AC-Kolumbi është një organizatë civile, e cila punon që prej vitit 1996 për të promovuar dhe për të konsoliduar iniciativat demokratike, frymëzuese të zhvillimit të mirë qeverisjes, qytetarisë dhe auditimit në nivel ndërkombëtar, të drejtat e njeriut, kulturën e paqes dhe pajtimit në Kolumbi. Sot AC-Kolumbi bashkëpunon me OLACEFS, me qëllim përmirësimin e praktikave të mirë qeverisjes në Amerikën Latine dhe Karaibe. www.ac-colombia.net.*

2. Forca institucionale si një bazë për zbatimin optimal, monitorimin dhe pajtueshmërinë e OZHM-ve;
3. Kompleksiteti për të formuluar disa tregues, të cilët mundësojnë matjen në mënyrë të kuptueshme të progresit të zbatimit;
4. Pasiguria e sistemeve të informacionit që janë në dispozicion. Siç u vu në dukje nga raporti Rajonal i Monitorimit të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) në Amerikën Latine dhe Karaibe, për vitin 2015, një nga pengesat kryesore për të përmbushur qëllimet dhe treguesit, kryesisht në vendet në zhvillim, është mungesa e qeverisjes[2].

Nëse Qeverisja është trajtuar si "Aftësia e Shtetit dhe e Shoqërisë për të gjeneruar një sistem të ndërlidhur në fusha të ndryshme të qeverisjes, i cili garanton koherencën, saktësinë dhe efektivitetin e politikave publike në tërësi, pjesëmarrjen dhe vlerat etike; të gjitha sa më sipër nevojiten për të përmbushur të drejtat e qytetarëve, paqen, bashkëjetesën dhe prosperitetin ekonomik, mjedisor dhe social në mënyrë që të sigurojnë përmirësimin në tërësi të cilësisë së jetesës"[3], është e qartë se rezultatet e OZHM-ve treguan problemet që lidhen drejtpërdrejtë me procesin e planifikimit qeveritar në aspekte të tilla si:

1. Përfshirjen sistematike të OZHM-ve në planet qeveritare në nivele të ndryshme rajonale;
2. Disponueshmërinë e sistemeve të përshtatshme të informacionit që përfshijnë regjistrimin e të dhënave të veprimeve që duhen ndërmarrë dhe prezantimin e raporteve të konsoliduara në mënyrë që të ndiqen, monitorohen, vlerësohen dhe auditohen;
3. Mungesën e mekanizmave për të matur shkallën e plotësimit të pritshmërisë së përfituesve dhe mungesën e hapësirave adekuate për pjesëmarrjen e qytetarëve për të formuluar, ekzekutuar dhe kontrolluar burimet publike të investuara në programe.
4. Pasigurinë e proceseve buxhetore të orientuara për të kristalizuar OZHM-të.

[2] *Për më shumë informacion ju lutemi konsultohuni me: Komiteti Ekspert i Administratës publike i Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara: Forcon aftësinë kombëtare dhe rajonale për menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm (2014). Gjendet në: http: //workspace.unpan.org/sites/Internet/Documents/UNPAN92617.pdf.*

[3] *Ky përkufizim i termit "Qeverisje" është hartuar prej AC-Kolumbi, bazuar në analizën e studimeve të specializuara, praktikat e mira të identifikuara në projektet e tyre në Amerikën Latine dhe pyetjeve të ndryshme adresuar palëve të interesuara. 2015.*

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se nivelet e ulta të qeverisjes përjashtojnë mundësitë që përpjekjet të fokusohen në forcimin e marrëdhënieve mes shtetit dhe shoqërisë civile, si dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e menaxhimit publik, qasjes në informacion dhe për këtë arsye kontrollin qytetar mbi ekzekutimin e programeve kombëtare që çojnë në konkretizimin e tyre.

Formulimi i axhendës së 2020 –Objektivat e Zhvilllimit të Qëndrueshëm – OZHQ nisi me eksperiencën e përfituar nga implementimi i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit 2000-2015. Ndryshimi i parë u fokusua në qasjen: ndërsa OZHM i adresohet eliminimit të varfërisë, OZHQ propozoi një ndryshim në drejtim të dinjitetit të njerëzve, të planetit dhe prosperitet, me qëllim forcimin e paqes globale dhe aksesin në drejtësi[4]. Ndryshimi i dytë bazohet në formulimin e axhendës: për OZHM-të u mblodh një grup ekspertësh botërorë ndërsa OZHQ ishte rezultat i një procesi pune dhe negociatash të rëndësishme midis 193 anëtarëve të OKB-së; aspekti i tretë, i cili bëri ndryshim në formulimin e OZHM-ve ishte se i vetmi përgjegjës për ekzekutimin ishte qeveria e secilit vend, ndërsa për OZHQ, për shkak të madhësisë dhe fushëveprimit, strategjia përfshin bashkëpunimin, aleancat dhe koordinimin midis palëve të ndryshme të interesuara, duke përfshirë qeveritë, parlamentet, entet lokale, shoqërinë civile të organizuar, sektorin privat, SAI-t (Institucionet Supreme të Auditimit) dhe qytetarët[5].

Si rezultat i procesit global të dialogut, Axhenda e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm është hartuar dhe deklaruar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në shtator 2015[6]. Edhe kur axhenda globale e OZHQ paraqet një vizion zhvillimi më gjithëpërfshirës, për të realizuar objektivat për 2030 nënkuptohet një përmirësim i cilësisë së qeverisjes, si dhe auditimi i sistemeve për të rritur nivelet e përgjegjësisë dhe koordinimin midis aktorëve.

---

[4] *Kombet e Bashkuara. El cambio hacia la dignidad 2030: acabar con la pobreza y transformar vidas protegiendo el planeta. (Ndrysho nëpërmjet dinjitetit 2030: Për të eliminuar varfërinë dhe për të ndryshuar jetën, duke mbrojtur planetin). Raport përmbledhës i Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm pas vitit 2015. 2014. Gjendet në:* http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/69/700&referer=http://www.un.org/en/documents/&Lang=S.

[5] *Komiteti Evropian Social dhe Ekonomik. Dokument informues. Mundësitë dhe proceset për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në implementimin e Axhendës post 2015. Gjendet në:* https://bapi.eesc.europa.eu/documentsanonymous/eesc-2015-01169-00-02-ri-tra-es.docx

[6] *Për të kërkuar përmbajtjen e Agenda 2030, shko tek:* http://nacionesunidas.org.co/ods/

Në këtë kuptim, Komiteti i Administratës Publike i Këshillit Social dhe Ekonomik të Kombeve të Bashkuara, iu rekomandon vendeve të përqëndrojnë përpjekjet e tyre drejt një qeverisjeje transformuese që merr në konsideratë vizionin e të gjithë aktorëve, të cilët përfaqësojnë sektorë dhe interesa të ndryshme[7]. Përveç kësaj, kjo qeverisje duhet të fokusohet në forcimin e kapaciteteve individuale dhe institucionale, si dhe të shoqërisë në tërësi, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të krijuar në mënyrë adekuate transformime strukturore për të krijuar dhe arritur zhvillimin[8]. Ky forcim i aftësive është hartuar për të kuptuar qeverisjen në një kuptim më të gjerë, me një qasje pjesëmarrëse që lejon përfshirjen dhe ripërcaktimin e rregullave, rolet e institucioneve, si dhe marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, rritjen e kapitalit social dhe përshtatjen e vendeve ndaj sfidave të globalizimit, përveç përmirësimit të aftësisë për të reaguar para cikleve të përsëritura të recesionit ekonomik botëror[9].

Bazuar në rishikimin e qëllimit dhe sfidave në tema të tilla si qeverisja dhe përgjegjshmëria për të implementuar axhendën e re të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Axhenda 2030, duke u bazuar në kornizën ndërkombëtare, vendimet, deklaratat dhe rekomandimet e OKB-së, INTOSAI[10] dhe OLACEFS[11], mund të deklarohet se implementimi i OZHQ ofron një mundësi të jashtëzakonshme për të forcuar monitorimin dhe auditimin e programeve dhe projekteve për të kristalizuar qëllime të tilla.

Në këtë kuptim, është e rëndësishme që të merren parasysh konsideratat e mëposhtme, për të ecur përpara me shpejtësi drejt adoptimit të praktikave të mirë-qeverisjes, në raport me OZHQ:

1. Rezoluta 69/228 e Kombeve të Bashkuara: Promovimi dhe inkurajimi i eficencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike me anë të forcimit të Institucioneve Supreme të Auditimit, pranon "rolin e SAI-t në inkurajimin e qeverive, në drejtim të përdorimit të burimeve dhe performancës për

[7] *Komiteti Ekspert i Administratës Publike për Ekonominë dhe çështjet Sociale i Kombeve të Bashkuara: Forcimi i aftësive kombëtare dhe lokale për menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm\ las capacidades Nacionales y locales para la Gestión del desarrollo sostenible (2014).* http://workspace.unpan.org/sites/Internet/Documents/UNPAN92617.pdf

[8] *I njëjti burim.*

[9] *I njëjti burim.*

[10] *INTOSAI. Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit. Për më shumë informacion shkoni në:* http://www.intosai.org/

[11] *OLACEFS. Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit për vendet e Amerikës Latine dhe Karaibet. Për informacion të mëtejshëm vizitoni:* http://www.olacefs.com/

arritjen e Objektivave të Zhvillimit"[12];

2. Përmes marrëveshjes 1115/11/2014 OLACEFS miratoi mjetet për të implementuar parimet e llogaridhënies të përcaktuara në Deklaratën e Parimeve *(Declaracion de Asuncion)* të vitit 2009, duke u fokusuar në promovimin e leadership-it të SAI-t dhe përfshirjen e sektorit të arsimit, institucioneve qeveritare, legjislativit, subjekteve të kontrollit, mediave, bashkëpunimit ndërkombëtar, organizatave qytetare dhe qytetarëve, të implementojnë praktika të mira të qeverisjes në Amerikën Latine"[13];
3. Konkluzionet dhe rekomandimet e Simpoziumit të 23-të të Kombeve të Bashkuara / INTOSAI rreth Zhvillimeve të Post Axhendës 2015: Roli dhe mundësitë e SAI-ve në implementimin e zhvillimit të qëndrueshëm, thekson pritshmëritë e palëve të interesuara në lidhje me SAI-t, të tilla si iniciativa që SAI-t të ofrojnë informacion relevant rreth shërbimeve të tyre qeveritare dhe rekomandime, i cili nga nga ana e tij do të jetë "Informacion me cilësi të lartë dhe me një përdorim shumë eficient, efektiv dhe ekonomik"[14];
4. Roli i auditimit dhe roli i SAI-ve në ndjekjen dhe kontrollin e programeve dhe projekteve të cilat kristalizojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm-OZHQ përfshihen në axhendën ndërkombëtare si pjesë e diskutimeve teknike të Asamblesë së XXVI OLACEFS që do të mbahet në tetor 2016 dhe Kongresit të XXI INTOSAI-INCOSAI në dhjetor 2016;
5. OLACEFS në Deklaratën e Cuzco në 2014: "SAI-t dhe Qeverisja Publike: Kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor", i cili përcakton një rrugë për mirë-qeverisje për SAI-t, kur konsideron se mirëqenia e shoqërisë, demokracia dhe zhvillimi i qëndrueshëm me drejtësinë sociale janë qëllimet prioritare të mirë qeverisjes publike.

Në të njëjtën mënyrë, është e rëndësishme të merren në konsideratë rezultatet e hulumtimit "Mundësitë për forcimin e sistemeve të auditimit dhe përgjegjësia në implementimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm –OZHQ"[15], të hartuara nga *Corporacion Accion Ciudadana Kolumbi* -AC Kolumbi, me financim nga GIZ, prej nëntorit 2015

[12] *Për informacion të mëtejshëm vizitoni: http://www.tribunaldecomptes.ad/pdf/objectius/Resolution_69_228_es.pdf*

[13] *Për informacione të mëtejshëm vizitoni http://www.olacefs.com/wp-content/uploads/2014/12/244.pdf*

[14] Për më shumë informacion vizitoni: http://www.intosai.org/fileadmin/doënloads/downloads/5_events/symposia/2015_23rd_symposia/23_UN_INT_Symp_S_Final_Conclusions_consolidated_04_March_2015.pdf

[15] *Për raportin e plotë, vizitoni: http://www.olacefs.com/la-ctpbg-presenta-informe-sobre-oportunidades-de-fortalecimiento-respecto-de-la-implementacion- de-los-objetivos-de-Desarrollo-sostenibles-ods/*

në shkurt 2016, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit për fuqizimin e mirë-qeverisjes CTPBG (në spanjisht), e cila paraqet një propozim të bazuar në pyetje të fokusuara për qeveritarët, ligjvënësit, mediat dhe aktorët e shoqërisë civile, me pjesëmarrjen e SAI-ve të Kolumbisë, Hondurasit dhe Guatemalës. Këto SAI-e lehtësuan identifikimin e mundësive për ndjekjen dhe auditimin e OZHQ, në nivele rajonale, kombëtare dhe lokale, bazuar në parimet e mirë-qeverisjes dhe llogaridhënies së Deklaratës së Parimeve *(Declaracion e Asuncion)*[16], aktualisht duke u konsultuar me OLACEFS dhe palët e tjera të interesuara.

Si ilustrim, parimet e llogaridhënies së Deklaratës së Parimeve *(Declaracion de Asuncion)* ofrojnë një mundësi për të përmirësuar cilësinë e mirë-qeverisjes dhe auditimit gjatë implementimit të OZHQ, duke përdorur mekanizma të hartuara nga SAI-t dhe nga subjektet lokale të auditimit, të cilat janë:

Parimi 1. Përgjegjshmëria është baza e mirë-qeverisjes

1. Të nxisë studime të specializuara për të përmirësuar të kuptuarit e llogaridhënies dhe ndikimin e saj në politikat publike që lidhen me implementimin e OZHQ;
2. Të nxisë zhvillimin e strategjive përmes cilësimit të llogaridhënies si një parim i mirë-qeverisjes, që siguron elementë të tillë si informacioni, shpjegimi, përgjegjësia dhe ndëshkimi, në bazë të kuadrit ligjor të çdo vendi;
3. Të nxisë përmirësimin e planifikimit qeveritar rreth OZHQ, në mënyrë të tillë që subjektet përgjegjëse të konsiderojnë konsistencën dhe koherencën mes Axhendës 2030, qëllimeve qeveritare kombëtare dhe strategjike dhe planeve qeveritare në të gjitha nivelet, lokale, rajonale dhe kombëtare;
4. Të marrë pjesë në diskutime teknike të fokusuara në përmirësimin e ndjekjes së treguesve të menaxhimit në përputhje me politikat, objektivat zhvillimore dhe qëllimet në nivel kombëtar;
5. Të përfshijë kompetencat legjislative dhe ekzekutive për të marrë feedback-un e rezultateve të arritura gjatë zbatimit të OZHQ;
6. Të promovojë dhe bëjë publike një raport mbi llogaridhënien përmes implementimit të OZHQ, si mbështetje teknike për pushtetin legjislativ.

Parimi 2. Detyrimi për të informuar dhe justifikuar

1. Të drejtojë dhe motivojë subjektet qeveritare dhe subjektet e tjera përgjegjëse për zbatimin e programeve dhe projekteve të cilat kristalizojnë OZHQ, të implementojë protokollet e

[16] *Për t'u njohur me Deklaratën e Parimeve të mirë-qeverisjes dhe llogaridhënies së OLACEFS, vizitoni: http://www.olacefs.com/p1148/*

informimit të qytetarëve, përmes përdorimit të faqeve institucionale të internetit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Informacioni duhet të lidhet me buxhetet dhe shpjegime rreth tyre; planet e investimeve, buxhetin për të ardhurat dhe shpenzimet, raportet e auditimit dhe gjykimet e jashtme dhe planet e përmirësimit institucional, ndër të tjera sugjeruar në nenin "Mjetet për realizimin e parimeve të llogaridhënies së Deklaratës së Parimeve (*Declaracion de Asuncion)*[17];

2. Të përmirësojë cilësinë e Auditimit dhe të raporteve, të cilat ndihmojnë në dhënien e informaciont për analizat dhe vendimmarrjen publike, në lidhje me zbatimin e OZHQ;
3. Të promovojë implementimin e sistemeve të informacionit të lidhura me regjistrimet e programeve dhe projekteve të cilat materializojnë OZHQ, me informacionet themelore dhe specifike mbi: qëllimin dhe shumat e programeve, të dhënat e përmbaruesit, progresin, informacionet financiare, modifikimet e buxhetit dhe kostot e operacioneve, ndër të tjera;
4. Të japë rregullisht informacion rreth indikatorit të sjelljes si një input për matjen e menaxhimit publik dhe rezultatet e zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e OZHQ;
5. Të bëjë publik informacionin në lidhje me menaxhimin institucional dhe llogaridhënien, në mënyrë të tillë që palët e interesuara dhe grupet e tjera të jenë në gjendje të analizojnë dhe vërtetojnë informacionin e siguruar në lidhje me implementimin e OZHQ;
6. Të gjenerojë hapësira për të përhapur, me qëllim për të informuar, rezultatet e vendimeve të auditimeve, në mënyrë që njerëzit të njohin numrin e auditimeve të realizuara, me theks të veçantë në auditimet që lidhen me financat e shtetit dhe ndikimin e tyre në politikat publike;
7. Të promovojë krijimin dhe forcimin e hapësirave të informimit për qytetarët në lidhje me menaxhimin dhe rezultatet e programeve të OZHQ: dëgjimet e llogaridhënies publike, konferenca shtypi dhe mekanizma të tjerë të transmetimit.

Parimi 3. Gjithëpërfshirja e sistemit të llogaridhënies

1. Të përgatisë një hartë shpjeguese mbi mënyrat e implementimit të OZHQ në nivel qeveritar;
2. Të zhvillojë programe informuese dhe trajnuese drejtuar mediave, qytetarëve dhe organizatave qytetare mbi rregullat dhe politikat e aplikuara për auditimin e programeve të cilat kristalizojnë OZHQ, duke theksuar

[17] *SAI-et dhe llogaridhënia. Krijimi i bazave të përbashkëta për të forcuar kontrollin e jashtëm në Amerikën Latine. Mjetet për zbatimin e parimeve të « Declaracion de Asuncion ». 2014, vizitoni:* http://bibliotecavirtual.olacefs.com/gsdl/collect/artculos/archives/HASH5cbf.dir/RENDICION.pdf

hapësirat e pjesëmarrjes të përshtatura për kontrollin social dhe llogaridhënien mbi punën e zhvilluar;

3. Të zhvillojë iniciativa për të forcuar kontrollin e brendshëm të subjekteve qeveritare duke theksuar ato që lidhen me zbatimin e OZHQ, të cilat përfshijnë hapësirat për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe dhënien e opinionit në lidhje me cilësinë e shërbimeve të përfituara;
4. Të përgatisë analizë krahasuese, që lejon vizualizimin e programeve që rezultojnë në OZHQ, në lidhje me cilësinë e jetesës së qytetarëve;
5. Të promovojë ndjekjen nga ana e qytetarëve të planeve të përmirësimit që rrjedhin prej rekomandimeve të auditimit.

Parimi 4. Transparenca e informacionit

1. Të zhvillojë sisteme informacioni për qytetarët në lidhje me investimet sociale dhe shërbimet e ofruara prej shtetit në implementimin dhe kristalizimin e OZHQ;
2. Të forcojë strategjitë informuese qeveritare, në faqet e internetit, përmes publikimit të raporteve të auditimit, planeve të përmirësimit dhe rezultateve të implementimit;
3. Të inkurajojë institucionet qeveritare përgjegjëse për zbatimin e programeve që përmirësojnë mundësitë, cilësinë dhe saktësinë e informacionit.

Parimi 5. Sanksionimi prej mospërputhjes

1. Të forcojë analizën që lidhet me efektivitetin e sistemit të sanksioneve të cilat janë në fuqi në vend, që përfshijnë qeverinë, ligjvënësit, akademikët, median, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët dhe të informojë rreth aplikimit gjatë procesit të implementimit të OZHQ;
2. Të paraqes faktorët që krijojnë një menaxhim jo të mirë të programeve, të cilat kristalizojnë OZHQ dhe të shpërndajë këtë informacion, si pjesë e inputit që garanton përmirësimin e menaxhimit institucional dhe inkurajon sanksionimin social;
3. Të informojë në lidhje me sanksionet ekonomike apo administrative të vendosura, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Parimi 6. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve

1. Të inkurajojë të gjitha institucionet përgjegjëse për implementimin e OZHQ, të shtojnë në manualet e tyre hapësira operative për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe kontrollin social, krahas zonave për koordinim mes tyre dhe zyrat e tyre të kontrollit të brendshëm;
2. Të forcojë strategjitë e ndihmës dhe orientimit për qytetarët, duke optimizuar shërbimet e informacionit, zgjidhjes së ankesave, pretendimeve dhe kërkesave;
3. Të promovojë marrëveshje

bashkëpunimi me organizatat qytetare dhe qytetarët për të ndjekur, monitoruar dhe për të zhvilluar kontrollin social të programeve të kristalizimit të OZHQ;

4. Të zhvillojë programe për forcimin e aftësive të organizatave civile dhe qytetarëve në lidhje me kontrollin shoqëror, zyrat mbikëqyrëse dhe auditimet sociale të përfshira në proceset e kontrollit institucional;
5. Të promovojë zhvillimin e aplikacioneve për telefonat celularë, të cilat iu bëjnë të mundur qytetarëve të kërkojnë institucionet në programet, të cilat mund të kristalizojnë OZHQ.

Parimi 7. Kuadri i plotë ligjor për llogaridhënie

1. Të identifikojë mundësitë për përmirësimin e kuadrit ligjor, lidhur me planifikimin, vlerësimin dhe llogaridhënien prej të gjitha niveleve, kombëtare, rajonale, departamentale dhe komunale.
2. Të promovojë zhvillimin e ushtrimeve publike të llogaridhënies me cilësi të lartë, në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme, që iu kërkohet subjekteve qeveritare prej SAI-ve dhe qytetarëve, në përputhje me rregullat në fuqi.

Parimi 8. Lidershipi i SAI-t

1. Të bëjë të ditur dhe të qartësojë praktikën institucionale të parimeve të llogaridhënies të *"Declaracion de Asuncion"* në implementimin e programeve OZHQ;
2. Të shpallë rezultatet e auditimeve për të gjitha palët e interesuara;
3. Të socializojë praktikat e mirë-qeverisjes dhe llogaridhënies të identifikuara gjatë implementimit të programeve që kristalizojnë OZHQ.

Së fundi, është e rëndësishme të merret në konsideratë që ndjekja dhe auditimi i OZHQ nënkupton domosdoshmërisht marrjen parasysh të aspekteve teknike kryesore, të tilla si:

1. Përcaktimi i objektivave, qëllimeve dhe treguesve të OZHQ të marra përsipër prej secilit vend;
2. Përfshirja e këtyre tezave të angazhimeve kombëtare, rajonale, lokale dhe komunale, në mënyrë të tillë që të jetë një objektiv i qartë institucional i zhvillimit kombëtar nën fokusin e Axhendës 2030;
3. Ndërveprimi institucional dhe koordinimi permanent mes planifikuesve të politikave publike, ekzekutuesve, kontrollorëve, sipas fushëveprimit të auditimit si dhe mbikëqyrjen qeveritare tipike në përputhje me organizimin institucional të çdo vendi;
4. Pjesëmarrja pluraliste e sektorëve të zhvillimit dhe aktorëve që lidhen me implementimin e OZHQ;
5. Kërkesa për risi në lidhje me proceset dhe procedurat për politika konkrete, programet dhe projektet që

kristalizojnë OZHQ institucionale;

6. Krijimin e hapësirave të reja për dialog, ndërveprim dhe veprim në lidhje me formulimin e politikave, programeve dhe ekzekutimin e projekteve, si dhe kontrollin institucional në aspektet e auditimit. Këto hapësira duhet të jenë të vlefshme për përpjekjet institucionale, si dhe për përpjekjet sociale, ndër të tjera, në përputhje me rregullat në fuqi në secilin vend të rajonit.

Në të njëjtën mënyrë, nga pikëpamja e auditimit të OZHQ, SAI-t, dhe në rastin e kontrollit të decentralizuar, degët rajonale të SAI-ve kombëtare, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e implementimit të politikave, programeve dhe projekteve që kristalizojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Përveç kësaj, këto entitete kanë në dispozicion të tyre një kuadër ndërkombëtar të siguruar prej INTOSAI-t, si dhe një hapësirë rajonale me njohuri teknike, si OLACEFS (Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve), një organizatë e aftë për të siguruar hapësirat vendimtare të koordinimit me Zyrat e Sistemit të Kombeve të Bashkuara në rajon, me fushëveprim në Amerikën Latine si dhe hapësirat e koordinimit me SAI-t e OLACEFS, përmes përdorimit të komiteteve, komisioneve dhe grupeve të brendshme të punës, në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e anëtarëve të tyre, në lidhje me OZHQ.

OJQ "Aksioni Qytetar Kolumbi" (AC-Columbia), botuar në revistën e OLACEFS

Nga: Luis Fernando Velasquez Leal Drejtor Ekzekutiv Corporación Acción Ciuda-dana Colombia – AC-Colombia director@ac-colombia.net

ROLI I ECA LIDHUR ME REAGIMIN E BE NDAJ KRIZËS FINANCIARE

ECA me të drejtë duhet të mësojë dhe të vazhdojë reformat e saj për të siguruar se ajo i paraprin gjithmonë problemeve, duke përgatitur veten për të përmbushur kërkesat e zhvillimeve të ardhshme në BE, si dhe të ketë fleksibilitetin e nevojshëm në kuadër të përgjigjes në kohën e duhur.

Nga: Dr. Louis Galea, Anëtar i ECA-s

Procesi i reflektimit nga ana e ECA

Kriza financiare ka filluar në vitin 2007 në sektorin bankar dhe më pas ka pasur një ndikim negativ në qëndrueshmërinë e borxhit sovran, stabilitetin e Euros, zhvillimin dhe në besimin e publikut. Për zgjidhjen e krizës u kërkuan masa urgjente dhe të jashtëzakonshme në nivelin e BE-së dhe vendeve anëtare. Reformat gjithashtu kanë qenë të nevojshme për ristrukturimin afatgjatë të kornizave financiare, ekonomike dhe politike të qeverisjes.

Procesi i reflektimit nga ana e ECA-s në lidhje me këto zhvillime duhet pranuar që filloi shumë vonë, pas valëve të para tronditëse të vitit 2007 dhe impaktit të pësuar në vitin 2009. Përpjekja e parë për të ndryshuar kushtet është bërë në vitin 2011 me publikimin e një letre me titull "Pasojat për përgjegjësinë publike dhe auditimin publik në BE dhe roli i ECA në dritën e krizës aktuale financiare dhe ekonomike".

Ky dokument shënoi një pikë kthese në vëmendjen e ECA-s për zhvillimin e roleve të qeverisjes financiare dhe ekonomike në nivel të BE, duke regjistruar faktin e marrjes së një numri masash të reja, rregullatore dhe financiare si edhe atë që subjekte të reja janë duke u zhvilluar apo u janë caktuar role të reja, të cilat kërkojnë shqyrtim të auditimit dhe llogaridhënie demokratike. Kjo letër theksoi lidhjen e rëndësishme ndërmjet reagimit të BE-së ndaj krizës financiare dhe implikimet e rëndësishme për përdorimin e fondeve publike në BE. Ajo gjithashtu theksoi se ndryshimet e bëra në politikën ekonomike të Bashkimit Evropian ngritën sfida të reja për

llogaridhënie, transparencë dhe auditim publik.

Ky dokument kishte një ndikim shumë të rëndësishëm në tre procese paralele që kanë ndodhur në vitin 2011 dhe 2012:

Së pari, një debat më i gjerë ishte duke u zhvilluar njëkohësisht në nivel ndërkombëtar (INTOSAI) dhe ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit Evropian (EUROSAI). Një debat i njëkohshëm po ndodhte edhe në mes të audituesve dhe parlamenteve kombëtare dhe komiteteve të tyre përkatëse të specializuara për shqyrtim publik mbi aspekte të ndryshme të qeverisjes ekonomike, financave publike dhe të mbikëqyrjes bankare. Një rezolutë e Komitetit të Kontaktit të SAI-ve të BE-së lëshuar në vitin 2012 përmblodhi shqetësimet në lidhje me detyrat dhe rolin e auditimit të jashtëm publik nën dritën e zhvillimeve që po ndodhnin. E njëjta rezolutë nuk mund të bëjë një shqyrtim të thellë të zhvillimeve dhe të informojë të gjithë SAI-t brenda BE-së përsa i përket rolit të tyre në lidhje me zhvillimin e qeverisjes ekonomike brenda BE-së dhe Eurozonës, pa lancimin e një task force të ngarkuar për të bërë këtë.

Së dyti, në kuadër të ECA, një proces i rishikimit strategjik për periudhën 2013-2017 është duke u zhvilluar dhe në këtë kontekst, ECA është përpjekur për të përcaktuar rolin e saj të ardhshëm në lidhje me ndryshimet e shpejta dhe zhvillimet që po zënë vend. ECA identifikoi reagimin e krizës financiare, si një nga elementet më të rëndësishëm të ndryshimit, të menjëhershëm dhe afat mesëm.

Strategjia zhvilloi më shumë pyetje se përgjigje, dhe dërgoi në ECA zhvillimin e një qasje të re për trajtimin e ndryshimeve të shpejta në mjedisin e saj. Komentet e para të ndërmarra, u bënë me qëllim për të studiuar zhvillimin e mjedisit të auditimit, mbulimin përkatës të auditimit, boshllëqet e mundshme dhe mbivendosjet me proceset e tjera të auditimit.

Strategjia gjithashtu pranoi rolin sfidues që ECA kishte për të luajtur në kontekstin e ri të BE-së dhe traktateve të tjera, zgjedhjeve strategjike dhe performancës Evropa 2020, si dhe rolin që kanë institucionet e BE-së në përkrahjen e aktiviteteve të shteteve anëtare jashtë kuadrit të TFEU.

Punimi i ECA-s është publikuar më pas, në vitin 2014, duke treguar nivelin e fragmentuar, kompleks, shumë-pjesëmarrës, sistemin mbrojtës të strukturave qeverisëse financiare dhe ekonomike, duke identifikuar një gamë të gjerë të strukturave të ndryshme ligjore, një grup të subjekteve, dhe një nivel shumë të paqëndrueshëm dhe të dobët të kontrollit publik dhe llogaridhënies demokratike.

Së treti, një proces i reflektimit, filluar në kuadër të Dhomës së IV-t, e cila ishte caktuar tradicionalisht përgjegjëse për auditimin e subjekteve që kishin një lidhje të drejtpërdrejtë me krizën financiare dhe të reagimit ndaj saj (subjekte të tilla si Banka Qendrore Evropiane, agjencive të

ndryshme të cilat janë përfshirë në EBA, ESMA dhe EFSA). Fokusi kryesor i Dhomës së IV-t në atë kohë ishte auditimi financiar i llogarive vjetore dhe me pak ai i fokusuar në aspektet e performancës së punës së tyre. Realizimi i parë në këtë drejtim ishte rreziku i dështimit të subjekteve të ndryshme në nivel të BE-së për të kryer rolet e reja, ky ka qenë një rrezik për BE-në dhe financat publike të të gjitha shteteve anëtare, në atë masë që garantoi një kapacitet shumë më intensiv dhe të fokusuar të auditimit të specializuar brenda ECA.

Një projekt me ekip të veçantë

Gjatë vitit 2013, ECA krijoi një ekip të veçantë të projektit për të ndërtuar kapacitetin e tij në fushën e auditimit të qeverisjes financiare dhe ekonomike të BE-së (FEG). Anëtarët e Dhomës së IV-t, së bashku me Mark Crisp (Drejtori i Dhomës IV) dhe Zaharias Kolias përgjegjës i ekipit të projektit FEG, koordinuan të gjitha aspektet e identifikimit të ekipit, përzgjedhjen dhe ngritjen e tij. Ekipi i projektit FEG përbëhej fillimisht nga njëmbëdhjetë auditues nga e gjithë ECA me profilet dhe ekspertizat e tyre respektive. Falë përpjekjeve të barabarta të fokusuara në zhvillimin profesional dhe trajnues, që ishte në gjendje të siguronte ekspertë dhe të zhvillonte programin e duhur të trajnimit, ky ekip ndërmori një program intensiv të specializuar. U organizua një rekrutimi i jashtëm i ekspertëve për të plotësuar ekspertizën e brendshme. Ekipit të projektit FEG iu caktua përgjegjësia për kontrollet e lidhura me qeverisjen ekonomike dhe koordinimin brenda BE-së, zhvillimet që kanë të bëjnë me bashkimin monetar dhe bankar (duke përfshirë edhe zhvillimet në rregullimin bankar, të mbikëqyrjes dhe të zgjidhjes së instrumenteve), asistencë makro-financiare e dhënë për anëtaret e BE-së, së bashku me seriozitetin themelor të statistikave dhe informacionit në mbështetje të proceseve kyçe vendim-marrëse në të gjitha këto fusha.

Unë jam krenar që kam kontribuar në këtë zhvillim, në kuadër të ECA dhe jam dëshmitar për rritjen e kompetencave të këtij ekipi si dhe rritjen e njohurive në këto fusha të reja dhe shumë sfiduese të auditimit të performancës. Raportet e para të auditimit që kanë dalë gjatë vitit 2015 e kanë vendosur ECA në një pozicion që të adresojë rreziqet e nivelit të lartë si dhe të identifikojë shanset në qoftë se rreziqet mund të shmangen ose të paktën të kontrollohen. Unë jam i sigurt se e ardhmja dhe fitimi i njohurive të reja të ekipit FEG do të vazhdojë të sigurojë një kontribut të rëndësishëm të ECA-s ndaj llogaridhënies publike, qeverisjes së mirë dhe shqyrtimit demokratike në nivel të BE-së.

ECA me të drejtë duhet të mësojë dhe të vazhdojë reformat e saj për të siguruar se ajo i paraprin gjithmonë problemeve, duke përgatitur veten për të përmbushur kërkesat e zhvillimeve të ardhshme në BE, si dhe të ketë fleksibilitetin e nevojshëm në kuadër të përgjigjes në kohën e duhur. Ajo duhet të vazhdojë të theksojë rëndësinë e të qenit jo vetëm pjesë e një

procesi efektiv të vlerësimit por i një sistemi edhe më të rëndësishëm të paralajmërimit për politikë-bërësit dhe qytetarët.

(Botuar ne EUROSAI Journal, nr.04, Prill 2016)

Përktheu: Amantja Patozi

Specialiste, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Dr. Louis Galea, Anëtar i ECA-s

RAPORT NGA SEKRETARIA E PËRGJITHSHME MBI AKTIVITETIN EUROSAI 2015-2016

TAKIMI I 44-rt I BORDIT DREJTUES TË EUROSAI (Luksemburg, 13-14 Qershor 2016) Pika 3 e rendit të ditës

Aktiviteti EUROSAI i është dedikuar thellësisht plotësimit të rekomandimeve të marra në Kongresin IX (në veçanti, vlerësimit të pavarur të Organizatës), për implementimin e Planit Strategjik të EUROSAI-t (EUROSAI Strategic Plan, ESP) dhe përgatitja e planit të ardhshëm, si dhe përforcimi i bashkëpunimit me Grupet të tjera Rajonale të punës INTOSAI.

Hyrje

Ky raport aktiviteti i Bordit të Qeverisjes (Governing Board, GB) lidhet me performancën e organizatës përgjatë periudhës 2015-2016, që prej Takimit të 43-të (Helsinki, Finlandë, 10 Mars 2015).

Aktiviteti EUROSAI i është dedikuar thellësisht plotësimit të rekomandimeve të marra në Kongresin IX (në veçanti, vlerësimit të pavarur të Organizatës), për implementimin e Planit Strategjik të EUROSAI-t (EUROSAI Strategic Plan, ESP) dhe përgatitja e planit të ardhshëm, si dhe përforcimi i bashkëpunimit me Grupet të tjera Rajonale të punës INTOSAI (Rajonal Working Groups, RWG).

Imlementimi i planit strategjik të EUROSAI

Ekipet e punës 1, 2, 3, 4 të drejtuar respektivisht nga Institucionetë Supreme të Auditimit të Hungarisë, Gjermanisë, Republikës Çeke dhe Hollandës kanë vazhduar punën në implementimin e Planit Strategjik EUROSAI 2011-2017. Ato kanë detyra të rëndësishme gjatë implementimit të Planeve të tyre respektive Operacionale, në veçanti Ekipi 4, prej momentit që ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit Strategjik. Në të njëjtën kohë Ekipi 4 ka implementuar Fazën I të vlerësimit të pavarur, rezultatet e të cilës do të prezantohen në pikën 12 të rendit të ditës (programit), së bashku me propozimet për Fazën II. Ekipi 4 gjithashtu ka drejtuar zhvillimin e Planit Strategjik të

EUROSAI 2017-2023, propozimet e të cilit do të diskutohen nesër në pikën 15 sipas programit. Në lidhje me këtë, Ekipet regjistruan praktikat për të kontribuar në formatimin e ESP.

Në lidhje me Kërkesat e Planifikimit, Monitorimit dhe Raportimit (PMRR), Ekipet e punës, Grupet e punës dhe Task Force[1] duhet t'i raportojnë çdo vit Bordit Drejtues për progresin e bërë, që prej takimit të kaluar të tij. Raporti i Progresit të Ekipeve të punës dhe Raporti i Përgjithshëm i Progresit GT4 do të prezantohen në pikën 7 të programit, në vazhdim të të cilit do të diskutohen përfundimet më kryesore (pika 8).

Në vazhdim të rrugës së nisur nga Konferenca e parë YOUNG EUROSAI e mbajtur në Roterdam në Nëntor 2013, Konferenca e Dytë YOUNG EUROSAI (YES 2.0) u mbajt në Jeruzalem nga 9-12 Nëntor 2015. YES 2.0 i dha 74 audituesve të rinj (37 femrave dhe 40 meshkujve, me një moshë mesatare 30 vjeç, prej 40 SAI dhe organizatash) mundësinë e diskutimit dhe shkëmbimit të problemeve, ideve, eksperiencave, sfidave dhe zgjidhjeve për këtë temë. Mjete dhe mënyra të ndryshme (si workshop-e, seksioneve "Yes Talks" dhe folësit e çështjeve kyçe) u morën parasysh me qëllim që të bëhej kërkimi më i mirë në lidhje me temën qendrore të Konferencës. Siç u tha gjatë takimit të 43-të të Bordit Drejtues, u organizua një program paralel (Eventet Shoqëruese). Përfaqësues të SAI Holandez (Presidenca e EUROSAI), SAI i Spanjës (Sekretariati i EUROSAI) dhe SAI i Republikës Çeke, Estonisë dhe Finlandës udhëhoqën Eventet Shoqëruese. Kjo ishte një mundësi e veçantë për to për të pritur atmosferën speciale të YES 2.0.

Në fund të YES.2.0 SAI i Estonisë u bë vullnetar për pritjen e edicionit të tretë të konferencës YES në 2017. Organizimi e këtij edicioni dhe pritja nga SAI i Estonisë do t'i propozohet Bordit Drejtues gjatë takimit të 44-të, në përputhje me procedurat e Standardeve EUROSAI (artikulli 5.1 dhe 14.1 vendos që vendimmarrja për organizimin e seminareve, takimeve të ekspertëve dhe aktiviteteve të ngjashme të përkohshme duhet të merret nga Bordi Drejtues).

Së fundi, një propozim për ngritjen e një Task Force në Auditimin Komunitar nga SAI i Lituanisë do t'i prezantohet gjithashtu Bordit Drejtues, në pikën 11 të programit.

Veprimet për forcimin e kontrollit të jashtëm publik nëpërmjet SAI-ve të pavarur

Që prej Deklaratës së Limës, Pavarësia është një çështje e qëndrueshme parësore për SAI-t dhe organizatat e tjera. Gjatë 2015-2016, EUROSAI ka marrë pjesë në "Projektin Peer-Reviw" për çështjen e pavarësisë.

[1] *Komisioni aktual (në praktikat me të mira mbi auditimin e cilësisë) do të raportojnë për këtë çështje në një nga pikat e axhendës së GT1, meqenëse të dyja këto struktura drejtohen nga SAI i Hungarisë dhe Komisioni nuk ka aktivitete të parashikuara për këtë vit.*

Projekti Peer-Review u krijua nga Gjykata Austriake e Auditimit (ACA) në bashkëpunim të ngushtë me Agjensinë e Zhvillimit Austriake. Ky projekt ka për qëllim identifikimin e problemeve lidhur me 8 parimet e pavarësisë të caktuara në Deklaratën e Meksikës dhe në ndihmë të komunitetit INTOSAI për identifikimin e masave të tjera shtesë të nevojshme për përmirësimin e pavarësisë. Për zhvillimin e projektit, një SAI në secilin prej shtatë Grupeve Rajonal të Punës INTOSAI është marrë në shqyrtim (SAI i Shqipërisë, për EUROSAI). Gjithashtu, Peer-Review janë mbajtur në 7 rajone dhe raporte individuale janë duke u formuluar. Gjetjet e Peer-Review do të prezantohen në konferencën e XXII-të në Abu Dhabi. Një vlerësim i këtij projekti do të bëhet nga SAI i Sllovakisë, si drejtues i Komitetit të Lartë CBC për Peer Review-të, në fillim të 2017 kur pritet të fillojë.

Bashkëpunimi me INTOSAI, grupe të tjerë rajonal të punës INTOSAI dhe partnerë të jashtëm

EUROSAI është shumë i vendosur të bashkëpunojë me INTOSAI dhe Grupeve të tij Rajonale të Punës. Gjatë periudhës 2015-2016, Presidenca dhe Sekretariati i EUROSAI kanë mbajtur një lidhje të qëndrueshme dhe të mirë më Presidencën aktuale dhe të ardhshme, Bordin Drejtues, Sekretariatin e Përgjithshëm dhe pjesë të tjera të INTOSAI (mbi të gjitha Iniciativën e Zhvillimit të INTOSAI-IDI, Komitetin e Donatorëve të INTOSAI-t, dhe Komitetit të Krijimit të Kapaciteteve të INTOSAI-t) më shumë në lidhje me përgatitjen e Konferencës XXII INCOSAI në 2016.

Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAI-t mori pjesë në Takimin e 67-të të Bordit Drejtues të INTOSAI-t, mbajtur në Abu Dhabi në 10 – 11 Nëntor 2015, ku prezantoi progresin e bërë nga EUROSAI brenda strukturës së Drejtorisë së Komunikimit INTOSAI. Disa nga çështjet thelbësore diskutuar në këtë takim ishin, orientimi i strategjisë së ardhshme dhe drejtimi i INTOSAI-t, nevoja e ndryshimit të Statutit në përputhje me Planin e Strategjisë së re 2017-2022, rolin e ardhshëm të Bordit Drejtues të INTOSAI, të ardhmen e standardeve INTOSAI, procesit të çertifikimit dhe përgatitjes së INCOSAI të ardhshëm.

Gjatë vitit të kaluar, Sekretariati i EUROSAI është përfshirë shumë në procesin e INTOSAI për zhvillimin e Planit të ri Strategjik të INTOSAI 2017-2022, duke rishikuar Statutin dhe mbledhjen e përshtypjeve nga EUROSAI për dy temat e INCOSAI XXII.

Sekretariati i EUROSAI-t u bashkua me Task Force e Planit Strategjik të INTOSAI, i ngritur në fillim të vitit 2014, që kontribuon në mënyrë aktive në vlerësimin e fazave të ndryshme të zhvillimit të planit të ri (nëpërmjet telekonferencave apo në mënyrë shkresore). Drafti i Planit Strategjik të INTOSAI është publikuar së fundmi në faqen zyrtare të INTOSAI dhe i është dërguar të gjithë anëtarëve të INTOSAI për

komente në 31 Korrik, para aprovimit përfundimtar në INCOSAI XXII.

Sekretariati i është bashkuar gjithashtu dhe Task Force për Statutin, krijuar në Takimin e 67-të, të Bordit Drejtues INTOSAI. Qëllimi kryesor i Task Force është rishikimi i Statutit të INTOSAI, që ti përshtatet Planit të ri Strategjik ashtu si dhe pozicionimit të INTOSAI në kontekstin aktual botëror. Një përfaqësi e Sekretariatit ndoqi takimin e parë të Task Force të INTOSAI mbi Statutin të datës 21-22 Mars, 2016, në Nanjing, Kinë. Statuti u analizua dhe u diskutua, përshtypjet e EUROSAI mbi rregullat e origjinës, dhe një draft që përmbante amendime të ndryshme të Statutit u krijua dhe iu shpërnda anëtarëve të Task Force për komente dhe sugjerime. Një draft prezantues për statutin e ri do tu shpërndahet anëtarëve të INTOSAI në muajt në vijim.

Në lidhje me përgatitjen e temave të INCOSAI XXII, "Objektivat e zhvillimit të Qëndrueshëm" dhe "Profesionalizmi", Sekretariati mori pjesë në takimin e mbajtur në 9 Nëntor 2015 në lidhje me përgatitjet për INCOSAI 2016. Në përfundim të atij takimi, Sekretariati dhe Presidenca koordinuan procesin e mbledhjes së të dhënave rajonale nga EUROSAI, që prej kohës kur për këtë rast pritja e INCOSAI kishte organizuar këtë proces në një mënyrë ndryshe. Materialet rajonale të EUROSAI u koordinuan nga SAI i Finlandës dhe Portugalisë, në bashkëpunim me SAI-t e Estonisë, Finlandës, Suedisë, Turqisë, Gjermanisë, Holandës dhe Spanjës. Anëtarët e Bordit Drejtues do të diskutojë këto material në pikën 19 të programit.

Lidhur ngushtësisht me materialet Rajonale të EUROSAI-t, workshop-i mbi Profesionalizmin Rajonal u organizua nga Sekretariati i EUROSAI dhe Presidenca në takimin e kaluar GT1 në Budapest (Hungari), në 11 Prill 2016. Qëllimi i workshop-it ishte mbledhja e mendimeve në lidhje me dy kërkesat për Profesionalizmin Rajonal të marra nga INTOSAI, pyetjet CBC për strukturën e Profesionalizmit Rajonal dhe pyetjeve të Temës II për Profesionalizmit Rajonal (për INCOSAI XXII).

Ashtu si për Bashkëpunimin e Donatorëve të INTOSAI, Sekretaria është një anëtare e Komitetit të Bashkëpunimit të Donatorëve të INTOSAI, që përfaqëson interesat e anëtarëve të EUROSAI në Komitet. Një përfaqësi e Sekretariatit ndoqi punimin e 8-të, të Komitetit të Donatorëve të INTOSAI në Brazil, në 6-7 Tetor 2015. Mbi 50 përfaqësues nga INTOSAI dhe komunitetit ndërkombëtar të donatorëve konfirmuan drejtimin strategjik të bashkëpunimit të rrisi mbështetjen për shtim të kapaciteteve të SAI. Ata diskutuan gjetjet kryesore të raporteve të jashtme të vlerësimit dhe dolën në përfundimin që u sigurua një input i vlefshëm për zhvillimin e mëtejshëm të Bashkëpunimit, që përfshin çështje mbi përmirësimin e aktivitetit (PMF e SAI, Thirrjet Botërore për Propozime, dhe Databazën e Shtimit të Kapaciteteve të SAI) dhe të qenit më i orientuar nga

rezultatet. Ata gjithashtu ranë dakort mbi rrugën dhe hapat që duhen ndërmarrë për implementimin e këtyre përmirësimeve.

Sekretariati, Task Force mbi auditimin dhe Etikën (TFA&E) dhe Ekipet e Punës së EUROSAI kanë bashkëpunuar gjithashtu me Inisiativën e Zhvillimit të INTOSAI (IDI).

EUROSAI mori pjesë në workshopin mbi Planifikimin Strategjik, Matjen e Performancës dhe Monitorimin të IDI, të organizuar nga INTOSAI në Oslo (Norvegji) në 14-16 Shtator 2015, që u përfaqësua nga Presidenca dhe Sekretariati i EUROSAI. Objektivi kryesor i workshopit ishte prezantimi i Strukturës së Zhvillimit Strategjik për rajonet, një dokument i bazuar në strukturën e planifikimit Strategjik të SAI.

IDI ka mbështetur TFA&E në testimin dhe përdorimin e platformës online të IDI për e-learning dhe video konferencën, të cilat u përdorën për e-seminaret e TFA&E mbi Metodat dhe Mënyrat e Auditimit të Etikës, që prej firmosjes së një memorandumi në lidhje me to. IDI gjithashtu ka mbështetur Ekipin 1 në lidhje me shtimin e kapaciteteve dhe për platformën e mësipërme online, Ekipin 4 në lidhje me çështje të zhvillimit të fazës I të vetëvlerësimit.

Përfaqësues të Sekretariatit dhe Drejtimit të Ekipit 1 ndoqën punimet vjetore të Komitetit CBC të INTOSAI, në 8-10 Shtator 2015, në Stokholm (Suedi). 93 pjesëmarrës nga të gjitha INTOSAI Rajonale dhe organizatave partnere kyç (IDI, Banka Botërore) morën pjesë në takim. Çështjet Kryesore të Takimit Vjetor ishin:

- Seksioni i punës paralele në certifikimin e auditimit INTOSAI /IntoSAINT dhe Korporata e Audituesve/ Peer-Review;
- Forum Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve;
- Procesi i planifikimit strategjik të INTOSAI;
- Evoluimi i propozimeve të CBC;
- Profesionalizmi rajonal;
- Kapacitetet e SAI/ rëndësia në një agjendë të ardhshme mbi shtimin e kapaciteteve.

Gjatë Forumit Rajonal Mbi Shtimin e Kapaciteteve, përfaqësues të SAI-t të Hungarisë prezantuan databazën e informacionit mbi Shtimin e Kapaciteteve.

Përfaqësues të Sekretariatit dhe Drejtimit të Ekipit 1 ndoqën workshop-in për Kompetencat e INTOSAI-t për Audituesit, që u organizua në 17-19 Qershor 2015, në Oslo (Norvegji), nga Grupi Task Force i Certifikimit të audituesve të INTOSAI-t. Qëllimi i këtij workshop-i ishte konceptimi i një sistemi që do të informojë mbi përshkrimin e një baze kompetencash të cilat janë unike për rritjen profesionale të audituesve të sektorit publik që do të pilotohet Brenda INTOSAI për të testuar fizibilitetin e certifikimit INTOSAI.

Në lidhje me bashkëpunimin me Grupe Rajonal të Punës INTOSAI, që prej takimit të 43-të, të Bordit Drejtues ndodhën aktivitetet e mëposhtme:

- Konferenca e Tetë e përbashkët OLACEFS-EUROSAI e mbajtur në Quito (Ekuador) në 24-26 Qershor 2015. Çështjet e diskutuara ishin "Auditimi i koordinuar" dhe "Kontributi i SAI në Mirëqeverisje", ku morën pjesë më shumë se 100 përfaqësues nga Evropa, Amerika Latine, Karaibet dhe partnerët e tij të jashtëm. Dy temat qendrore të Konferencës u zhvilluan gjatë seksioneve të ndryshme paralele të punimeve të cilat dhanë një dinamikë dhe format inovativ të eventit. Ato u paraprinë çdo ditë, nga ndërhyrjet e specialistëve të fushave si edukimi dhe e-learning, shtimi i kapaciteteve ose qeverisja e hapur dhe kontrolli, që i aftësuan pjesëmarrësit për diskutimin që pasonte secilën çështje. Përfundimet dhe leksionet u prezantuan nga secili grup në një Seksion Plenar, pas seksioneve të punës.

- Konferenca e Pestë e përbashkët ARABOSAI-EUROSAI e mbajtur në Doha (Katar), në 7-9 Dhjetor 2015. Tema kryesore e konferencës ishte "Roli i SAI në këndvështrimin e planeve shpëtuese të qeverisë", që u zhvillua nëpërmjet dy nën temave: "Roli i SAI në monitorimin e implementimit të planeve shpëtuese" dhe "Perceptime të ardhshme të rolit të SAI në parandalimin e riskut të krizave financiare", që mblodhi 35 delegacione nga SAI të dy Grupeve Rajonale të Punës së INTOSAI. Sekretariati i EUROSAI-t realizoi një anketim për të vlerësuar sesi ishin përmbushur pritshmëritë e pjesëmarrësve në këtë konferencë. Perceptimi i përgjithshëm është pozitiv, megjithëse ka vend për përmirësim në drejtimi të të bërit më produktiv të konferencave të këtij lloji.

Sekretariati beson se pas më shumë se 15 vitesh bashkëpunimi me organizata të tjera Rajonale pjesë të INTOSAI, është koha të vlerësohet ky bashkëpunim dhe të riformohet ai në mënyrën më efiçente, duke dhënë input-e të reja, me qëllim që të bëhet më dinamik dhe i frytshëm.Për këtë, Sekretariati hodhi një propozim të bazuar në rezultatet e anketimit.

Konferenca e vetme e Përbashkët e planifikuar për momentin është Konferenca e tretë ASOSAI-EUROSAI, që do të mbahet nga SAI i Ukrainës në Kiev (Ukrainë) në 2017, siç u ra dakord nga Bordi Drejtues i EUROSAI (në 7 Shtator 2015). Bordi Drejtues i ASOSAI ra dakord të hapë këto evente të përbashkëta për të gjithë anëtarët, ashtu si Bordi Drejtues i EUROSAI aprovoi në takimin e 43-të, të tij. Dhoma e Llogarive të Ukrainës propozoi një temë për këtë konferencë të përbashkët "Kontributi i SAI në sfidat e kohës" dhe nën-temat:

1. Shkatërrimet humanitare, natyrore dhe njerëzore, Kapacitetet për t'u paraprirë dhe përgjigjur;

2. Parandalimi i korrupsionit si hapje e mundësive për investimet.

Bordi Drejtues do të diskutojë vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi në

pikën 16 të programit, ashtu si dhe temën dhe datën e Konferencës së Tretë të Përbashkët EUROSAI-ASOSAI.

Bashkëpunimi me partnerë të jashtëm është mbuluar nga Konfederata Evropiane e Instituteve të Auditimit të Brendshëm (ECIIA), që vendos në praktikë Marrëveshjen e Bashkëpunimit të rinovuar në Kongresin e IX. Si pjesë e kësaj marrëveshjeje një numër iniciativash të planifikuara janë përmbushur përgjatë 2015 dhe 2016. Njëra nga to, e udhëhequr nga anëtarët e ECIIA, ishte eksplorimi i ekzistencës dhe funksionimit të Komitetit të Auditimit të sektorit publik brenda juridiksionit Evropian. Një tjetër, e drejtuar nga anëtarët e EUROSAI është mbledhja dhe shpërndarja e informacionit për marrëveshjet e bashkëpunimeve kombëtare midis SAI dhe Audituesve të Brendshëm në sektorin publik. Dokumentet lidhur me secilën nga iniciativat u shpërndanë dhe diskutuan në takimin e Komitetit të bashkëpunimit EUROSAI-ECCIIA mbajtur në Madrid, në prill 2016. Në atë takim u diskutuan gjithashtu termat e referencës për bashkë organizimin e konferencës së Përbashkët EUROSAI-ECCIIA, që do mbahet në Bruksel në 2017. Diskutimet për të, do të bëhen në pikën 20 të programit.

Anëtarët e rinj dhe heqja e anëtarësisë në EUROSAI

Që prej takimit të kaluar të Bordit Drejtues, nuk është shtuar ose larguar asnjë anëtar në EUROSAI. Numri i anëtarëve vazhdon të jetë 50.

Përvjetori i 25-të i EUROSAI

Në 2015 ne festuam përvjetorin e 25-të, të krijimit të EUROSAI (2 Nëntor 1990) në mënyra të ndryshme, siç u miratua gjatë takimit të kaluar të Bordit Drejtues. Iniciativat ishin këto: Logoja e Përvjetorit të 25-të të EUROSAI e dizenjuar nga Sekretariati i EUROSAI, e shfaqur në faqen zyrtare dhe përdorur përgjatë vitit në të gjitha komunikimet zyrtare të Sekretariatit. Festimi në Konferencën e VIII-të OLACEFS-EUROSAI, në Quito (Ekuador) në 24-26 Qershor 2015, që përfshiu një ekspozitë fotografike të momenteve më të rëndësishme në historinë e EUROSAI dhe një seksion të veçantë në Revistën EUROSAI (nr. 21) dedikuar përvjetorit të 25-të të EUROSAI. Ky seksion konsistoi në pamjet që nga fillimi (nga formimi deri në Presidencën aktuale të EUROSAI dhe palëve të tjera kryesore të interesuara të EUROSAI, kohëzgjatjen EUROSAI (1990-2015), një fotografi të EUROSAI (ku produktet kryesore, rezultate dhe të dhëna të tjera të rëndësishme ishin nënvizuar), një intervistë dhe artikuj nga kolegë më një marrëdhënie të gjatë dhe të fortë më EUROSAI.

Aktiviteti i sekretariatit të EUROSAI-t

Në përputhje me funksionet e Sekretariatit në nenin 14 të Statutit dhe nenin 9 të Procedurave Standarde të EUROSAI, Sekretariati ka përmbushur

detyrat e tij në drejtim të implementimit të vendimeve të marra në Kongresin e IX si dhe në Bordin Drejtues.

Në shtesë të kësaj, Sekretariati i EUROSAI ka mbështetur Ekipet e Punës në ekzekutimin e Planeve të tyre Operacionale dhe ka vepruar si një motor i përhershëm informacioni dhe komunikimi me dhe midis anëtarëve të EUROSAI, me INTOSAI, si dhe me jashtë. Ai i ka siguruar anëtarëve të EUROSAI takime për diskutimin e çështjeve te ndryshme.

Për më tepër, Sekretariati ka implementuar Buxhetimin e EUROSAI dhe i ka siguruar Organizatës mbështetjen e duhur administrative. Detaje të mëtejshme jepen në seksionin e këtij raporti që lidhet me çështjet financiare.

Si në Revistën EUROSAI, Sekretariati ka trajtuar dhe publikuar në faqen zyrtare çështjen 21 të këtij publikimi, me temën qendrore "Kontributi i EUROSAI për Mirëqeverisjen dhe auditimin e besueshëm për sektorin publik nga SAI modern". Sekretariati dizenjoi këtë çështje në një mënyrë më të dukshme dhe tërheqëse (duke përfshirë midis përmirësimeve të tjera dhe infografikën), përfshiu për herë të parë një intervistë dhe bëri ndryshime të tjera që ndoqën sugjerimet e marra gjatë anketimit e Revistës nga GT4. Gjatë informimit të anëtarëve në lidhje me lançimin e revistës, anëtarët morën një guidë të shkurtër me disa mënyra të të bërit të Pdf dhe Viewer, dy formatet e vlefshme për të parë revistën në faqen zyrtare. Përmirësimet e bëra nga trajtimi i fundit në revistë dhe në seksionin qendror të përvjetorit të 25-të të EUROSAI morën një vlerësim të mira nga anëtarët. Sekretariati dëshiron të falënderojë ato SAI-e që bashkëpunuan me kontributin e tyre në çështjen e fundit, duke mundësuar këtë publikim.

Një nga projektet kryesore të GT4 është përmirësimi dhe promovimi i revistës. Për këtë, një anketim për revistën u bë për të parë nivelin e realizimit të pritshmërisë së anëtarëve të EUROSAI-t me të dhe për mbledhjen e sugjerimeve për ta përmirësuar atë. Rezultatet finale dhe propozimet për përmirësim do ti prezantohen në GT4 anëtarëve të Bordit Drejtues për miratim, sipas pikës 7 të programit.

Sekretariati i EUROSAI ka përgjegjësinë e shkrimit të revistës. Megjithëse pjesëmarrja aktive e anëtarëve të tjerë të SAI-t konsiderohet një praktikë e mirë dhe është përdorur si model bashkëpunimi nga grupe të tjerë rajonal të INTOSAI (p.sh. ASOSAI, OLACEFS) dhe nga vetë INTOSAI. Pjesëmarrja e anëtarëve të tjerë mund të arrihet nëpërmjet krijimit të një Bordi Editorial, roli i të cilit mund të jetë:

a) Zgjedhja e temës për artikujt monografik ose botimet e Revistës

b) Përcaktimi i kritereve për artikujt që do të përfshihen në Revistë

c) Vlerësimi dhe përzgjedhja e artikujve (përmbajtja, cilësia, rëndësia)

d) Vlerësimi i përgjithshëm i revistës përpara publikimit

e) Rishikimi i versioneve të ndryshme të gjuhëve të Revistës

f) Aktivitetet mbështetëse në lidhje me formatin e revistës, paraqitjen vizuale ose promovimin e saj.

Përgjatë 2015 Sekretariati bëri një analizë të bordeve botuese të revistave të ngjashme dhe u konsultua në lidhje me këtë çështje me INTOSAI RËG të tjerë. Bazuar në këtë analizë, një Bord Editorial do të krijohet për Revistën, të drejtuar nga Sekretariati[2]. Sipas opinionit të Sekretariatit, Bordi do të përforcojë më tepër rolin e revistës si një nga komunikimet kryesore brenda organizatës. Anëtarë të Bordit Editorial duhet të zgjidhen duke marrë parasysh ato SAI me njohuri të mira specifike në fushën e komunikimit, departamentin e dizenjimit grafik dhe të tjera aftësi me rëndësi për Revistën EUROSAI. Nëse Bordi Drejtues do ta mbështesë ngritjen e një Bordi të tillë, duhet të bëhet një studim më i detajuar, në mënyrë që të krijohet një propozim konkret në të cilin funksionet, rolet dhe përbërja e Bordit Editorial të përcaktohen qartësisht. Në çdo rast dhe kur Plani Strategjik i ri 2017-2023 do të përfshijë disa ndryshime në strukturën organizative, mund të jetë e këshillueshme të lidhet diskutimi i krijimit të një Bordi Editorial me diskutimin e strukturës së EUROSAI.

Lidhur me faqen zyrtare të EUROSAI, një mënyrë tjetër e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, kemi kënaqësinë të informojmë se ajo po bëhet gjithnjë e më shumë i njohur nga anëtarët dhe jashtë tij. Ajo është vizituar në rritje që prej lançimit zyrtar në Tetor 2013. Numri i vizitorëve mesatarë ditorë është rritur nga 734, në Janar 2014 në 1,916 në Janar 2015, në 2,367 në Janar të këtij viti. Prilli 2016 ishte gjithashtu një muaj shumë i vizituar nga 2,828 vizitorë.

Vizitat në bazën e të dhënave të produkteve dhe raporteve të auditimit të GT3, të lançuara zyrtarisht përgjatë Takimit të kaluar të Bordit Drejtues në Mars 2015, janë rritur çdo muaj. Të dhënat aktuale të Bazës së të Dhënave të Raporteve të Auditimit janë këto: 26 anëtarët EUROSAI të regjistruar si përdorues - kontribuues (19 kanë kontribuar tashmë) dhe informacioni për 695 raporteve të auditimit të vlefshme. Ashtu si për vizitorët dhe vizitat në bazën e të dhënave mund të shihet se si ka evoluar (Spanja – Sekretariati- dhe Republika Çeke –Drejtuesi i GT3 janë përjashtuar, meqë ata e vizitojnë shumë shpesh).

[2] *Kjo Ide e një komiteti editorial u sugjerua gjithashtu nga një nga anketim për revistën bërë në GT4*

Baza e të dhënave të produkteve përbëhet nga 200 produkte të vlefshme (ose informacion i rëndësishëm sesi të merren ato). Më poshtë mund të shihni të dhënat mujore mbi vizitat dhe vizitorët (Spanja dhe Republika Çeke janë përjashtuar) që prej takimit të kaluar të GB-së.

Sekretariati ka punuar ngushtë me Drejtuesit e Ekipit të Punës nr. 3 për përmirësimin e databazës, në ndërtimin e eksperiencës që rrjedh nga ky përdorim, konsultimeve dhe përshtypjeve nga anëtarët. Gjithashtu, implementimi i disa ndryshimeve në shabllonet elektronike, që nuk mund të bëhen nga stafi IT i Gjykatës Spanjolle të Auditimit, është kontraktuar së fundmi, pas miratimit të procedurës nga Bordi Drejtues.



Çështjet financiare të EUROSAI-t

Periudha e re buxhetore e Organizatës e vitit 2015 nisi me implementimin nga Sekretariati i Buxhetit të vitit të parë të 2015-2017 të EUROSAI.

Sekretariati ka nxjerrë Raportin Financiar të vitit 2015, në përputhje me Rregullat Financiare të EUROSAI, që do të prezantohet sipas pikës 5 të programit, së bashku me raportin e audituesve (që prej 2014, SAI i Kroacisë dhe Izraelit), puna audituese e të cilëve nisi në 11-12 Prill 2016.

Gjendja përfundimtare financiare e vitit 2015 tregon një rezultat pozitiv prej 58,388.83 euro. Kjo vlerë është më e lartë se viti i kaluar, për shkak të kursimeve në publikimin e Revistës si dhe shpenzimeve të përkthimit jo të sakta të vitit 2014, lidhur me organizimin e Kongresit të IX. Si çdo vit, Sekretariati ka siguruar Organizatën me mbështetjen e duhur administrative. Kontributi i Gjykatës Spanjolle të Auditimit gjatë vitit 2015 u vlerësua rreth 233,000 euro, sipas raportit financiar të EUROSAI.

Sipas rregullit nr. 40 të Rregullave Financiare të EUROSAI, buxheti i EUROSAI mund të mbulojë shpenzime të organizimit të eventeve (si pajisje teknike, dhoma konference ose përkthime), ndërkohë që shpenzimet e pritjes (si vaktet dhe programet sociale) nuk mbulohen prej tij. Ky Bord Drejtues ra dakord për të financuar 3 evente të organizuara në vitin 2015. Miratimi u bë në mënyrë shkresore duke përmendur

faktin që takimi i 43-të i Bordit Drejtues të EUROSAI u mbajt në fillim të Marsit, para paraqitjes së kërkesës për financim (31 Mars). SAI i Turqisë, Maltës dhe ECA ishin financuar përkatësisht me 6,000, 5,500, dhe 2,640 euro. Faturat për përdorimin e këtyre fondeve u paraqitën në EUROSAI nga SAI përkatës të përfshirë. SAI përfituese justifikuan fondet e marra dhe SAI i Maltës dhe Turqisë rimbursoi 2,856.29 dhe 4,333.45 euro, respektivisht, pas rishikimit të faturave nga Sekretariati (shpenzimet si pagat për punën jashtë orarit për stafin dhe komisionet nuk u morën parasysh nga Sekretariati).

SAI i Lituanisë (3,500 euro), Ukraina (6,000 euro), Republika Çeke (6,121 euro), Portugalia (450 euro) dhe ECA (15,000 euro) kërkuan mbulim financiar nga buxheti i vitit 2016, kapitulli 2 (alokime nga GT1, GT3 dhe GT4). Kërkesat financiare do të paraqiten më të detajuara në pikën 6 të programit, gjatë diskutimit dhe miratimit të mundshëm nga Bordi Drejtues, duke marrë parasysh raportin e trajtuar nga GT-të dhe Sekretariati.

Sfidat e ardhshme

Gjatë vitit të ardhshëm, EUROSAI do të përballet me sfida të ndryshme si përgatitja e draftit të Planit të ri Strategjik 2017-2023 dhe finalizimi i një vlerësimi të pavarur. Në duam të adresojmë dhe pritshmëritë e anëtarëve tanë, lidhur me rezultatet e vetëvlerësimit, që janë shumë të fokusuara në rritjen e njohurive në ngritjen e kapaciteteve, mbi të gjitha, në nivelin praktik të auditimit dhe përmirësimin e komunikimit; për vendosjen e rolit të anëtarëve të EUROSAI dhe EUROSAI lidhur me Arritjet në Zhvillimin e Qëndrueshëm; të merren me impaktin që do ketë në EUROSAI dhe INTOSAI Plani Strategjik i ri dhe Statuti i rinovuar; dhe riformatimi i bashkëpunimit midis EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, etj.

Megjithëse të orientuar nga e ardhmja nuk duhet të zvogëlojmë përpjekjet për disa rezultate të planit strategjik aktual të paarritura deri tani, siç është platforma bashkëpunuese për video konferencat, e-learning dhe funksione të tjera praktike. Implementimi i një platforme të tillë duhet të jetë një prioritet kyç, nëse duam që EUROSAI të operojë në mënyrë efiçente, siç kërkohet nga anëtarët e saj.

Pas 25 vitesh pune së bashku dhe shkëmbimesh zgjidhjeje për sfidat e përbashkëta, ne kemi bërë një progres të rëndësishëm duke forcuar rolin e SAI-ve Evropiane dhe kjo është arritur kryesisht nëpërmjet kontributit të anëtarëve tanë. Siç u evidentua nga vëzhgimi i jashtëm, kur ne shohim në Organizatat e ngjashme mund të themi se nuk jemi mbrapa në praktikën tonë aktuale dhe qeverisëse, përkundrazi po e bëjmë këtë shumë mirë. Çfarë kemi arritur dhe mësuar gjatë këtyre viteve, është një aset me vlerë që duhet pasur parasysh, tani që jemi në momentin e vendosjes se kush do të drejtojë Organizatën tonë në të ardhmen. Ne duhet të vlerësojmë eksperiencën dhe të

dimë se eksperienca e mbledhur përgjatë gjithë këtyre 25 viteve, përbën themele të forta, mbi to mund të vazhdojmë të ndërtojmë komunitetin tonë të SAI-ve në Evropë.

Përktheu: Irma Idrizaj

Audituese, Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm

INFO KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
AKTIVITETE TË KLSH-së
PËR PERIUDHËN JANAR – PRILL 2016

Kryetari i KLSH, z.Bujar Leskaj, takon z. Dennis Wesner, Zyrtar i Përgjithshëm për Zhvillimin pranë USAID

Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj zhvilloi një takim në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit me z. Dennis Wesner, Zyrtar i Përgjithshëm për Zhvillimin, pranë USAID.

Zoti Wesner theksoi rëndësinë e KLSH si institucion kushtetues. Ai u shpreh se SHBA janë të interesuara për të luftuar korrupsionin ne Shqipëri. "Mbështetja jonë për KLSH nuk do të mungojë", tha Wesner, duke nënvizuar rëndësinë që ka bashkëpunimi i KLSH me institucione të tjera si Avokati i Popullit, ILDKP, etj.

Nga ana e tij, Kryetari i KLSH-së vlerësoi projektet e realizuara nga USAID-i në Shqipëri dhe shprehu dëshirën dhe vullnetin për të bashkëpunuar me USAID-in në projekte që do të propozohen nga kjo agjenci. Duke bërë një panoramë të punës së institucionit në katër vitet e fundit, ai veçoi rekomandimet e dhëna nga KLSH për përmirësimin e qeverisjes, si propozimi për vendosjen e një tavani për borxhin publik, për pagesën e borxheve të prapambetura bizneseve, rekomandimet për sektorin e energjisë dhe të hidrokarbureve, propozimin për miratimin e një ligji për përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë, me qëllim që të luftohet efektivisht anti-kultura e pandëshkueshmërisë në Shqipëri, etj. Kryetari i KLSH-së cilësoi se të gjitha rekomandimet e dhëna nga KLSH kanë qenë në linjë me rekomandimet e FMN-së.

KLSH është në fazën e transformimit dhe modernizimit, duke pasur si model SAI-et më të zhvilluara evropiane. Në këtë drejtim, institucioni ka synuar transparencën e plotë, duke vendosur një

raport të ri me shoqërinë civile (janë nënshkruar në këto vite më shumë se 20 marrëveshje bashkëpunimi), duke u hapur dhe qenë pro-aktiv ndaj medias dhe publikut, me botimin e 51 librave, me zhvillimin e analizës së punës së institucionit nën frymën e INTOSaint (vetëvlerësimi i integritetit) dhe në praninë e medias, etj.

Kryetari i KLSH përmendi që në kuadër të bashkëpunimit me OJF-të, u përfundua projekti "Forcimi i Ligjit përmes zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së » që Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë (QTIL) realizoi me financim të USAID-it, nëpërmjet programit «Assist-Impact »". Në raportin final të projektit janë trajtuar çështje të rëndësishme që lidhen me zbatimin e rekomandimeve te dhëna nga KLSH, referuar auditimeve te vitit 2014. "Ne si institucion",-vijoi z. Leskaj- "vlerësojmë rekomandimet e QTIL dhe jemi duke hartuar një plan veprimi të detajuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga kjo OJF".

Kryetari i KLSH-së më tej u ndal në bashkëpunimin e rritur ndjeshëm me SAI-et e rajonit dhe me ato evropiano-perëndimore, si dhe me institucionet e BE-së. Një shembull në këtë drejtim është projekti IPA 2013(me vlerë 2.1 milion euro), komponenti i I-rë, që KLSH ka fituar që në vitin 2014 dhe që lidhet me forcimin e kapaciteteve të auditimit të jashtëm publik.

Zoti Wesner shprehu gatishmërinë për të mbështetur KLSH në Auditimet e Performancës dhe Kryetari i KLSH-së i bëri një përmbledhje të auditimeve të Performancës të realizuara deri tani nga KLSH, duke theksuar se institucioni është i hapur dhe çdo propozim i USAID-t është i mirëpritur.

Të dyja palët ranë dakort që bashkëpunimi të jetë konkret dhe në fusha me interes reciprok. Kontrolli i Lartë i Shtetit do t'i propozojë USAID-it projekte konkrete dhe të qarta me kohëzgjatje 1-2 vjeçare.

Bashkëpunimi mes KLSH dhe USAID-it do të jetë i drejtpërdrejtë ose nëpërmjet OJF-ve, projekte në të cilat KLSH do të mbështesë organizata të shoqërisë civile që kanë fituar projekte nga USAID, në fusha që lidhen me aktivitetin e KLSH-së.

Gjithashtu, zoti Leskaj e ftoi z.Wesner që të auditojnë KLSH nëpërmjet projekteve që financojnë, duke theksuar që institucioni është e hapur dhe mund të auditohet në fusha që janë me interes për USAID-in dhe publikun e gjerë.

Në takim morën pjesë gjithashtu zj. Elina Koçi (USAID), z. Ermal Yzeiraj, Drejtor Departamenti dhe zj.Irena Islami, Drejtore Drejtorie (KLSH).

KLSH zhvillon analizën vjetore të punës për vitin 2015

Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilloi në sallën "UNESCO" të Muzeut Historik Kombëtar, Analizën Vjetore të punës së Institucionit për vitin 2015.

Analiza e punës së institucionit vjen pas analizave të departamenteve të auditimit që u zhvilluan në fund të vitit 2015 në Universitetet Publike në rrethe të ndryshme të vendit si në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", në Elbasan, në Universitetin "Ismail Qemali" në Vlorë, në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe në Universitetin e Tiranës. Analizën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Bujar Nishani, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Z.Donald Lu, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë, z.Erion Braçe, Prokurori i Përgjithshëm, z.Adriatik Llalla, Avokati i Popullit, z.Igli Totozani, Ministri i Drejtësisë,z.Ylli Manjani; Inspektor i Përgjithshëm i ILDKPKI, z.Shkëlqim Ganaj,Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Gent Sejko, Kryetari i Autoritetit të Konkurencës, znj.Lindita Lati, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, etj.Analiza u zhvillua me pjesëmarrjen e shumë përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe organizatave profesionale të fushës, partnerë të KLSH-së, si Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof.Dr.Sherif Bundo, Prof.Dr.Hysen Çela, Prof. Dr. Sazan Guri, Prof.Dr.Lavdosh Zahaj, Prof.Dr.Vjollca Karapici, Prof.Dr.Ago Nezha, përfaqësues të botës akademike, si Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës Akademik Jorgaq Kaçani, pedagogë të Fakultetit Ekonomik, gaetarë, etj.Në analizën Vjetore të KLSH-së mori pjesë një delegacion me 10 auditues i ZAP-it të Kosovës, i kryesuar nga Zv/Audituesi i Përgjithshëm z.Artan Venhari.

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj, i cili bëri një pasqyrë të shkurtër të punës së institucionit për vitin 2015. Zoti Leskaj theksoi që KLSH si institucion suprem i auditimit publik ka detyrimin ndaj qytetarit dhe Kuvendit dhe jo ndaj partive politike që me misionin, forcën dhe moralin që i ka dhënë Kushtetuta, të kthejë besimin publik ndaj qeverisjes.

Në fjalën përshëndetëse që Kreu i Shtetit Shqiptar, SH.T.Z Bujar Nishani, u drejtoi të pranishmëve, vlerësoi punën dhe kontributin e audituesve dhe drejtuesve të tyre për gjithë investimin profesional, qytetar dhe institucional, duke rikonfirmuar rëndësinë e madhe që ka KLSH-ja dhe duke vënë në pah "bindjen e thellë për pritshmëritë shumë të larta që kanë në tërësi, shoqëria dhe aktorët e shoqërisë, për institucionin, produktin dhe për angazhimin e punës suaj".

Nuk nguroj të them-nënvizoi Presidenti "… që keni arritur një standard më të arrirë, më të përparuar, dhe ndoshta jeni ndër institucionet më të para që keni ngritur në një shkallë më të lartë çështjen e asaj që përbën sfidën më të madhe të shoqërisë

sonë, besimin…Drejtuesit e Institucioneve të pavarura përshëndetën Analizën e punës së KLSH-së për vitin 2015.

Analiza e punës së institucionit vijoi me Raportin e performancës institucionale për vitin 2015, "Treguesit Kryesorë të Raportimit referuar fushave të performancës së KLSH-së bazuar në instrumentin e vetëvlerësimit "Matja e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit" dhe në praktikat më të mira të komunitetit të INTOSAI-t", mbajtur (për rreth 1 orë e 30 minuta) nga Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj. Më pas grupe audituesish referuan lidhur me auditimet me impaktet më të rëndësishme dhe me efekte të konsiderueshme në menaxhimin e financave publike dhe zhvillimin ekonomik të vendit si Auditimet në Sektorin Energjitik, në Menaxhimin e Financave Publike, ne Sistemin e Shëndetësisë ne sistemet informatike, etj. Gjithashtu pjesëmarrësit u njohën me arritjet e KLSH-së në auditimet e Performancës, forcimin e kapaciteteve Institucionale nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm të stafit, me transparencën e aktivitetit të KLSH-së: si një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe të komunikimit të tij shumë dimensional, etj.

Punimet e ditës së pare të Analizës Vjetore të KLSH-së u mbyllën me promovimin e disa librave:

•Promovimi i librit të Prof.Dr.Skënder Osmanit: "Elemente të Fazistikës, pjesa e IV" dhe Hyrje në Inxhinierinë Financiare dhe Stokastike", me autore Prof.Dr. Skënder Osmani dhe Dr.Bujar Leskaj.

•Promovimi i librit "Ylli i shkrimtarit" monografi nga Ndriçim Kulla dedikuar shkrimtarit të madh Ismail Kadare.

•Promovimi i Librave të z. Bedri Çoku me titull: "Plaku i Kënetës" "Dashuri e fundosur" dhe "Arrestova shokun Tim".

Dita e dytë e analizës u zhvillua në një nga sallat e Universiteti Politeknik të Tiranës dhe u është dedikuar audituesve të rinj, të cilët nën moton e konferencës së I-rë dhe të II-të, të Young EUROSAI me temë qendrore "SAI&Unë" zhvilluan konferencën: Kontributi, Inovacioni nën moton: "Unë, KLSH dhe EUROSAI ".

Konferencën e moderoi z.Ermal Yzeiraj, Drejtor i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, i cili në fjalën e tij të hapjes theksoi që ndarja në të rinj dhe në të vjetër nuk është se ka ndonjë rëndësi në KLSH, pasi ndarja e vërtetë që ekziston është ajo ndërmjet audituesve shumë të mirë, të mirë dhe atyre që nuk plotësojnë dot kriteret për të qenë pjesë e këtij institucioni. Të jesh i ri nuk është aspak një disfavor për të bërë karrierë në KLSH por përkundrazi përbën

një avantazh. Shpejtësia me të cilën brezi i ri arrin të përthithë dhe vërë në praktikë eksperiencën e brezave të mëparshëm në KLSH është mbresëlënëse. Energjia që të rinjtë mbartin gjithashtu është impulsi që i nevojitet ritmit të institucionit.

Gjatë konferencës referuan 23 auditues të rinj, të cilët kishin përzgjedhur tema me fokus drejt se ardhmes. Tema e trajtuara kishin te bënin me matjen e performances se SAI-t, bashkëveprimin KLSH-Media, një mjet për rritjen e pergjegjshmerise se qeverise dhe besueshmërisë se institucionit tek publiku, SAI në një shoqëri multikulturore, ndikimi i teknologjisë në profilin professional të një audituesi, lidhja midis ISSAI-ve dhe IPSAS-eve, etj.

Në Konferencën "Unë, KLSH dhe EUROSAI" Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, vlerësoi punimet dhe i nxiti të rinjtë që të punojnë më shumë në drejtim të rritjes së tyre profesionale.

Në përfundim të dy ditëve të Analizës së vitit 2015, KLSH u fokusua tek sfidat e institucionit për vitin 2016, gjatë të cilës KLSH do të kryejë auditime financiare (certifikime të pasqyrave financiare), do të konsolidojë auditimet e përputhshmërisë, duke aplikuar kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit në përputhje me manualin e ri të Auditimit të Përputhshmërisë, do të shtojë numrin dhe cilësinë e auditimeve të performances, etj.

Thellimi i luftës kundër korrupsionit do të jetë në fokus të veprimtarisë institucionale të KLSH-së dhe krahas veprimtarisë audituese dhe modernizimit të tij, do të vazhdojmë të thellojmë luftën kundër korrupsionit, duke denoncuar aktet korruptive në publik, media, prokurori e më gjerë.

KLSH fillon procesin e rishikimit mes kolegëve (peer review) lidhur me pavarësine e SAI-t

Kontrolli i Lartë i Shtetit është përzgjedhur nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) si përfaqësues i Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) Europiane për të realizuar një Peer Review (proces rishikimi mes kolegësh) lidhur me pavarësinë e SAI-ve.

Nën shembullin e SAI-ve të zhvilluara evropiane dhe në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, të parimeve të transparencës së plotë dhe integritetit, mbështetur në standardin ISSAI 5600 "Udhëzim për Rishikimin mes Kolegëve", KLSH iu përgjigj pozitivisht vitin e kaluar kërkesës së INTOSAI-t, drejtuar të gjithë Institucioneve Supreme të Auditimit, anëtarë të kësaj organizate, nëpërmjet së cilës i ftonte që të ishin pjesë e Peer Review. Kontrolli i Lartë i Shtetit u vetë ofrua për të qenë pjesë e këtij procesi, duke vlerësuar si parësore pavarësinë e SAI-ve për realizimin e misionit të tyre, duke ofruar njëkohësisht audituesit e tij më të përgatitur për të realizuar me sukses këtë projekt.

Në këtë kuadër, në datat 8 -19 shkurt 2016 nga auditues të Gjykatës Austriake

të Auditimit nisi procesi i Peer Review nga një staf prej 4 audituesish, tre prej tyre janë auditues të Gjykatës Austriake të Auditimit: z.Bernhard Beybel, zv/Drejtor Departamenti, zj.Eva Prenner dhe zj. Irmtraud Weinke, audituese si edhe dhe nje përfaqësuese e SAI-t të Moldavisë, zj.Verica Verdes, Drejtore Departamenti.

Në datën 8 shkurt, grupi u prit në një takim nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, i cili bëri një ekspoze të përgjithshme mbi veprimtarinë e institucionit dhe u ndal veçanërisht në tetë parimet e pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit, të përcaktuara në Deklaratën e Meksikos.

Kryetari i KLSH-së vleresoi shumë këtë proces dhe theksoi faktin që KLSH do t'i vërë në dispozicion grupit të audituesve të gjithë stafin dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin me sukses të këtij procesi.

Stafi që do të realizojë "Peer Review" do të kontaktojë gjithashtu edhe me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që bashkëpunojnë me KLSH-në si edhe me përfaqësues të shoqatave të profesionistëve të fushës së auditimit dhe të ekonomisë.

Duke Vlerësuar rëndësinë parësore që ka bashkëpunimi mes Kuvendit dhe KLSH-së, audituesit do të realizojnë takime edhe me përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, veçanërisht me përfaqësues të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Raporti përfundimtar i këtij projekti do t'i vihet në dispozicion medias dhe të gjithë palëve të interesuara.

Në këtë takim morën pjesë edhe zj.Irena Islami, Drejtore Drejtorie dhe z.Fatos Çoçoli, ekspert i jashtëm.

Kryetari i KLSH-së takohet me Z. Gjon Junçaj, Këshilltar Ligjor Rezident i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara

Në datë 9 shkurt 2016, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetari i KLSH-së, Z. Bujar Leskaj, zhvilloi një takim pune me Z. Gjon Junçaj, Këshilltar Ligjor Rezident i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe ekspert i misionit të OPDAT në Shqipëri.

Në këtë takim Z. Junçaj vlerësoi rolin dhe kontributin e deritanishëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit në luftën kundër korrupsionit duke shprehur dëshirën e forcimit të mëtejshëm të këtij roli dhe kontributi të KLSH-së jo vetëm në bashkëpunimin me organin e Prokurorisë dhe institucionet e tjera ligjzbatuese por edhe me strukturat e mëvonshme të specializuara hetimore si Byroja e Hetimit

që priten të ngrihen në funksion të reformës në drejtësi.

Në fjalën e tij, Kryetari i KLSH-së bëri një rezyme të përgjithshme të punës dhe veprimtarisë audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjatë këtyre viteve të fundit, duke theksuar një sërë treguesish dhe arritjesh të këtij institucioni si, rritja e performancës institucionale të KLSH-së, përmirësimi i cilësisë së auditimeve, rritja e shkallës së zbulueshmërisë së dëmeve ekonomike, rritja progresive e numrit të kallëzimeve penale të depozituara pranë organit të Prokurorisë, rritja e trajnimeve të stafit të KLSH-së, rritja e bashkëpunimit të këtij institucioni me strukturat akademike dhe shoqërinë civile, si dhe rritja e prezencës së këtij institucioni në median e shkruar dhe atë elektronike në funksion të një transparence sa më të madhe institucionale, kontribuimit si institucion i rëndësishëm kushtetues në mirëqeverisjen e vendit dhe çinstalimit të antikulturës së pandëshkueshmërisë.

Z.Junçaj tregoi një interes të veçantë në lidhje me bashkëpunimin e deritanishëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit me organin e Prokurorisë dhe institucionet e tjera shtetërore, duke kërkuar njëkohësisht edhe paraqitjen e çfarëdolloj problematike që KLSH ka hasur përgjatë këtyre viteve në kryerjen e veprimtarisë audituese si dhe dhënien e ideve se si mund të forcohet në të ardhmen roli, kontributi dhe bashkëpunimi i këtij institucioni dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit.

Kryetari i KLSH-së, në vlerësim të bashkëpunimit të deritanishëm me organin e Prokurorisë, theksoi në mënyrë të veçantë mbështetjen dhe kontributin e rëndësishëm të Prokurorit të Përgjithshëm, Z. Adriatik Llalla, në këtë bashkëpunim, duke shprehur bindjen që pavarësisht rezultateve që ky bashkëpunim ka mundur të prekë përgjatë këtyre viteve, ende mbetet shumë punë për të bërë jo vetëm nga institucionet tona por edhe nga shumë institucione të tjera shtetërore të angazhuara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte në luftën kundër korrupsionit. Kjo pasi pritshmëritë e opinionit të gjerë publik mbeten ende tepër të larta.

KLSH ka theksuar vazhdimisht përgjatë këtyre viteve, madje edhe në analizën vjetore të veprimtarisë së KLSH zhvilluar në 1 Shkurt 2016, faktin që një numër i konsiderueshëm zyrtarësh të lartë vazhdojnë të qëndrojnë të pashqetësuar në pozicionet e tyre në administratën shtetërore, pavarësisht faktit që ndaj tyre KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë kallëzime konkrete penale për shkelje të konstatuara sidomos në lidhje me procedurat e prokurimit. Fakt ky i cili vështirëson së tepërmi pozitat e organit të

Prokurorisë në hetimin dhe zbardhjen e plotë të këtyre çështjeve si pasojë e pushtetit të padukshëm që garanton qëndrimin e tyre ende në detyrë. Kjo ka kalçifikuar prej vitesh instalimin e antikulturës së pandëshkueshmërisë.

Një element i rëndësishëm në veprimtarinë tonë institucionale si institucion suprem auditimi mbetet zbatueshmëria e rekomandimeve të KLSH-së nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore, theksuar kjo në çdo Progres Raport të viteve të fundit të Komisionit Europian. Në këtë aspekt një rol të veçantë, përveç medias dhe opinionit të gjerë publik, luan edhe Kuvendi i Shqipërisë, agjent të të cilit ne konsiderohemi, dhe nisur nga ky fakt jo pa qëllim KLSH ka intensifikuar së tepërmi këto vitet e fundit bashkëpunimin me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit.

Në përfundim të këtij takimi Kryetari i KLSH-së i kërkoi z. Junçaj që t'i përcjellë në mënyrë miqësore Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara z. Donald Lu, falenderimet e tij të veçanta për prezencën e tij inkurajuese në analizën vjetore të KLSH-së 2015, si dhe mirënjohjen për kontributin e pazëvendësueshëm që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe z. Lu po japin në lidhje me reformën në drejtësi, pa të cilët kjo reformë nuk mund të realizohet. Në këtë mision të rëndësishëm, theksoi z. Leskaj, Ambasadori i SHBA, z. Donald Lu, ka si aleat gjithë opinionin e gjerë publik dhe popullin shqiptar.

Nga ana e tij z. Junçaj, u shpreh mjaft optimist për bashkëpunimin në të ardhmen ndërmjet OPDAT dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke kërkuar edhe angazhimin e afërt të KLSH-së sidomos në fushën e trajnimeve dhe dhënies së ekspertizës profesionale audituese.

Kryetari i KLSH takon ambasadorin e Italisë në Tiranë, z. Alberto Cutillo

Ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri, z. Alberto Cutillo, zhvilloi një takim më datën 10 shkurt 2016, me Kryetarin e KLSH z. Bujar Leskaj në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kryetari i KLSH e falenderoi Ambasadorin Italian për ndihmën e dhënë gjatë gjithë këtyre dy dekadave e gjysëm nga ana e Shtetit, qeverisë dhe popullit italian për qeveritë dhe popullin shqiptar, sidomos në momente të vështira të ekzistencës së tij. Më tej, ai prezantoi performancën e KLSH gjatë viteve të fundit, duke theksuar miratimin e ligjit të ri të KLSH në nëntor 2014 nga Parlamenti, tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, arritjet në shtimin e ndjeshëm të treguesit të dobishmërisë të institucionit, të treguesit të zbulimit të dëmit ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit, që për vitin 2015 kapi shifrën e 919 milionë eurove, si dhe rritjen 3.5 herë të numrit të kallëzimeve penale për vitet 2012-2015, në krahasim me katërvjeçarin 2008-2011.

Kryetari i KLSH theksoi gjatë takimit sfidën e institucionit të KLSH, por edhe të gjithë shoqërisë shqiptare për luftën ndaj anti-

kulturës së pandëshkueshmërisë që është instaluar në vend.

Nga ana e tij, Ambasadori Cutillo vlerësoi rolin e rëndësishëm që luan KLSH në luftën kundër korrupsionit në vend dhe për rritjen e përgjegjshmërisë së administratës publike. "Ju, -tha z. Cutillo keni tre role por edhe sfida të së ardhshmes që jam i bindur se do t'i përballoni me sukses. Së pari, mbajtjen e administratës publike të përgjegjshme. Së dyti, përmirësimin e performancës së administratës publike nëpërmjet rekomandimeve tuaja dhe së treti, kontributin në reformën ligjore me propozimet që ju bëni për ndryshimet në legjislacion".

Në të ardhmen, si KLSH dhe Ambasada Italiane në Shqipëri do të shtojnë kontaktet dhe shkëmbimin e informacioneve, me qëllim bashkëpunimin për përmirësimin e qeverisjes publike në vend.

Kontrollit i Lartë i Shtetit dhe Revista "MONITOR" nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

Në datën 10 shkurt 2016, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe Revistës "MONITOR".

Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH do të angazhohet për shkëmbimin e të dhënave me interes reciprok, duke hapur edhe një dritare tjetër komunikimi me publikun me qëllim rritjen e transparencës dhe modernizimin e institucionit. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi do të krijohet mundësia e rritjes së prezencës së audituesve të KLSH-së me shkrime profesionale në Revistën "Monitor", bashkë-përgatitje materialesh si buletine informative për mirëqeverisjen, trajnime, takime konsultative, tryeza të rrumbullakëta, workshop-e, seminare etj, aktivitete këto që synojnë rritjen e cilësisë së punës së stafit të KLSH-së dhe pjesëmarrjen e Revistës "Monitor" dhe ekspertizës së saj te kualifikuar, sipas një program të detajuar të miratuar nga palët.

Kryetari i KLSH-së nënvizoi hapjen e institucionit drejt organizatave të shoqërisë civile, me të cilat janë nënshkruar 19 marrëveshje bashkëpunimi në katër vitet e fundit si edhe vullnetin dhe seriozitetin e këtyre organizatave për të bashkëpunuar me KLSH, si dhe besimin e palëve se një bashkëpunim i sinqertë mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile jep rezultate konkrete në kufizimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe nga zj.Ornela

Liperi, Kryeredaktore e Revistës "MONITOR".

Zonja Liperi, nga ana e saj, vlerësoi bashkëpunimin dhe qasjen e re që ka KLSH ndaj Shoqërisë Civile dhe veçanërisht rritjen e transparencës së institucionit ndaj Medias dhe publikut në përgjithësi, duke theksuar se ky bashkëpunim do te gjenerojë ide të reja dhe do të ndihmojë në informimin e taksapaguesve shqiptarë lidhur me gjetjet dhe auditimet e KLSH-se, duke rritur ndjeshmërinë qytetare dhe duke përmirësuar luftën kundër korrupsionit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Revista "Monitor" shprehen së fundmi vendosmërinë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, duke bashkëpunuar për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, për t'i ofruar njëri tjetrit shërbime të ekspertizës dhe trajnimit për fushat respektive të bashkëpunimit, në dobi të rritjes së cilësisë së auditimit dhe të zgjerimit të ekspertizës së dhënë nga Revista "Monitor", krahas të tjerave edhe në auditime të veçanta performance.

Kontrollit i Lartë i Shtetit dhe Konfederata e Industrive të Shqipërisë nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

Në vijim të bashkëpunimeve me organizata të shoqërisë civile dhe të profesionistëve të fushës së auditimit, KLSH nënshkroi në datën 25 shkurt 2016, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Konfederatën e Industrive të Shqipërisë (Konfindustria).

KLSH ka qenë në vazhdimësi i hapur për bashkëpunime të tilla dhe ka eksperienca të mira në këtë drejtim. Marrëveshja me Konfederatën e Industrive të Shqipërisë është e 20-ta që nënshkruhet nga KLSH në katër vitet e fundit. Nënshkrimi i marrëveshjes me Konfindustrinë është një vlerë më tepër në këtë drejtim sepse fusha e aktivitetit të këtyre organizatave është e ndryshme dhe plotësojnë në mënyrë të natyrshme njëra tjetrën.

Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj vlerësoi seriozitetin dhe integritetin e Konfindustrisë në përballimin e sfidave dhe theksoi që pritshmëritë e publikut ndaj institucioneve shtetërore janë të larta, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe siguristh që puna nuk mund të përmbushet vetëm nga një institucion, cilido qoftë, por vetëm nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave.

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të përdorë të gjitha hapësirat ligjore për të mundësuar kontributin e ekspertëve të Konfindustrisë në ekipet e tij të auditimit, të atyre enteve shtetërore ku mungesa e transparencës, deformimi i konkurencës dhe rreziku i

lartë i korrupsionit përbën shqetësim të përbashkët.

Zoti Buxhuku, nga ana e tij, vlerësoi bashkëpunimin dhe veçanërisht rritjen e transparencës së KLSH-së, duke nënvizuar se të dy institucionet i bashkon një qëllim i përbashkët, mirëadministrimi i financave publike dhe respektimi i konkurencës së lirë në tenderat publikë, duke vendosur standardet e ekonomisë së lirë dhe të barazisë në treg.

Konfindustria dhe KLSH ranë dakord që të angazhohen bashkërisht në luftën kundër korrupsionit dhe të mungesës së transparencës në administratën shtetërore, me qëllim përmirësimin e qeverisjes.

Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe nga z.Gjergj Buxhuku, Administrator i Përgjithshëm i Konfindustrisë.

Vizita e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj, në Poloni

Në kuadër të Takimit të Grupit të Punës së INTOSAI-t për Rishikimin e ISSAI 30- Kodit të Etikës, në datat 2-4 mars 2016, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj zhvilloi një vizitë në Krakovë, Poloni.

Gjatë qëndrimit të tij në Krakovë, z. Leskaj u takua me Presidentin e Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë z. Krzysztof Kwiatowski, me të cilin u diskutua për fillimin e projektit të binjakëzimit për ngritjen e kapaciteteve institucionale të KLSH, që do të implementohet në KLSH në dy vitet e ardhshme në kuadër të projektit IPA.

Në përfundim të takimit, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Leskaj dhe Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë z. Kwiatowski nënshkruan një Deklaratë të Përbashkët në të cilën të dy institucionet, në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të vitit 2012, angazhohen:

• për arritjen e objektivave të projektit të binjakëzimit, me synim përdorimin me efektivitet, eficiencë, transparencë dhe përgjegjshmëri të fondeve publike;

• për implementimin e objektivave të projektit të binjakëzimit, të cilat janë në përputhje me praktikat në të mira të BE dhe standardet e aplikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI);

• për të punuar ngushtësisht së bashku për arritjen e rezultateve të pritshme të aktiviteteve të projektit të listuara në Kontratën e Projektit të Binjakëzimit;

• për angazhimin e stafit të dy institucioneve për implementimin e projektit të binjakëzimit;

• për mbështetjen e domosdoshme që kërkohet për implementimin e aktiviteteve të projektit, të përshkruara në Kontratën e Projektit të Binjakëzimit.

Z. Leskaj vlerësoi rëndësinë që ka ky projekt për Kontrollin e Lartë të Shtetit pasi institucioni i KLSH dhe audituesit do të kenë mundësinë të njihen me praktikat më të mira në fushën e auditimit dhe trajnimet që do të kryesh gjatë implementimit të projektit të binjakëzimit do t'i shërbejnë ngritjes së tyre profesionale dhe modernizimit të auditimit të jashtëm në Shqipëri.

Auditimit të Polonisë i ka dhënë një rëndësi të veçantë implementimit të suksesshëm të Projektit të Binjakëzimit në KLSH dhe është e angazhuar për përfshirjen në të të ekspertëve më të suksesshëm në fushën e auditimit. Kryetari i KLSH, z. Leskaj dhe Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, z. Kwiatowski më pas përshëndetën aktivitetin e Grupit të Punës për ISSAI 30 dhe adresuan vlerësime për kontributin dhe angazhimin e e përfaqësuesve të institucioneve supreme të auditimit në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës të INTOSAI-t për rishikimin e ISSAI 30- Kodit të Etikës, duke theksuar rëndësinë e pa diskutueshme që ka hartimi i këtij dokumenti për komunitetin e INTOSAI-t.

Në datat 2-4 mars 2016 ky grup pune zhvilloi takimin e tij të fundit, në të cilën u diskutuan komentet e përcjella nga 31 SAI-e mbi draftin e bërë publik nga INTOSAI. Dokumenti do t'i përcillet për miratim Komitetit Drejtues të INTOSAI dhe do të miratohet në Kongresin e XXII të INTOSAI-t që do të zhvillohet në Abu Dhabi në datat 5-11 dhjetor 2016.

Në këtë vizitë z. Leskaj shoqërohej nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano dhe Specialistet, znj. Alma Shehu dhe znj. Elira Elezi.

KLSH nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën Supreme të Auditimit të Republikës Çeke

Në datën 9-10 Mars 2016, në Pragë, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj, zhvilloi takime pune në Zyrën Supreme të Auditimit të Republikës Çeke dhe nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin e Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës Çeke, Ing.Miloslav Kala. Marrëveshja u përgatit në bazë të Nenit 15 të Deklaratës së Limës, të parimeve të përbashkëta të respektit, besimit dhe bashkëpunimit dypalësh të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) si edhe të Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).

Dokumenti i nënshkruar është me shumë vlera për KLSH-në dhe vjen pas nënshkrimit të disa marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et Europiane, të tilla si NIK-u Polak, Gjykata Austriake e Auditimit, Gjykata Turke e Llogarive, SAI-et e Kroacisë dhe Sllovenisë dhe në nivel rajonal, me SAI-et e Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, etj. Zbatimi i këtyre marrëveshjeve, ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së. Përvoja e gjatë 255 vjeçare e SAI-t Çek dhe cilësia e punës në auditim është një model shumë i mirë për t'u ndjekur nga KLSH. Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Zyra Supreme e Auditimit të Republikës Çeke, do të shkëmbejnë eksperiencë në veprimtarinë e tyre audituese, përmes vizitave të punës, trajnimeve dhe workshop-eve për audituesit shqiptarë, etj.

Gjatë ditës së parë të vizitës, pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe Presidenti i SAI-t Çek, z. Miloslav Kala, bënë nga një prezantim të SAI-ve respektive lidhur me mandatin e tyre të auditimit, pavarësinë e SAI- ve, strukturën organizative, ligjin në të cilin mbështetet funksionimi i SAI-ve në secilin prej të dy vendeve, si edhe nenet e Kushtetutës që lidhen me funksionimin e SAI-ve.

Kryetari i KLSH-së, pasi evidentoi lidhjet e forta historike dhe ekonomike mes popullit shqiptar dhe çek, bëri një prezantim të shkurtër të historisë 91 vjecare të KLSH-së, duke u përqëndruar më së shumti në arritjet, vështirësitë dhe sfidat e institucionit në vitet e fundit. Zoti Leskaj u përqëndrua në miratimin e Ligjit të Ri të KLSH-së nga Kuvendi i Shqipërisë në nëntor të vitit 2014, për të cilin pati shumë debate e kundërshti por që me këmbënguljen e KLSH-së, me mbështetjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë dhe veçanërisht me mbështetjen e ekspertëve të SIGMA dhe të DG Budget, ligji u miratua dhe është në përputhje të plotë me standartet e INTOSAI.

Zoti Leskaj, më tej, i njohu të pranishmit me numrin e auditimeve të realizuara

gjatë vitit 2015 (158), me rritjen e numrit të auditimeve të Performanscës, me rritjen e dëmit ekonomik të zbuluar, i cili në periudhën 2012-2015 ishte 8 herë më i madh krahasuar me periudhën 2008-2011, si edhe me efektivitetin e KLSH-së, i cili është rritur ndjeshëm, 4.2 herë më i lartë mesatarisht në periudhën 2012-2015, krahasuar me periudhën 2008-2011.

Zoti Leskaj u ndal gjithashtu ne rekomandimet e rëndësishme të KLSH-së për ndryshime ligjore, për ligje të reja, për borxhin publik, për detyrimet e prapambetura ndaj bizneseve, për botimet e KLSH-së, për prezencën e audituesve të KLSH-së në median e shkruar, bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe me Universitetet, bashkëpunimin me SAI-et partnere, etj.

Zoti Miloslav Kala nga ana e tij bëri një paraqitje të Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës Çeke dhe të strukturës së saj organizative. Aktualisht SAI Çek ka 470 punonjës, nga të cilët 340 punojnë në zyrat qendrore në Pragë dhe realizon mesatarisht 39 auditime në vit. Që nga viti 1991 deri tani, SAI Çek ka realizuar gjithsej 901 auditime, duke audituar 11 000 subjekte. Zoti Kala informoi lidhur me protokollin e auditimeve dhe detajet e realizimit të tyre, auditimin e zbatimit të buxhetit te shtetit, marrëdhëniet me parlamentin dhe me qytetarët, pavarësinë e SAI-t Çek lidhur me përzgjedhjen e auditimeve, data-base e auditimeve dhe të të dhënave të subjekteve që do të auditohen, mënyrën e të shkruarit të raporteve të auditimit dhe problematikat që hasen në këtë drejtim, etj,.

Të dy prezantimet u shoqëruam me pyetje të shumta dhe diskutime.

Në ditën e dytë, diskutimet u përqëndruan në Analizën e Riskut dhe për palën çeke diskutimi u mbajt nga zj.Jana Schenkova, Drjtore e Departamentit të I-rë, ku përfshihen planifikimi i auditimeve, menaxhimi i cilësisë së auditimit dhe analiza e riskut, ndërsa për palën shqiptare referoi z.Ermal Yzeiraj, Drejtor i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës. Në këtë panel u diskutua edhe për Konferencën e IV-t Shkencore të KLSH-së që do të zhvillohet në datat 20-21 qershor 2016, në Tiranë, e cila do të përqëndrohet në analizën e riskut.

Tema të tjera që u trajtuan ishin auditimet e performacës nga z. Stefan Kabatek, Drejtor i Departamentit të XVI, ku përfshihet edhe Auditimi i Performancës si edhe Data Base e auditimeve të EUROSAI-t që drejtohet nga SAI Çek, material që u referua nga zj.Sylva Mullerova, Drejtore e Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë. Kryetari i KLSH-së shprehu dakortësinë lidhur me kontributin konkret të KLSH-së për plotësimin e Data Base të auditimeve të EUROSAI-t me auditimet e KLSH-së.

Presidenti i SAI-t Çek, Ing. Miloslav Kala gjatë dy ditëve të qëndrimit të delegacionit të KLSH-së në Pragë shoqërohej nga drejtues të lartë të institucionit, si Zv/Presidentja, zj. Zdeňka Horníková, anëtarët e Bordit Drejtues të SAI-t Çek, zj.Hana Hyksova dhe z. Pavel Hrncir, drejtorët e Departamenteve z. Stanislav Koucky, z. Sylva Mullerova, zj. Jana Schenkova, z.Stefan Kabatek dhe z.Jaroslav Broza.

Zoti Bujar Leskaj shoqërohej në këtë vizitë nga z.Ermal Yzeiraj, Drejtor i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit Standarteve dhe Etikës, zj.Albana Agolli, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike dhe zj. Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Vizita u organizua dhe u realizua nën kujdesin e vecantë të Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Republikën Çeke, z.Riza Poda, i cili asistoi edhe gjatë nënshkrimit të marrëveshjes.

Ambasadori Poda dhe z.Lulzim Çota, Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Republikën Çeke shoqëruan delegacionin e KLSH-së edhe gjatë takimeve të punës në Zyrën Supreme të Auditimit të Çekisë.

KLSH merr pjesë në takimin e grupit të punës të EUROSAI-t për Auditimin e TI për projektin e vetëvlerësimit, ITSA dhe ITASA

Nga data 15 deri më 17 mars në Bern të Zvicrës u mbajt takimi i grupit të punës së EUROSAI-t për Auditimin e IT për projektin e vetëvlerësimit të IT dhe vetëvlerësimit Auditimit IT (ITSA dhe ITASA).

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Gjykata Europiane e Auditimit, Gjykata e Llogarive të Francës, SAI i Hungarisë, SAI i Lituanisë, SAI i Maltës, Gjykata e Llogarive e Moldavisë, NIK i Polonisë, Zyra e Kombëtare e Auditimit të Bullgarisë, Gjykata e Llogarive e Federatës Ruse, Gjykata e Llogarive e Turqisë dhe Zyra Federale Zvicerane e Auditimit.

KLSH u përfaqua në takim nga një grup i Drejtorisë së Auditimit të Teknologjisë së Informacioniti i përbërë nga Kozma Kondakçiu Drejtor, Aulona Jani Audituese e Lartë dhe Marenglen Sinani Auditues.

Fjalën e hapjes së takimit e mbajti z. Bernhard Hamberger nga SAI-t i Zvicrës, i cili pasi përshëndeti pjesëmarrësit zhvilloi

një analizë të vendimeve të takimit të grupit të punës të EUROSAI-t mbajtur në Warshavë më Korrik 2015, nga të cilat veçoi vendimin e ripunimit të ISSAI 5300 "Udhëzime mbi Auditimin IT" nga grupi i punës së Auditimin IT të INTOSAI, drafti i shpërndarë u diskutua nga pjesëmarrësit të cilët theksuan rëndësinë e plotësimit të boshllëkun midis standardeve dhe udhëzimeve ekzistuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit.

Me moderim nga Z.Bernhard Hamberger dhe znj. Brigitte Schnyder Von Morischn të SAI-t të Zvicrës u krye një përsëritje e metodologjisë së ITSA-s dhe ITASA-s, si dhe zhvillimet e reja të ndodhura që nga takimi i Warshavës.

Nga moderatorët z. Musa Kayrak i TCA, z. Milian Istatkov i SAI-t të Bulgarisë, z.Ivo Koppelma i ECA dhe z. Dainius Jakimavičius i SAI-t të Lituanisë u kryen prezantimet e vetëvlerësimeve dhe nga diskutimet u arrit në konkluzionin mbi nevojën e disa ndryshimeve të metodologjisë, ku ndër të tjera veçojmë atë se analiza SWOT nuk konsiderohet më pjesë e metodologjisë së vetëvlerësimit dhe nevojën e disa ndryshimeve në pyetësorët e vetëvlerësimit dhe të mjeteve për kryerjen e procesesit (në Excel zhvilluar nga SAI i Hungarisë dhe web zhvilluar nga SAI-t Bullgar).

Në ditën e dytë, presidenti i SAI-t Zviceran, z. Michel Huissoud prezantoi rezultatet e Auditimit Paralel të kryer mbi Pasaportat Biometrike nga SAI-et e Belgjikës, Letonisë, Lituanisë, Norvegjisë, Portugalisë dhe Zvicrës.

Në ditën e fundit të ndarë në grupe pjesëmarrësit diskutuan e hodhën ide të reja për projekte dhe një përditësim te projekteve ekzistuese veçanërisht ato të Auditimeve Paralele duke miratuar një listë prej 17 projektesh e idesh për t'u propozuar në takimin e ardhshëm të grupit të punës që do të mbahet në qershor ne Pragë.

Grupi i KLSH mori pjesë aktive në diskutimet duke propozuar 2 ide për projektet e reja:

-Krijimi i një mjeti për vlerësimin e riskut.

-Hartimin e metodologjisë për përdorimin e vizualizimit në auditim

Propozimet u pëlqyen dhe u futen në propozimet që do diskutohen në takimin e Pragës.

Grupi i KLSH krahas ndjekjes së zhvilloi takime të veçanta me moderatorët z.Ivo Koppelmaa të ECA-s dhe z Milian Istatov, z. Miroslav Ivanov nga SAI Bullgar për ITASA që do të kryhet në KLSH.

Workshop-i në KLSH do të zhvillohet në muajin qershor 2016 gjatë tre ditëve.

KLSH merr pjesë në takimin e personave të kontaktit(liaison officers) të komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të BE-së

Në datat 6-8 prill 2015 u zhvillua në Riga, Letoni, takimi i personave të kontaktit të Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të BE-së. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

përfaqësues të 28 SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së dhe përfaqësues të SIGMA-s, si dhe delegacione të SAI-ve të vendeve kandidate dhe para kandidate për në BE si Turqia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnje Hercegovina.

Në ditën e parë u zhvillua takimi i personave të kontaktit të vendeve kandidate dhe parakandidate të BE. Në këtë takim u diskutua rreth aktiviteteve që ky rrjet do të organizojë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 dhe përgjatë vitit 2017. Kështu, u rikonfirmua që në datat 13-14 prill 2016 nga SAI i Serbisë do të organizohet tavolina e rrumbullakët me temë "Opinioni i Auditimit", në të cilën SAI-et pjesëmarrëse do të shkëmbejnë eksperiencat për hartimin e një opinioni bazuar ne ISSAI-t për auditimet financiare dhe ato të përputhshmërisë. Institucioni ynë në këtë event do të përfaqësohet nga një grup audituesish me përvojë të cilët do të prezantojnë eksperiencën e KLSH-së në Auditimet Financiare. Në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta të rrjetit të vendeve kandidate të BE, nga SAI i Bosnje dhe Hercegovinës do të organizohet në Shtator të vitit 2016 tavolina e rrumbullakët mbi pavarësinë e SAI-eve. Synimi i aktivitetit është krijimi i një platforme për diskutimin e sfidave me të cilat ndeshen SAI për të ruajtur pavarësinë e tyre institucionale dhe financiare. Target grupi i cili do të marrë pjesë në këtë aktivitet do të jenë Presidentët e SAI-ve. Një temë mjaft e rëndësishme është marrëdhënia e SAI me parlamentin. Në këtë kuadër nga SAI Turk do të organizohet në nëntor Konferenca me temë "Kuadri i marrëdhënieve midis SAI-eve dhe Parlamenteve". Konferenca synon zhvillimin dhe prezantimin e një udhëzuesi, i cili do të përdoret nga SAI-et për të forcuar marrëdhënien me Parlamentet. Kjo konferencë do të jetë e një niveli të lartë përfaqësimi në të cilët do të marrin pjesë Presidentët e SAI-ve dhe përfaqësues të parlamenteve të vendeve pjesëmarrëse. Marrëdhënia midis SAI-t dhe Parlamentit konsiderohet si një nga shtyllat kryesore të mbikëqyrjes parlamentare në kuadrin e rritjes së llogaridhënies publike dhe transparencës.

Auditimi i performancës është një fushë e re auditimi për shumë nga vendet kandidate të BE dhe ekspertiza dhe praktikat e vendeve të BE dhe e Gjykatës Evropiane të Auditimit është e mirëpritur nga këto vende. Me iniciativën Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe me mbështetjen e Gjykatës Evropiane të Auditimit, disa nga vendet e Ballkanit si Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia do të kryejnë auditime paralele të performancës me temë "Prokurimi Publik". Në kuadër të këtij auditimi, u vendos që përgjatë vitit 2016 të kryhen disa workshop-e në të cilat ekspertë të SNAO dhe ECA do të prezantojnë praktikat më të mira për të gjitha fazat e kryerje së auditimit, duke filluar që nga faza e

planifikimit e deri në hartimin e raportit përfundimtar.

Korrupsioni dhe mashtrimi janë dy fenomene të cilat audituesit i ndeshin shpesh në punën e tyre audituese. Në këtë kuadër Kontrolli i Lartë i Shtetit mori përsipër për të qene vendi pritës dhe organizator i workshop-it "Për luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit". Ky event u parashikua të kryhet gjatë gjysmës së parë të vitit 2017.

Në takim u theksua organizimi i suksesshëm nga ana e KLSH i workshop-it "Për materialitetin dhe auditimin bazuar në kampione", i organizuar në Vlorë në nentor 2015.

SAI-et e rrjetit të vendeve kandidate të BE vendosën të organizojnë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 një seri workshop-esh, në të cilat do të trajtohen aspektet teknike të fazave e auditimit financiar dhe atij të përputhshmërisë.

Në ditën e dytë të aktivitetit personat e kontaktit të vendeve anëtare të BE diskutuan rreth aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë vitit 2016 dhe raportuan për ecurinë e grupeve të punës të cilat kryejnë auditime në fusha të ndryshme.

Kështu nga SAI Sllovak u raportua rreth përgatitjeve për takimin e Drejtuesve të SAI-eve, anëtarë të Konitetit të Kontaktit i cili do të organizohet në datat 21-22 tetor 2016 në Bratislavë.

Nga SAI i Holandës, Gjykata Evropiane e Audituesve dhe SAI i Letonisë u raportua ecuria e punës së Task Forcës për Bashkimin Bankar Evropian dhe përkatësisht takimet e grupeve audituese të SAI-eve pjesëmarrëse, përditësimi i ecurisë së auditimit të ECA mbi mekanizmin e vetëm mbikëqyrës dhe përgjigjet e palëve të interesuara mbi këtë bashkim.

Gjatë takimit u diskutua gjerësisht propozimi i SAI të Polonisë për hartimin e një deklarate të përbashkët për të ftuar në aktivitete të dakortësuara më parë të SAI-eve të Ukrainës, Moldavisë dhe Gjeorgjisë.

Përfaqësues të SAI-t Gjerman, raportuan rreth zhvillimeve në procesin për hartimin dhe miratimin e standardeve EPSAS dhe rreth deklaratës së SAI të landit të Baden Wuerttenberg për sistemet e kontrollit dhe kostot administrative në fondet e EU per agrikulturën.

SAI i Italisë raportoi mbi aktivitetin e Grupit të Punës për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, si kryesues i grupit të vendeve që po kryejnë auditimin mbi TVSH-ne në vendet e BE raportoi mbi ecurinë e auditimit dhe disa nga rezultatet e pritshme te këtij auditimi.

Në axhendën e këtij aktiviteti u prezantuan dhe aktivitetet e ardhshme të planifikuara të rrjetit të vendeve kandidate dhe para kandidate ku nëpërmjet të tjerave iu bë prezent të pranishmëve propozimi i përfaqësuesve të KLSH-së për marrjen përsipër dhe organizimin e Workshopit "Mbi luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit".

Në këtë aktivitet Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga Kryetari KLSH-së, z. Bujar Leskaj, Sekretari i Përgjithshëm, znj.

Luljeta Nano, dhe Audituesja e parë, znj. Alma Shehu.

Takimi i ardhshëm i Komitetit të Kontaktit do të zhvillohet në Stokholm, Suedi gjatë vitit 2017.

Takim i Grupit të Punës së EUROSAI-t lidhur me Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat

Në datat 5-7 prill 2016, në Baku, Azerbajxhan u zhvillua takimi i Dytë i Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat, i cili u fokusua në sfidat e inplementimit të suksesshëm dhe zbatimi praktik i ISSAI-ve 5500-5599 "Udhëzime mbi Auditimin e ndihmës për Katastrofat: risqet për mashtrim financiar dhe korrupsion, duke përdorur metodat e reja të marrjes së të dhënave". Organizues i këtij takimi ishte Dhoma e Llogarive (SAI) e Ukrainës që kryeson këtë grup pune të EUROSAI-t, ndërkohë që Dhoma e Llogarive e Azerbajxhanit ishte mikpritëse dhe mundësoi realizimin e aktivitetit. Në takimin dhe diskutimet e vendeve pjesëmarrëse u sollën përvoja të shumta të përdorimit të metodave të reja në sigurimin e të dhënave, sikurse është sistemi GIS në auditimin e menaxhimit të katastrofave. U diskutua mbi eksperiencën e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë në parandalimin dhe menaxhimin e risqeve të përmbytjeve, apo në eksperiencat e Gjykatës së Llogarive të Italisë në auditimet për pakësimin e riskut hidrologjik të katastrofave. Me interes ishte qasja e auditimeve të realizuara nga SAI i Ukraines për menaxhimin e përmbytjeve, si dhe eksperienca e përfaqësuesve të Indonezisë lidhur me vështirësitë praktike në zbatimin e standardeve ISSAI 5510 "Mbi Auditimin e Reduktimit të Riskut të Katastrofave, ISSAI 5520 "Mbi Auditimin e Aktiviteteve Pas Katastrofës", ISSAI 5540 "Mbi Informacionin Gjeo-hapësinor për Auditimin e Menaxhimit të Fatkeqësive", etj.

Në takimin e Dytë të Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat, morën pjesë edhe përfaqësues të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA), SAI-ve të Italisë (Presidenti i Gjykatës së Llogarive të Italisë z. Raffaele Squitieri), të Turqisë, Polonisë, Shqipërisë, Letonisë, Moldavisë, Bullgarisë, Rumanisë, Rusisë, Serbisë dhe Indonezisë. Nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave u arrit që të përcillej një qasje e koordinuar në ndihmë të qeverive respektive në zhvillimin e instrumenteve efektive për parandalimin dhe eliminimin e pasojave që shkaktojnë fatkeqësitë dhe katastrofat natyrore, pa harruar ato katastrofa që janë pasojë e aktivitetit njerëzor, duke u bazuar në përvojat e fituara dhe në standardet ISSAI 5500-5599

"Udhëzimet për auditimin e fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat". Gjithashtu u diskutua mbi parimet dhe procedurat mbi të cilat do të realizohen auditime të kësaj natyre. U ndalua në domosdoshmërinë e fondeve në parandalimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të vijnë nga katastrofat, duke sjellë përvoja nga SAI-t të cilat kanë realizuar auditime të kësaj natyre, sidomos përvoja nga kolegët ukrainas, bullgarë, azerbajxhanas, turq dhe italianë. Në këtë aktivitet KLSH u përfaqësua nga znj. Manjola Naço, Drejtore Departamenti në KLSH dhe znj. Amantja Patozi, specialiste në Drejtorinë e Komunikimit, Publikimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Kontrollit i Lartë i Shtetit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me organizatën "Albanian Platform for Policy Advocacy"

Në datën 22 prill 2016, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe organizatës jo-fitim prurëse "Albanian Platform for Policy Advocacy" (Platforma Shqiptare për Advokimin e Politikave)", përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv i saj, z. Brenton Kotorri. KLSH gjatë viteve të fundit ka rritur bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile dhe organizata të profesionistëve të fushës së Ekonomisë, duke arritur në 22 marrëveshje bashkëpunimi, si rezultat i të cilave ka pasur produkte dhe rezultate konkrete.

Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj vlerësoi seriozitetin dhe ambicien e kësaj organizate, që përbëhet nga të rinj të moshës 18-30 vjeç, të cilët me vendosmëri dhe guxim kanë hyrë në tregun shqiptar të ideve, duke u ndjekur me interes nga publiku dhe duke ndikuar në rritjen e llogaridhënies dhe të transparencës së veprimtarisë së institucioneve publike. Marrëveshja do të ketë përfitime të dyanshme, nga njëra anë, veprimtarët e "Platformës Shqiptare për Advokimin e Politikave" do të njihen me auditimet, gjetjet dhe rekomandimet e një institucioni të pavarur kushtetues si KLSH dhe nga ana tjetër, audituesit e KLSH-së do të përfitojnë nga kurajo e këtyre të rinjve për të denoncuar si edhe nga ndjeshmëria që ka opinioni qytetar ndaj veprimtarëve të kësaj organizate, të cilët kanë treguar vlera gjatë kësaj kohe të aktivizimit të tyre në jetën shoqërore të vendit.

Nga ana e tij, z. Brenton Kotorri, Drejtori Ekzekutiv i kësaj organizate vlerësoi transparencën e KLSH-së dhe hapjen e saj ndaj shoqërisë civile. Ai theksoi se organizata që ai drejton po rritet shpejt, në sajë të besimit që kanë fituar tek qytetarët sepse ata janë përpjekur që me analizat dhe publikimet e tyre profesionale të mbushin boshllëkun që kishte në tregun shqiptar, për t'i thënë dhe evidentuar problemet, qartë, pa ekuivoke dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke peshuar faktet drejt dhe me paanësi. Gjithashtu zoti Kotorri e vlerësoi KLSH si një nga partnerët më prestigjioz, në luftën e përbashkët kundër korrupsionit.

Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të "Albanian Platform for Policy Advocacy" dhe drejtues e audites të KLSH-së.

Trajnime të stafit

Në funksion të linearizimit të nevojave personale të audituesve me objektivat për zhvillim të institucionit të shprehura në strategjinë për zhvillimit insitucional 2015 – 2017, të shprehura në programin vjetor të trajnimeve, për periudhën Janar – Prill 2016, janë zhvilluar 1,185 ditë trajnimi. Trajnimi zhvillohet në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe vendas. Ditët e trajnimit jashtë vendit janë 280 ditë trajnimi dhe në vend janë 905 ditë trajnimi.



Në programet e trajnimit jashtë vendit përmendim trajnim pranë Gjykates Turke të Llogarive, Hyrje ne Auditimin e IT, Luxemburg, projektet ITSA dhe ITASA, Bern, Seminar per antikorrupsionin, Hungari etj.

Në trajnimet ne vend, jashtë institucionit të KLSH-së përmendim trajnimin e zhvilluar nga ASPA, nga Auditi i Brendshëm, Ministria e Financave, trajnime nga përfaqësues të Komunitet Evropian, AFCOS-Training të stafit të lartë menaxherial për projektin e binjakëzimit IPA, etj. Në institucion janë zhvilluar trajnime si nga burime të brendshme trajnimi ashtu dhe nga burime të jashtme me partnerët tanë ndërkombetarë, parnerët tanë në vend, etj. Format e trajnimit kanë qenë face-to-face, e-learing, worshope dhe seminare të përbashkëta, etj. Trajnimi në KLSH realizohet i diferencuar në funksion të eksperiencës së audituesit, formimit të tij profesional dhe nevojave e karakteristikave të tjera personale. Në grafikun në vijim po evidentojnë dite trajnimet sipas audituesve (me

eksperience, të rinj dhe trajnime të përbashkëta të rinj dhe me experience):



Prioritet i është dhënë trajnimit të stafit të ri auditues duke ofruar module trajnimi të specifikuara në dimensione të njohurive të standardeve ndërkombetare të auditimit, njohurive mbi kuadrin rregullator të subjekteve të audituara. Në këtë aspekt trajnime të metodologjisë, trajnime të standarteve dhe trajnime të tjera paraqiten:



Gjatë periudhës janar-prill, stafi i KLSH-së ka marrë pjesë në shumë aktivitete ndërkombëtare si trajnime, workshop-e, etj.

Trajnimi i 22 audituesve të KLSH-së, pranë Gjykatës Turke të Llogarive, zhvilluar në datat 18 – 22 Janar 2016. KLSH mori pjesë me një grup prej 22 audituesish, (grupi i X-të i audituesve që trajnohen pranë TCA dhe në total janë 176 auditues që janë trajnuar në periudhën 2012-2015).Grupi i KLSH-së, i përbërë nga Drejtor Departamenti Bajram Lamaj, Kryeauditues Vullnet Karafilaj, Muhamet Kavaja, Selfo Zeneli, Përgjegjës Sektori Gëzim Zilja, si dhe audituesit Albert Thoma, Elira Elezi, Xhuljeta Çelaj, Gerti Bode, Elida Koçani, Helena Solis, Krisi Anastas, Mareglen Sinani, Xhein Xhindolli, Alfonc Gabili, Enkelejda Tole, Erieta Këlliçi, Hektor Kosova, Benet Koka, Haki Hoxhaj, Orgest Levani dhe Gentjan Leva, në ditën e parë të trajnimit u prit nga Presidenti i Gjykatës së Llogarive Prof.Ass. Dr. Recai Akyel, i cili përshëndeti audituesit dhe i uroi për suksese gjatë trajnimit.

Workshop-i i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë (SAO) në Budapest dhe Szarvas me temë "Nga anketa e integritetit tek auditimi i integritetit", zhvilluar në datat 22 deri më 26 Shkurt 2016 me iniciativën dhe mbikëqyrjen e SAO-s. Konferenca u përshëndet nga Presidenti i SAO Hungareze, z. László Domokos. Në këtë aktivitet merrnin pjesë gjithashtu z. Péter Szijjártó, Ministër i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Hungarisë dhe z. Einar Gørrissen, Drejtor i Përgjithshëm i IDI (Norvegji).Në këtë aktivitet morë pjesë përfaqësues të SAI-ve të ndryshme si Hungaria, Portugalia, Greqia, Shqipëria, Bosnja and Herzegnovina, Maqedonia, Indonesia, Kirgizstan, Malajsia, Mauritania, Moldavia, Mali i Zi, Pakistani, Filipinet, Sudani, Zvicra, Tajlanda, Ukraina,

Bangladesh dhe Tanzania. KLSH në këtë aktivitet u përfaqësua nga z. Muhamed Kavaja, z. Vullnet Karafilaj me detyrë Kryeauditues si dhe z. Skënder Muça me detyrë Auditues i Lartë.

Workshop-i PPA I, zhvilluar më 25-26 Shkurt 2016 në Gjykatën Europiane të Auditimit, Luksemburg, ku u bë prezantimi i koncept-ideve mbi Projektin e Dytë të Auditimit të Performancës në nivel rajonal. Punimet e workshop-it u shtrinë në dy ditë dhe u drejtuan nga Zv/Auditori i Përgjithshëm i SAI-t suedez, z. Magnus Lindell. Seicili përfaqësues i SAI-eve pjesëmarrëve bëri një prezantim të shkurtër të punës në PPA I dhe dobinë e këtij projekti në perspektivën specifike të SAI-t përkatës. Më pas u kalua në propozimet për tematikat potenciale që mund të auditohen në PPA II. Propozimet u fokusuan në katër drejtime kryesore:

1. Prokurimi Publik,

2. Investimet e Huaja Direkte,

3. Borxhi Publik dhe

4. Cilësia e produkteve dhe certifikimi i tyre.

SAI shqiptar, i përfaqësuar nga z. Rinald Muça, drejtor i departamentit të auditimit të performancës, z. Alfred Zylfi dhe znj. Elfrida Agolli, auditues të lartë, u shpreh në favor të dy temave të para, duke argumentuar se Prokurimi Publik është një fushë me risk të lartë, përsa i përket ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike.

Workshop-i rajonal "Mbi Opinionin e Auditimit", zhvilluar në datat 13 dhe 14 prill 2016 në Beograd në kuadër të aktiviteteve të dakortësuara në Konferencën mbi Marrëdhëniet e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve Kombëtare të vendeve të rajonit, e cila u zhvillua në Budva, Mal të Zi në datat 18-19 nëntor 2013. Ky aktivitet është pasuesi i workshopit të organizuar nga KLSH në Vlorë në datat 3 dhe 4 nëntor 2015 "Mbi materialitetin dhe auditimin bazuar në kampione". Workshopi u mbështet nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO) bazuar në Planin e Aktiviteteve të propozuara nga Grupi i Përbashkët i Punë për Aktivitetet e Auditimit (JWGAA). KLSH në këtë aktivitet u përfaqësua nga zj. Yllka Pulashi, Drejtore e Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Artur Hasanbelliu, Drejtor i Auditit të Brendshëm, zj. Selime Bregu audituese e lartë dhe zj. Ina Sokoli, audituese.

Trajnimi me temë "Hyrje në Auditimin IT", zhvilluar në datat 18 - 20 prill 2016 në Luksemburg, pranë Gjykatës Europiane të Audituesve. Në këtë trajnim morën pjesë auditues të brendshëm të ECA, përfaqësues të SAI-t turk dhe spanjoll, si dhe të interesuar të sektorit privat. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga zj. Irma Idrizaj, audituese. Lektor i trajnimit ishte z. Patrick Soenen, ekspert i jashtëm i ECA. Qëllimi i trajnimit ishte njohja e procesit të auditimit në një mjedis teknologjik, mësimi i praktikave të mira nga COBIT 4.1, përdorimi i auditimit IT brenda auditimit financiar, përdorimi i

auditimit IT brenda auditimit të performancës.

Trajnimi mbi prokurimet e BE-së, zhvilluar më datat 21-22 prill 2016 nga "Instituti Europian i Administratës Publike – The European Institute of Public Administration", në Dubrovnik-Kroaci, i cili kishte si objekt dhënien e një pasqyre të detajuar të Direktivës të Komisionit Europian për prokurimet "Directive 2014/24/EU" dhe nocioneve bazë të kontratave të Partneritetit Publik Privat (PPP). Moderator të trajnimit ishin zj. Rita Beuter dhe z.Michael Brunett, ekspertë në Institutin Evropian të Administratës Publike. Në trajnim merrnin pjesë kryesisht përfaqësues nga Ministria e Financave, Punëve Sociale dhe Transporteve të Bullgarisë, nga Ministria e Financave të Çekisë, Polonisë, Lituanisë dhe Auditues nga Agjencia e Programeve të Bashkimit Evropian të Kroacisë. KLSH u përfaqësua z. Fatmir Zilja dhe z.Idlir Dervishi, auditues në Departamentin e Auditimit të Buxheti Qëndror, Administratës së Lartë Publike dhe Auditimit të Brendshëm.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT TË FINLANDËS

NATIONAL AUDIT OFFICE OF FINLAND

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucioni më i lartë i auditimit të Finlandës dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Ajo auditon financat e shtetit dhe menaxhon asetet në mënyrë që të sigurojë që fondet publike janë shpenzuar në mënyrë sa më ekonomike dhe në përputhje me legjislacionin.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka qenë historikisht organi më i rëndësishëm monitorues në Finlandë. Ai është institucioni më i vjetër shtetëror finlandez, përgjegjës për auditimin dhe menaxhimin financiar të ekonomisë shtetërore.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucioni më i lartë i auditimit të Finlandës dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Ajo auditon financat e shtetit dhe menaxhon asetet në mënyrë që të sigurojë që fondet publike janë shpenzuar në mënyrë sa më ekonomike dhe në përputhje me legjislacionin. Së bashku me administratën, Zyra Kombëtare e Auditimit punon për të zhvilluar një menaxhim të shëndoshë financiar dhe për të siguruar përdorimin e drejtë dhe efektiv të fondeve publike. Si një ekspert i pavarur, ai mbështet Kuvendin, Qeverinë dhe administratën shtetërore në vendimmarje.

Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO)

Zyra Kombëtare e Auditimit të Finlandës është organ ekspert i pavarur dhe neutral. Detyra e saj është të kontrollojë ligjshmërinë dhe drejtësinë e menaxhimit financiar dhe në përputhje me buxhetin e shtetit. Zyra Kombëtare e Auditimit informon Parlamentin, Qeverinë dhe nivelet e tjera të administratës mbi menaxhimin financiar të shtetit dhe të aktiviteteve administrative.

Zyra Kombëtare e Auditimit mbron interesat e qytetarëve dhe taksapaguesve, me anë të auditimit të të ardhurave shtetërore, përdorimit të fondeve publike, si dhe menaxhimit të pronës shtetërore.

Me anë të auditimit, ajo nxit ekonomicitetin, e dhe efektivitetin në administratën shtetërore, që lidhen me kontrollin e menaxhimit financiar. NAO ka të drejtë të marrë të gjithë informacionin që i nevojitet nga subjekti i audituar, për kryerjen e detyrave të tij. Autoritetet shtetërore dhe ndërmarrjet e biznesit, duhet të raportojnë menjëherë, çdo rast shpërdorimi të fondeve në Zyrën Kombëtare të Auditimit. NAO i raporton organeve përkatëse parregullsitë dhe mbikëqyr nëse mangësitë e vërejtura janë korrigjuar.

Organizimi

Zyra Kombëtare e Auditimit drejtohet nga Audituesi i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga parlamenti për një mandat 6-vjeçar.

Zyra Kombëtare e Auditimit përfshin auditimin financiar, auditimin e performancës dhe menaxhimin e njësive ekzekutive, të cilat janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e auditimit dhe raportimin në Parlament. Ajo përfshin gjithashtu edhe njësitë e Administrimit dhe Informacionit.

NAO ka një staf prej rreth 150 punonjësish me seli qëndrore në Helsinki dhe me degë në Turku dhe Oulu. Statusi, detyrat dhe aktivitetet e NAO-s, përcaktohen në nenin 90 të Kushtetutës së Finlandës dhe në akte të tjera të caktuara.

Kuadri Ligjor

Ligji mbi Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Pozita dhe detyrat

Ka një organ të pavarur të Kontrollit të Shtetit, i cili lidhet me Parlamentin. Detyra e Zyrës së Auditimit është të sigurojë ligjshmërinë dhe efektivitetin e menaxhimit financiar të shtetit si dhe pajtueshmërinë me buxhetin. Detyrat e NAO-s nuk përfshijnë auditimin e menaxhimit financiar të Parlamentit, të fondeve për të cilat kuvendi është përgjegjës, të bankës së Finlandës apo institucioneve të sigurimeve shoqërore. E drejta e NAO-s për të mbikqyrur transferimin e fondeve nga Finlanda drejt BE-së, përcaktohet me ligje të veçanta.

Të drejtat e auditimit

Zyra e Auditimit të shtetit ka të drejtë të auditojë:

1. Autoritetet shtetërore, agjencitë, ndërmarrjet e biznesit, grupet e biznesit dhe fondet shtetërore.
2. Kompanitë në të cilat shteti ka interesa dhe kompanitë e tjera të përmendura në nenin 19, veçanërisht kur përcaktohet se janë përdorur pronësia dhe aksionet e shtetit.
3. Komunat, federatat komunale, fondacionet dhe organizatat e tjera, personat juridikë dhe personat privatë, të cilët kanë marrë fonde ose mbështetje apo përfitime ekonomike nga shteti. Audituesit përcaktojnë nëse këto fonde janë përdorur për qëllimet e duhura.
4. Organizatat dhe subjektet e tjera ligjore, të cilat kanë marrë leje nga shteti për të prokuruar fonde, për ti përdorur ose shpërndarë për një qëllim të veçantë.
5. Institucionet e kreditimit ose organizata të tjera që kujdesen për

transaksionet financiare të shtetit, ose përdorin dhe menaxhojnë fonde dhe prona shtetërore.

6. Fonde të tjera për të cilat shteti është përgjegjës.

Parashikimet e paragrafit 1 pika 3, të lidhur me përfituesit e mbështetjes shtetërore, janë gjithashtu të zbatueshme edhe për ndërmjetësit dhe palët të cilët kanë transferuar fondet e marra nga persona privatë, për qëllime personale.

Raportimi në Parlament

NAO duhet të paraqesë në Parlament një raport mbi veprimtarinë e tij, çdo vit deri në fund të shtatorit, si dhe raporte të tjera të veçanta sipas nevojës. Me anë të raporteve, ka të drejtë të marrë informacione edhe Komisioni parlamentar.

Audituesi i Përgjithshëm

Aktivitetet e Zyrës së Auditimit drejtohen nga Audituesi i Përgjithshëm, i cili është përgjegjës për të gjitha çështjet, përveç atyre që janë përgjegjësi e Bordit, ose për çështje për të cilat në ligj përcaktohet ndryshe.

Audituesi i Përgjithshëm zgjidhet nga Parlamenti. Dispozita të mëtejshme në lidhje me zgjedhjet, përfshihen në procedurën e Parlamentit (40/2000). Mandati i Audituesit të Përgjithshëm zgjat 6 vjet dhe vazhdon deri në momentin që fillon mandati i Audituesit të ardhshëm. Audituesi i zgjedhur do të lirohet nga çdo detyrë e mëparshme, gjatë ushtrimit të detyrës si Auditues i Përgjithshëm.

Audituesi i Përgjithshëm vendos se si të paraqesë çështjet për të cilat ai është përgjegjës.

Bordi Këshillues

Në strukturën e saj, NAO ka edhe një Bord Këshillues. Detyrat e këtij Bordi janë që të ruajë dhe të zhvillojë lidhjet e NAO-s me partnerët, të ndërmarrë iniciativa për zhvillimin e auditimeve dhe të monitorojë efektivitetin në marrëdhëniet me partnerët. Bordi e zgjedh kryetarin nga radhët e anëtarëve të tij.

NAO mund të emërojë si anëtarë të Bordit, përfaqësues nga partnerët kyç të bashkëpunimit ose ekspertë të administrimit financiar publik, për një peridhë jo më shumë se 3 vjet.

Raportimi i abuzimeve

Pavarësisht nga rregullat e konfidencialitetit, çdo autoritet shtetëror, agjenci apo ndërmarrje biznesi, duhet të raportojë menjëherë në Zyrën e Kontrollit të Shtetit, për çdo shpërdorim të fondeve ose pronave që ajo menaxhon ose për të cilat është përgjegjës.

Ligji mbi të drejtën e Zyrës së Auditimit për të audituar transferta të caktuara mes Finlandës dhe Komunitetit Evropian (17 mars 1995/353).

Qëllimi i aplikimit

Ky ligj zbatohet për transfertat e kredive mes Finlandës dhe Komunitetit Evropian dhe auditon përdorimin e tyre. Sipas këtij ligji, transfertat e kreditit do të thotë pagesa ose llogaritë e detyrimeve të shtetit, komunave, shoqërive finlandeze,

shoqërive që operojnë në Finlandë, fondacioneve, ndërmarrjeve dhe individëve ndaj Komunitetit Evropian, si dhe të subvencioneve, kredive, financimeve të tjera, letrave me vlerë, ose forma të tjera të subvencionimit, të drejtuara në Finlandë nga Komuniteti Evropian.

Parashikimet e paragrafit 1, në lidhje me transferimin e kredive nga Komuniteti Evropian, janë gjithashtu të zbatueshme edhe për ndërmjetësit dhe palët të cilët kanë transferuar fondet.

Kompetencat

Zyra e Auditimit të Shtetit ka të drejtë të auditojë transferimin e kredive sipas referencave në paragrafin 1, si dhe kontrollin në masën e duhur të financave dhe operacioneve të ndërmjetësuesit, dhuruesit, marrësit dhe ndërmjetësit që paguan transferimin, apo të personit të cilit marrësi i ka transferuar burimet që ka marrë.

NAO ka të drejtë të auditojë transferimet e kredive të përmendura në paragrafin 1 dhe përgjegjësit për pagesën. Personat e audituar duhet të ndihmojnë audituesit gjatë kryerjes së detyrës. NAO mund të zgjedhë të përfshijë në auditim edhe këshilltarë ekspertë.

Qasja në informacione

Subjektet e audituara duhet ti sigurojnë NAO-s të gjithë informacionin dhe dokumentet e kërkuara, pa cënuar dispozitat e veçanta mbi fshehtësinë e çështjeve. NAO duhet të ketë akses në të gjitha informacionet dhe dokumentet e subjekteve të audituara, si dhe në shkresat që kanë lidhje me operacionet e saj.

Dorëzimi i informacioneve sekrete (21 Maj 1999/653)

Pavarëshit detyrimit për ruajtjen e fshehtësisë, siç përshkruhet në Ligjin mbi Publikimin e Aktiviteteve Zyrtare (621/1999), informacioni i siguruar gjatë kryerjes së auditimit, që ka lidhje me gjendjen ekonomike, biznesin, apo sekretin shtetëror, mund të trajtohet nga policia dhe autoritete të tjera si prokuroria dhe gjykatat në mënyrë që të hetohet një krim dhe madje edhe nga organet e KE-së, nëse e kërkon legjislacioni.

Rregullorja e Punës

Rregullorja e punës udhëheq organizimin, departamentet, njësitë dhe detyrat e tyre, si dhe menaxhimin dhe përgatitjen e çështjeve për vendimmarrje. Rregullorja e punës gjithashtu rregullon lëshimin dhe përgatitjen e udhëzimeve dhe urdhrave që kanë të bëjnë me auditimin, me bordin e gjobave dhe sanksioneve dhe vendosjen e tyre, me bordin e cilësisë dhe këshillin shkencor, me bashkëpunimin mes zyrtarëve dhe personelit, si dhe me postet dhe kualifikimet.

IZRAEL – KONTROLLI I SHTETIT

DHE

AVOKATI I POPULLIT

The office of the State Comptroller and Ombudsman of Israel

Kontrolli i Shtetit në Izrael fokusohet në shqyrtimin e aktiviteteve të autoritetit ekzekutiv, nëse ato janë kryer në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës, efektivitetit dhe integritetit moral. Funksioni i Kontrollit të Shtetit është përcaktuar në ligjin bazë mbi Kontrollorin Shtetëror.

